



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 143

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 9 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 84/2024, datë 26.7.2024	Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033..... 18177
Dekret i Presidentit nr. 283, datë 1.8.2024	Për shpallje ligji..... 18208
Ligj nr. 85/2024, datë 26.7.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ushtarake ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë..... 18208
Dekret i Presidentit nr. 284, datë 1.8.2024	Për shpallje ligji..... 18218
Ligj nr. 88/2024, datë 26.7.2024	Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake..... 18218
Dekret i Presidentit nr. 302, datë 6.8.2024	Për shpallje ligji..... 18226
Ligj nr. 89/2024, datë 26.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar..... 18226
Dekret i Presidentit nr. 303, datë 6.8.2024	Për shpallje ligji..... 18228
Ligj nr. 90/2024, datë 26.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës” 18228
Dekret i Presidentit nr. 304, datë 7.8.2024	Për shpallje ligji..... 18229
Ligj nr. 91/2024, datë 26.7.2024	Për disa ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 18230

Dekret i Presidentit nr. 305, datë 7.8.2024	Për shpallje ligji.....	18230
Dekret i Presidentit nr. 288, datë 5.8.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18230
Dekret i Presidentit nr. 289, datë 5.8.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18231
Dekret i Presidentit nr. 290, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18231
Dekret i Presidentit nr. 291, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18231
Dekret i Presidentit nr. 292, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18231
Dekret i Presidentit nr. 293, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18232
Dekret i Presidentit nr. 294, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	18232
Dekret i Presidentit nr. 295, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18232
Dekret i Presidentit nr. 296, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18233
Dekret i Presidentit nr. 297, datë 5.8.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18233
Dekret i Presidentit nr. 298, datë 5.8.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18233
Dekret i Presidentit nr. 299, datë 5.8.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18234
Dekret i Presidentit nr. 300, datë 5.8.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18234
Dekret i Presidentit nr. 301, datë 5.8.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18234
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 137, datë 6.8.2024	Për delegimin e kompetencave.....	18234



LIGJ
Nr. 84/2024

**PËR MIRATIMIN E PLANIT AFATGJATË
TË ZHVILLIMIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA 2024–2033**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet Plan i Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ligji nr. 121/2015, “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016–2025” shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të nevojshme sipas përcaktimeve në Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 283, datë 1.8.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**PLANI AFATGJATË I ZHVILLIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
2024–2033**

**Mesazhi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm
të Forcave të Armatosura të Republikës së
Shqipërisë**

Plan i Afatgjatë i Zhvillimit (PAZH) i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është një dokument i rëndësishëm strategjik, i cili në dhjetë vitet e ardhshme do të orientojë zhvillimin e Forcave tona të Armatosura. Ai përcakton rrugët dhe mjetet që do të garantojnë që Forcat tona të Armatosura të jenë të gatshme për t’u përballur me sfidat dhe kërcënimet e sigurisë dhe përmbushur misionin e tyre kushtetues.

Hartimi i PAZH-it është bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK), Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë dhe atë të NATO-s dhe i sinkronizuar me procesin e planifikimit të mbrojtjes të NATO-s. Njëkohësisht plani është në harmoni me qëllimet strategjike dhe objektivat e sigurisë dhe politikës së jashtme të Shqipërisë, duke siguruar që përpjekjet e FARSH-it të jenë të integruara në qasjen e vendit ndaj sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare dhe asaj kolektive.

PAZH-i përcakton kapacitetet që i nevojiten FARSH-it për t’iu kundërpërgjigjur kërcënimeve të sigurisë, përfshi ato ushtarake konvencionale, terrorizmin, krimin e organizuar dhe sulmet kibernetike dhe përcakton modelin, madhësinë, përbërjen dhe organizimin e Forcave të Armatosura, duke përfshirë ato tokësore, detare, ajrore dhe ato të specializuara (*niche*), për të garantuar sigurinë e vendit, përgjegjësitë në kuadër të mbrojtjes kolektive, promovuar stabilitetin rajonal dhe përmbushur përgjegjësitë në komunitetin ndërkombëtar.

PAZH-i trajton gjithë kontekstin e planifikimit dhe përkthen synimet e sigurisë kombëtare, objektivat dhe politikat e mbrojtjes në plane të zbatueshme, në harmoni me kërkesat e NATO-s dhe detyrimet e vendit tonë në kuadër të mbrojtjes kolektive. Ai përshkruan se si do të zhvillohen Forcat e Armatosura, duke siguruar që ato të jenë të pajisura, të përgatitura dhe të gatshme për të garantuar mbrojtjen e vlerave dhe interesave të



vendit dhe Aleancës, në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks dhe dinamik.

Lufta në Ukrainë dhe realiteti i ri gjeopolitik dhe gjeostrategjik e ka ndryshuar kuadrin e planifikimit afatgjatë. Përvojat e fundit operacionale nënvizojnë domosdoshmërinë për një qasje gjithëpërfshirëse të të gjithë shoqërisë për të adresuar sfidat e mbrojtjes, garantimin e qëndrueshmërisë ushtarake dhe rritjen e nevojës për kapacitete dhe struktura fleksibile të forcës.

Në perspektivën afatgjatë prioritetet e zhvillimit të mbrojtjes do të jenë kapacitetet ushtarake shumëpërdorimëshe, të ndërveprueshme dhe me lëvizshmëri të lartë, të fokusuara te forcat e luftimit me elementet e mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit, sistemet e mbrojtjes ajrore, sistemet e fuqisë së zjarrit dhe teknologjitë e avancuara krahas fuqizimit të flotës ajrore me helikopterë, si dhe forcës detare me anije luftarake.

PAZH-i shtrihet në periudhën 10-vjeçare, e nevojshme për implementimin e strukturave të reja të forcave dhe zhvillimin kapaciteteve. Ai shërben si një udhërrëfyes për të ardhmen, duke ofruar udhëzimet për rritjen e efektivitetit të kapaciteteve, por njëkohësisht lejon fleksibilitet për t'u përshtatur dhe reaguar kundrejt dinamikave gjeopolitike në ndryshim. Aftësia për të përshtatur planet dhe prioritetet sipas nevojës siguron që Forcat e Armatosura të mbeten të shkathëta dhe të përgjegjshme përballë sfidave.

Për të mundur zhvillimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të parashikuara në këtë plan nevojitet mbështetja buxhetore me jo më pak se 2% të PPB-së. PAZH-i do të orientojë shpërndarjen sipas prioriteteve dhe shfrytëzimin efektiv të burimeve, duke përfshirë personelin, materialet dhe infrastrukturën, për të rritur aftësitë, gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë.

Ai do të vijojë me zhvillimin e planeve mbështetëse sipas komandave, fushave dhe planet e modernizimit për zhvillimin e kapaciteteve ushtarake me pajisje bashkëkohore e të avancuara, duke përfshirë mbrojtjen ajrore, helikopterët, anijet, sistemet e artilerisë, automjetet dhe sistemet e armëve, duke menaxhuar me efektivitet burimet dhe duke shfrytëzuar zhvillimet teknologjike.

Ndërsa teknologjia evoluon, është jetike që Forcat e Armatosura të modernizohen, prandaj dhe PAZH-i konsideron përfshirjen dhe integrimin e

teknologjive të reja, si në sistemet e avancuara të armatimeve, po ashtu edhe në kapacitetet e sigurisë kibernetike dhe sistemet e inteligjencës. Në të njëjtën kohë do të thellohen masat për të mbrojtur infrastrukturën kritike, rrjetet dhe sistemet e informacionit.

Shqipëria si anëtare e NATO-s dhe kontribuuese në paqen dhe sigurinë rajonale e më gjerë, do të vijojë të marrë pjesë në misione dhe operacione të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja apo koalicione vullneti. PAZH-i konsideron nevojën për rritjen e kontributit dhe ndërveprueshmërisë me NATO-n dhe forcat Aleate, përfshi standardizimin e pajisjeve, procedurave dhe trajnimit, për të siguruar që Forcat e Armatosura të jenë të ndërveprueshme dhe të krahasueshme me aleatët në terrenet e stërvitjes dhe fushën e betejës.

PAZH-i u mundëson Forcave të Armatosura të aplikojnë strategji rekrutimi, trajnimi dhe zhvillimi gjithëpërfshirëse për të siguruar dhe mbajtur në to burimet njerëzore të afta dhe profesionale, e cila është thelbësore për cilësinë e Forcave të Armatosura. PAZH-i adreson rekrutimin, trajnimin, mbajtjen dhe zhvillimin e karrierës dhe nëpërmjet programeve bashkëkohore të edukimit, trajnimit dhe mësimin në detyrë do të zhvillohen aftësitë dhe do të sigurohet ekspertiza për të përmbushur nevojat e të ardhmes.

SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM Gjeneralmajor Arben Kingji

Përmbajtja

KREU I. TË PËRGJITHSHME

KREU II. VLERËSIMI I MJEDISIT TË SIGURISË

2.1. Ambianti gjeostrategjik i veprimit të FARSH-it

2.2. Kërcënimet dhe rreziqe

KREU III. KUADRI STRATEGJIK

3.1 Mjedisi i Sigurisë dhe ndikimi i tij në FARSH

3.2 Misioni i FARSH-it

3.3 PAZH-i në frymën e dokumenteve strategjike

KREU IV. KËRKESAT DHE DREJTIMIT KRYESORE PËR FARSH-in

4.1 Kërkesat kryesore për FARSH-in

4.2 Objektivat sipas drejtimeve kryesore

4.2.1 Zhvillimi, menaxhimi dhe motivimi i personelit



4.2.2 Arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i personelit

4.2.3 Zhvillimi i kapaciteteve

4.2.4 Projektet e zhvillimit të infrastrukturës ushtarake

4.2.5 Mbështetja logjistike

KREU V. KAPACITETET E ARDHSHEME TË FA-së

5.1 Forca Tokësore

5.2 Forca Detare

5.3 Forca Ajrore

5.4 Arsimimi, stërvitja dhe trajnimi në FARSH

5.4.1 Arsimi

5.4.2 Stërvitja dhe trajnimi

5.5 Komanda Mbështetëse

KREU VI. KAPACITETET E KOMUNIKIM-KOMANDIM-KONTROLLIT NË FA

KREU VII. MBROJTJA KIBERNETIKE

KREU VIII. OPERACIONET

KREU IX. BURIMET E MBROJTJES

KREU X. BASHKËPUNIMI

KREU XI. PËRFUNDIME

KREU I TË PËRGJITHSHME

Hyrje

Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (PAZH 2024–2033) është dokumenti kryesor për zhvillimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura, si dhe është baza për hartimin e planeve mbështetëse të zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky plan ka për qëllim të kthejë objektivat e Strategjisë Ushtarake në kapacitete dhe aftësi ushtarake në zbatim të misionit kushtetues, detyrave kombëtare dhe detyrimeve në kuadër të NATO-s.

Procesi i Planifikimit të Mbrojtjes së vendit tonë dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA-së i referohet elementeve më të rëndësishme të ambicies dhe objektivave të mbrojtjes, dinamikës dhe harmonizimit me proceset e planifikimit të Aleancës (NDPP). Kjo dinamikë do të lehtësojë përcaktimin e fazave të planifikimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, si dhe përafrimin me kuadrin normativ të synimeve të dokumenteve kryesore strategjike të sigurisë dhe mbrojtjes. Me miratimin e PAZHFA 2024–2033, strukturat e FA-së do të hartojnë planet e tyre respektive të detajuara, planin e vendosjes dhe planet mbështetëse sipas fushave.

PAZHFA ka një afat 10-vjeçar, por ai do të rishikohet çdo katër vjet ose sa herë që do të ketë rishikim të dokumenteve strategjike, si Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK) dhe Strategjia Ushtarake (SU) e Republikës së Shqipërisë.

Nevoja për rishikimin e PAZHFA-së

Rishikimi i PAZH 2024–2033 është i domosdoshëm nëse konsiderohen qasjet koherente të NATO-s, për harmonizimin e planifikimit të mbrojtjes me planifikimin operacional, në planifikimin e kapaciteteve për përballimin e rreziqeve dhe sfidave që na paraqet mjedisi i sigurisë. Për sistemin tonë të planifikimit mbetet e rëndësishme që metodologjia e planifikimit në PAZH 2024–2033, të reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e kapaciteteve, transformimin dhe modernizimin koherent për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument rishikohet në një kohë kur mjedisi i sigurisë ka pësuar ndryshime domethënëse. Agresioni rus ndaj Ukrainës ka thyer normat dhe parimet e sovranitetit kombëtar të vendosura pas Luftës së Dytë Botërore dhe ka rikthyer luftën në Evropë. Nuk përjashtohet mundësia e një sulmi konvencional kundër vendeve aleate në NATO-s apo që kjo luftë të ketë efekt domino edhe në Ballkanin Perëndimor. Prandaj ne duhet të fuqizojmë instrumentin e mbrojtjes nëpërmjet krijimit të kapaciteteve ushtarake të nevojshme për mbrojtjen e vendit, sigurimin e qëndrueshmërisë kombëtare, si dhe kapacitetet për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s.

Si pjesë e Aleancës, Shqipëria planifikon dhe zbaton sigurinë dhe mbrojtjen e saj, si pjesë e mbrojtjes kolektive të NATO-s, me përfitimet dhe detyrimet përkatëse që rrjedhin prej saj.

PAZH 2016–2025 nuk i shërben më qëllimit të tij. Situata e sigurisë në ambientin gjeostrategjik, tërmeti i vitit 2019, pandemia COVID-19, përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në paketën e objektivave të kapaciteteve, rritja e kontributeve në operacione si brenda vendit dhe në kuadër të NATO/BE/OKB, rritja e ndikimit të teknologjisë së informacionit, angazhimi i qeverisë për rritjen e buxhetit të mbrojtjes në 2% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB), si dysHEME e shpenzimeve për mbrojtjen, duke evidentuar veçanërisht mësimet e nxjerra dhe domosdoshmëritë e përshtatjeve të FARSH-it në strukturë dhe aftësi, e përforcojnë domosdoshmërinë e rishikimit të këtij plani.



Afatet kohore nga miratimi i PAZH-it të fundit e përforcojnë domosdoshmërinë e rishikimit të këtij dokumenti.

Metodologjia e hartimit të PAZHFA 2024–2033

Hartimi i PAZHFA 2024–2033 është bërë nga një grup pune i përbashkët i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, duke përfshirë ekspertizën dhe kontributet nga të gjitha strukturat e FA-së.

PAZHFA 2024–2033 mbështetet në Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s² dhe përfshin detyrimet e vendit tonë në këtë proces, për realizimin e tri detyrave thelbësore: të mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese. Hartimi i këtij dokumenti vjen si nevojë për zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve, gatishmërisë dhe operacionalitetit, rritjen e qëndrueshmërisë të sistemit të mbrojtjes, ndarjes më të drejtë të barrës dhe përgjegjësisë, si dhe një marrëdhënie të përforcuar NATO–BE dhe me vendet partnere.³

Procesi i rishikimit të PAZHFA 2024–2033 filloi me analizën e ndryshimeve në ambientin e sigurisë, në përputhje me Strategjinë e rishikuar të Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake, si edhe me të gjithë hierarkinë e dokumenteve të NATO-s.

Në hapin e radhës, kapacitetet e nevojshme u krahasuan me kapacitetet ekzistuese për të identifikuar mangësitë sasiore dhe cilësore. Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese dhe të nevojshme krijoi një pamje të përgjithshme të situatës aktuale dhe të synimit të dëshiruar. Kjo u pasua nga ndarja sipas prioriteteve e kapaciteteve të kërkuara, duke u nisur nga faktorët e përdorimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të rrezikut. Fokusi u orientua në planifikimin e kapaciteteve fleksible (shumëpërdorimëshe) dhe të ndërveprueshme.

Në hapin e fundit u përcaktuan nivelet në të cilat duhet të zhvillohet çdo kapacitet dhe nevojat për burime në aspektin e financës, personelit, materialeve dhe kohës. Në përfundim të kësaj analize u evidentuan tri kategori kapacitetesh si më poshtë:

- Kapacitetet që janë të nevojshme për mbrojtjen kombëtare dhe të detyrueshme e në përputhje me angazhimet e vendit tonë në NATO, zhvillimi i të cilave do të nisë dhe do të realizohet brenda 10 viteve të ardhshme. Këto kapacitete janë fokusi i këtij dokumenti.

- Kapacitetet që janë të nevojshme për mbrojtjen kombëtare, por janë shumë të kushtueshme për vendin tonë dhe mund të arrihen vetëm në bashkëpunim me NATO-n dhe Aleatët. Në rastin e FA-së kapacitete të tilla, ndër të tjera përfshijnë mbrojtjen raketore, transportin strategjik dhe policimin ajror etj.

- Kapacitetet që i nevojiten FA-së dhe realizimi i të cilave është i pamundur në afatin kohor të 10 vjetëve të ardhshëm. Zhvillimi i kapaciteteve të tilla do të konsiderohet te PAZH-i radhës ose në rast se disa nga projektet në zhvillim do të kenë kosto konsiderueshme më të ulët sesa buxheti i planifikuar fillimisht.

Supozimet në hartimin e PAZH 2024–2033

- sovraniteti tokësor i Republikës së Shqipërisë nuk do të preket nga kërcënime të jashtme;

- masat që ka ndërmarrë Aleanca për rritjen e veprimtarisë shkurajuese janë të efektshme dhe parandalojnë cenimin territorial të një vendi anëtar të saj;

- mjedisi global i sigurisë do të vijojë të jetë i paqëndrueshëm, duke sjellë ndikime të tërthorta në mjedisin e sigurisë rajonale;

- kërkesat për zhvillimin e kapaciteteve për mbrojtjen e vendit, qëndrueshmërinë dhe në kuadër të Aleancës do të rriten;

- kërcënimet ndaj sigurisë, të ndërlidhura me ato hibride e kibernetike, do të vijojnë të jenë prezent në hapësirën tonë kombëtare;

- buxheti i Mbrojtjes i përcaktuar, duke filluar nga viti 2024 do të jetë jo më pak se 2% të PBB-së, nga e cila 20% do të jetë e dedikuar për modernizimin;

- FARSH-i do të ketë një rritje të personelit mbi numrin e parashikuar në RSM, duke integruar si pjesë të saj edhe forcën rezerviste;

- FARSH-i do të vijojë përgatitjen, kompletimin dhe modernizimin e saj bazuar në parimin e një grupimi të vetëm forcash (*one single set of forces*);

- bashkëpunimi ushtarak me partnerët dhe në rajon do të jetë në të njëjtin nivel ose në rritje;

- FARSH-i do të vijojë të ketë një kontribut të shtuar në emergjencat civile, brenda dhe jashtë vendit.

KREU II

VLERËSIMI I MJEDISIT TË SIGURISË

2.1 Ambienti gjeostrategjik i veprimit të FARSH-it



Mjedisi global i sigurisë karakterizohet nga paqëndrueshmëria, paparashikueshmëria, ndryshimi i vazhdueshëm dhe konkurrenca strategjike. Aktorë shtetërorë me tendenca keqdashëse po mundohen të zhvillojnë aftësi për të ndikuar në mjedisin e sigurisë, të sfidojnë rregullat ndërkombëtare, interesat, vlerat dhe mënyrën e jetesës. Këto tendenca po tentohen të arrihen nëpërmjet ndikimeve/ndërhjryjeve në të gjitha fushat, duke përfshirë dhe përdorimin e forcës ushtarake.

Rreziqet dhe kërcënimet e rritura të sigurisë tashmë janë shtuar, po ashtu edhe kërcënimet në hapësirën kibernetike. Ky kërcënim mund të përdoret në çdo kohë dhe pa paralajmërim si një armë kundër qëndrueshmërisë sociale, ekonomike, politike si pasojë e zhvillimeve teknologjike, mungesës së një regjimi të kontrollit të armëve kibernetike dhe aftësive që kanë vendet për t'ju përgjigjur këtij kërcënimi.

Realiteti i ri gjeopolitik në kufijtë e Evropës, sjellja agresive, retorika dhe gatishmëria për të përdorur forcën ushtarake, ka krijuar implikime të reja edhe për rajonin tonë, si dhe ka rritur shqetësimet për mundësitë e nxitjeve për rizgjim të tensioneve ndëretnike dhe konflikteve të vjetra ndërshtetërore, të cilat mund të kenë ndikim të paparashikueshëm në situatën e sigurisë rajonale.

Angazhimi dhe vullneti i fortë i treguar nga NATO-ja dhe BE-ja në rajon, për të mbrojtur stabilitetin dhe paqen nga interesat gjeopolitike të aktorëve të jashtëm, ka qenë dhe mbetet burim inkurajimi për perspektivën e afërt drejt integritetit euroatlantik të shteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe ka nxitur bashkëpunimin rajonal për përballimin e sfidave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë. Prania ushtarake dhe angazhimi i vazhdueshëm politiko-ushtarak i NATO-s ndaj vendeve të rajonit, për ruajtjen e stabilitetit dhe promovimin e paqes, tregon gjithnjë e më shumë rëndësinë që ka mbrojtja kolektive. Rikonfirmimi në Konceptin e ri Strategjik të Aleancës, i angazhimit të palëkundur ndaj mbrojtjes kolektive, si dhe rritja e bashkëpunimit me partnerët, duke mbështetur aspiratat euroatlantike të vendeve të rajonit, e vlerësuar si një rëndësi strategjike për NATO-n, rrit shanset për krijimin e mundësive të qëndrueshme për krijimin e një mjedisi të qetë, të sigurt dhe bashkëpunues.

Koordinimi me partnerët strategjikë, vendet anëtare të NATO-s, si dhe bashkëpunimi rajonal,

janë kontribuesit kryesorë në përmirësimin e klimës së sigurisë.

2.2 Kërcënimet dhe rreziqe

Zhvillimet në mjedisin gjeostrategjik, pavarësisht se nuk ka një vijë të qartë ndarjeje, kanë nxjerrë në pah sfidat dhe rreziqet e reja në ambientin gjeopolitik si ato hibride, terroriste, jo-konvencionale dhe ushtarake. Këto sfida të cilat në natyrën e tyre janë tradicionale, po mbivendosen me sfida të reja të shfaqura në dekadën e fundit, si: pandemitë, sulmet kibernetike, ndryshimet klimaterike, lëvizjet e pakontrolluara të popullsisë etj. Këto sfida që më shumë se kurrë, po vijnë njëra pas tjetrës në mënyrë të paparashikueshme, po rrisin paqëndrueshmërinë e sistemit të sigurisë dhe po sfidojnë aftësitë dhe zgjidhjet strategjike të shteteve për t'ju përgjigjur në mënyrë efektive.

Në nivel global: hapja e një vatre konvencionale konflikti ushtarak në Evropë vë seriozisht në diskutim të gjithë arkitekturën e sigurisë të pas Luftës së Ftohtë në Evropë dhe më gjerë. Konflikti në Ukrainë ka sjellë gjithashtu më afër se kurrë mundësinë e një përplasjeje të armatosur konvencionale mes Federatës Ruse dhe NATO-s. Gjithashtu, riaktivizimi i konfliktit Izael-Hamas ka potencial të përhapet në një konflikt rajonal me pasojë globale. Kjo rrit më tej shqetësimet për sigurinë, kërcënimet përtej kufijve kombëtarë, paqëndrueshmërinë ekonomike dhe shqetësimet për kriza humanitare, divergjenca politike e sociale edhe në thellësi të kontinentit evropian.

Zhbërja e arkitekturës së kontrollit të armëve si rrjedhojë e shkeljes së njëanshme të detyrimeve ndërkombëtare dhe tërheqjes nga marrëveshjet ndërkombëtare të armë-kontrollit, rrisin rrezikun e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Terrorizmi, në të gjitha format dhe manifestimet e tij, i përcaktuar në Konceptin Strategjik të NATO-s si kërcënim asimetric më i drejtpërdrejtë për sigurinë e vendeve të NATO-s, mbetet një kërcënim konstant krahas gamës së kërcënimeve asimetrike dhe hibride. Lindja e grupeve të reja terroriste apo i fraksioneve ekstremiste nga grupe të njohura më synime zgjerim territori nën kontroll, aftësia e tyre për të përshtatur strategjinë, organizatën dhe mënyrat e veprimit, për të shfrytëzuar zona e rajone me vakum sigurie, apo për të plotësuar hapësirat e lëna pas nga paqëndrueshmëritë politike dhe konfliktet, vijon të përbëjë kërcënim për sigurinë ndërkombëtare.



Po ashtu, teknologjitë në zhvillim dhe çorientuese po sjellin në skenën e sigurisë ndërkombëtare kërcënime të reja, veçanërisht ato që lidhen me hapësirën kibernetike, manipulimin e të dhënave, keqpërdorimin e inteligjencës artificiale dhe përdorimin e saj për motive ushtarake dhe të sigurisë. Këtyre kërcënimeve i shtohen ndryshimi i kushteve klimatike të cilat kanë potencial të sjellin implikime të reja social-ekonomike për sigurinë.

Përdorimi i energjisë si armë dhe mjet presioni nga ana e Federatës Ruse ka sjellë në vëmendje rëndësinë e sigurisë energjetike.

Vatrat e shumta të konfliktit në rajone të ndryshme të kufijve jugorë dhe lindjen e mesme, si dhe lufta aktuale Izrael– Hamas kanë rritur ndjeshëm emigracionin e pakontrolluar, çka mund të sfidojë vendet e prekura në menaxhimin e tij.

Në nivelin rajonal: Ballkani Perëndimor (BP) reflekton dinamikën, rreziqet, kërcënimet dhe agresivitetin e mjedisit global të sigurisë, por ai vazhdon të sfidohet edhe nga sfida të brendshme, si: mosmarrëveshje politike e aktivitete penguese shtetformuese; paqëndrueshmëri politike dhe të konsolidimit të qeverisjes demokratike; mosmarrëveshje ndërshtetërore e thellim të ndarjeve ndëretnike, si dhe akte të rënda dhune etnike e nacionaliste. Sfidat që po kërcënojnë situatën e sigurisë, po nxisin destabilitetin e rajonit, duke ndikuar në klimën e mirëbesimit, fqinjësisë e bashkëpunimit rajonal, si dhe po pengojnë përparimin drejt institucionet euroatlantike.

Ngurrimi dhe mosmarrëveshjet e aktorëve të caktuar shtetërorë brenda BE-së për zgjerim dhe skepticizmi e paqartësia e orientimit të disa vendeve të rajonit drejt integritetit euroatlantik, po shfrytëzohen nga aktorë brenda e jashtë rajonit në interes të interesave gjeopolitike malinje.

Këta aktorë të jashtëm po përpiqen të ushtrojnë ndikimin e tyre në BP, përmes një spektri të gjerë instrumentesh që nga elementet e fuqisë së butë e deri tek aktivitetet hibride e subversive për nxitjen e konflikteve ndërshtetërore në rajon.

Rusia ka rritur aktivitetet hibride për të nxitur destabilizimin dhe për të penguar proceset integruese të vendeve në rajon në BP, si dhe në një kontekst më pragmatist për të shmangur vëmendjen e perëndimit nga konflikti në Ukrainë.

Realiteti i ri gjeopolitik me të cilin po përballlet kontinenti Evropian pas agresionit rus në Ukrainë, ka krijuar implikime të reja politike, ekonomike,

sociale dhe të sigurisë për rajonin e BP-së dhe ka rritur shqetësimet për rinxitjen e tensioneve dhe konflikteve të vjetra me ndikim të paparashikueshëm në situatën e sigurisë rajonale duke rritur rrezikun për konflikte të armatosura.

Fuqitë perëndimore tashmë po tregojnë një vullnet të fortë dhe ka një mandat të qartë për të mbrojtur stabilitetin dhe paqen në BP nga interesat gjeopolitike të aktorëve të jashtëm dhe vendeve të rajonit me orientim të paqartë. Prezenca e shtuar ushtarake e SHBA-së, NATO-s dhe BE-së në rajon e është një tregues i qartë i kësaj qasje strategjike.

Pavarësisht kësaj, rajoni vijon të mbetet një rrugë transiti për krimin e organizuar me lidhje rajonale e ndërkombëtare. Krimi apo grupet e krimit të organizuar dhe aktiviteti i tyre vazhdon të jetë shqetësim për vendet e rajonit. BP-ja konsiderohet si rruga kryesore e transimit nga lindja për në vendet e BE-së, për aktivitete si trafikimi i lëndëve narkotike, kontrabandës, armatimit, si dhe qenieve njerëzore. Aktiviteti nga grupet e krimit të organizuar mbetet një ndër kërcënimet kryesore në rajon, kryesisht për shkak të lidhjeve me politikën dhe korrupsionin për të ndikuar në vendimmarrjen politike e zhvillimet ekonomike dhe deri në marrëdhëniet ndërshtetërore.

Terrorizmi, në të gjitha format dhe manifestimet e tij duke përfshirë edhe ekstremizmin e dhunshëm, janë një kërcënim për sigurinë, paqen dhe prosperitetin e qytetarëve të rajonit, edhe pse vendet e rajonit kanë marrë disa masa për të adresuar këtë kërcënim.

Vendet e Ballkanit janë objekt i sulmeve kibernetike nga aktorë gjeopolitikë të jashtëm të cilët synojnë grumbullimin e informacionit kritik mbi politikat kombëtare të shteteve dhe të organizatave ku ata aderojnë. Orientimi drejt rrugës euroatlantike i disa shteteve të rajonit dhe qenia anëtar i NATO-s i disa vendeve të tjera, ka rritur interesin duke pasur si qëllim njohjen dhe ndikimin e vendimmarrjes politike.

KREU III

KUADRI STRATEGJIK

3.1 Mjedisi i Sigurisë dhe ndikimi i tij në FARSH

Në nivel kombëtar, Shqipëria ndikohet ndjeshëm ndaj rreziqeve, kërcënimeve dhe sfidave të mjedisit global dhe rajonal të sigurisë, për shkak të globalizmit, ndërveprimit të teknologjisë,



zhvillimeve ndërkombëtare, konsideratave rajonale dhe rrethanave të brendshme.

Mjedisi i brendshëm i Republikës së Shqipërisë është i ndikueshëm nga tendenca negative dhe keqdashëse, të cilat mund të shfrytëzohen nga aktorë gjeopolitikë të jashtëm, për të dëmtuar dhe për të penguar zhvillimin e interesave kombëtarë, kohezionin dhe bashkëjetesën sociale, progresin dhe konsolidimin institucional në rrugën drejt integritetit Evropian. Fenomene si korrupsioni, krimi organizuar, sulmet kibernetike, lajmet e rreme dhe fatkeqësitë natyrore kanë potencial të kërcënojnë sigurinë e vendit tonë. Pavarësisht sfidave të brendshme e dinamikave të mjedisit global dhe rajonal të sigurisë, Republika e Shqipërisë vitet e fundit ka bërë progres në drejtim të forcimit të mjedisit të brendshëm të sigurisë. Anëtarësimi në NATO dhe perspektiva e anëtarësimit në BE, kanë forcuar demokracinë, kanë rritur stabilitetin e brendshëm dhe vendi është shndërruar në një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon. Shqipëria dhe FARSH, si një nga komponentët kryesorë të fuqisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, janë të përkushtuara për të përmbushur të gjitha detyrimet dhe angazhimet si në kuadër të Aleancës, po ashtu edhe ato ndërkombëtare.

3.2 Misioni i FARSH-it

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë mision të sigurojnë pavarësinë, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe rendin kushtetues të vendit në bashkëveprim me forcat aleate, mbrojtjen dhe mbështetjen e popullsisë e të autoriteteve civile në kohë paqeje, krize e lufte, të kontribuojnë për mbrojtjen kolektive, në kuadër të nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit^{vii}, si dhe paqen e sigurinë në rajon e më gjerë.

Për përmbushjen e misionit, Forcat e Armatosura realizojnë këto detyra kryesore:

- mbrojtja dhe garantimi i sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit, si dhe zbatimi i detyrimeve në kuadër të Aleancës;

- kontribut në sigurinë ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet dhe misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së për menaxhimin e krizave;

- ndërtimin e kapaciteteve paralajmëruese dhe zbuluese për rreziqet potenciale dhe kërcënimet, kontrollin e hapësirës detare e ajrore, operacionet e kërkim-shpëtimit, mbrojtjen e objekteve strategjike, në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile;

- mbështetja e popullsisë në rast fatkeqësish natyrore, aksidenteve industriale dhe krizave ekologjike;

- mbështetjen sipas ligjit të autoriteteve lokale dhe qendrore dhe institucioneve të tjera qeveritare.

3.3 PAZH-i në frymën e dokumenteve strategjike

Hartimi i këtij plani respekton dhe bazohet në hierarkinë e dokumenteve strategjike të Republikës së Shqipërisë:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton misionin e FARSH-it: “Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues”.

- *Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK)*

SSK-ja përcakton detyrimet e shtetit për garantimin e sigurisë dhe lirisë, të cilat paraqiten në formën e objektivave strategjike. SSK-ja vlerëson mjedisin e sigurisë, përshkruan rreziqet e sigurisë kombëtare dhe detyrimet e institucioneve për përballimin e tyre.

- *Strategjia Ushtarake (SU)*

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë është dokumenti kryesor, i cili përkthen objektivat politike të përcaktuar në SSK në objektiva ushtarakë. Në funksion të mjedisit të sigurisë, përcaktohet roli, misioni, detyrat dhe përgjegjësitë e FARSH-it, si një prej instrumenteve kryesore të fuqisë kombëtare. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, Forcat e Armatosura duhet të zhvillojnë dhe të mbajnë kapacitete të nevojshme për përballimin e rreziqeve të parashikuara dhe përmbushjen e misionit dhe detyrave.

- *Koncepti strategjik dhe dokumente të tjera të NATO-s*

Përveç dokumenteve të rëndësishme kombëtare, PAZHFA 2024–2033 merr në konsideratë edhe Konceptin Strategjik të NATO-s, SU-ja e NATO-s me dy konceptet për implementimin e saj (DDA dhe NWCC), Modelin e Ri të Forcës si elementi kyç i Konceptit Strategjik, si dhe detyrimet në kuadër të mbrojtjes kolektive sipas *Paketës së objektivave të kapaciteteve*.

KREU IV

KËRKESAT DHE DREJTIMET KRYESORE PËR FARSH-in

Dokumentet strategjike të përmendura më herët përcaktojnë kërkesat për FARSH-n, të nevojshme



për përmbushjen e objektivave kombëtare strategjike të mbrojtjes, të pasqyruara në misionin dhe listën e detyrave themelore të FARSH-it. Këto kërkesa ndahen në kombëtare dhe në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Kërkesat e përcaktuara në dokumentet kryesore strategjike për FARSH-in orientojnë zhvillimin e kapaciteteve të FARSH-it, sipas drejtimeve kryesore të mëposhtme:

- një forcë ushtarake efektive e gatshme dhe e aftë (*e kompletuar, e përshtatshme, e ndërveprueshme*);
- zhvillimi, menaxhimi dhe motivimi i personelit;
- arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i personelit;
- zhvillimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë;
- zhvillimi i infrastrukturës ushtarake;
- mbështetja logjistike dhe kapacitetet e vendit pritës;

- bashkëpunimi ushtarak.

4.1 Kërkesat kryesore për FARSH-in

- *Kombëtare*

Në zbatim të misionit dhe detyrave të ngarkuara, kërkesat kryesore për Forcat e Armatosura janë përgjigja me forca dhe mjete ndaj situatave të krijuara në kohë paqe, krize dhe lufte, në mbrojtje të sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit, reagimit ndaj emergjencave civile të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga njeriu.

Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kapacitete të përshtatshme (mjete, pajisje, sisteme, personel, procese dhe procedura) të forcave të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit, për t'ju përgjigjur spektrit të rreziqeve që mund të kanosin sovranitetin dhe tërësinë territoriale të vendit. Forcat e Armatosura do të kompletohen me sisteme e pajisje dhe do të organizohen, stërviten e trajnohen për të qenë të gatshme të kryejnë operacione luftarake dhe joluftarake brenda dhe jashtë vendit.

- *Qëndrueshmëria*

Në përputhje me SSK-në, nenin 3 të Traktatit të Uashingtonit dhe Konceptin Strategjik të NATO-s, FARSH-it do të rrisin dhe do të forcojnë qëndrueshmërinë në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë kombëtare.⁴ Rritja e qëndrueshmërisë mundësohet përmes analizës, vlerësimit të riskut dhe aftësisë për të reaguar ndaj kërcënimeve të mundshme të saj.⁵ Sipas SSK-së, kjo ka tre hapa të rëndësishëm: kuptimi (i rreziqeve dhe dobësive), mbrojtja (e infrastrukturës kritike, njerëzve dhe institucioneve) dhe reagimi (aftësi për

të penguar, menaxhuar dhe reduktuar rreziqet e mundshme).

FARSH-i, përveç rolit të tyre parësor që buron nga misioni kushtetues për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë, kontributit në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës, pjesëmarrjes në misione dhe operacione të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara, si dhe mbështetjen në përballimin e emergjencave civile, gjithashtu ofrojnë kapacitetet e tyre për institucionet të tjera të sigurisë kombëtare nëse nevojiten për përballimin e kërcënimeve të karakterit virtual dhe ato hibride.⁶

- *Emergjencat civile*

Përveç sigurimit të mbështetjes ndaj autoriteteve qendrore dhe lokale, Forcat e Armatosura ofrojnë ndihmën e tyre edhe në përballimin e emergjencave natyrore në nivel rajonal.

Përballimi i emergjencave civile në ndihmë të autoriteteve lokale realizohet kryesisht nga efektivat e Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse, e më pas edhe nga strukturat e tjera, sipas situatës. Forca Ajrore ndihmon me transport ajror të mallrave, njerëzve dhe luftës kundër zjarrit, si dhe marrjes së pamjes ajrore për situatat e përhapjes së përmytjeve dhe zjarreve. Forca Detare ndihmon në mënyrë të kufizuar me mjete dhe njerëz, autoritetet civile kryesisht në zonat pranë dislokimeve të reparteve të saj.

Kjo mbështetje për autoritetet civile qendrore dhe lokale, jepet nga FARSH-i kur burimet shtetërore janë përdorur dhe kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme, si dhe do të kryhet në varësi të përshkallëzuar të gjenerimit të situatave.

- *Në kuadër të NATO-s*

Koncepti strategjik i NATO-s kërkon nga vendet aleate zhvillimin e kapaciteteve ushtarake për të përballuar kërcënimet dhe sfidat aktuale dhe të pritshme të sigurisë. Ky koncept rritet qëllimin thelbësor të NATO-s dhe përgjegjësinë e saj më të madhe për të siguruar mbrojtjen kolektive të aleatëve kundër të gjitha kërcënimeve nga të gjitha drejtimet.

Detyrimet e vendit tonë për kapacitete në kuadër të Aleancës jepen në *Paketën e objektivave të kapaciteteve*, e cila përmban kapacitete cilësore dhe sasiore të domosdoshme për t'u zhvilluar dhe siguruar nga FA-ja. Kapacitetet që do të zhvillohen do të jenë me



përdorim të dyfishtë, për Aleancën dhe për përdorim kombëtar.

Gjithashtu, duhet të zhvillohen kapacitetet e mbështetjes si vend pritës për të mbështetur forcat aleate gjatë kalimit transit apo dislokimit në vendin tonë, si dhe kapacitetet në funksion të mbështetjes së aktiviteteve të pritjes, konsolidimit dhe lëvizjes përpara (RSOM) të këtyre forcave.

- Kërkesat në kuadër të BE-së dhe OKB-së

Me marrjen e statusit të “vendit kandidat” rritja e ndërveprueshmërisë me FA-në e vendeve të BE-së është një detyrim i vazhdueshëm dhe i shërben agjendës integruese të Republikës së Shqipërisë. Kjo shërben njëkohësisht edhe si pararendëse e integritimit në BE.

Republika e Shqipërisë është eksportues i paqes, çka pasqyrohet nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja, por edhe nga koalicionet e drejtuara nga aleatët.

4.2 Objektivat sipas drejtimeve kryesore

Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e FARSH-it sipas drejtimeve kryesore do të arrihet nëpërmjet përmbushjes së objektivave të qartë, të arritshëm e të matshëm në periudhat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Në vijim të këtij dokumenti periudha afatshkurtër nënkupton periudhën 2024–2026, ajo afatmesme 2027–2030 dhe periudha afatgjatë nënkupton periudhën 2031–2033.

- Objektivat në nivelin strategjik

Mbështetur në parimet e politikës së mbrojtjes dhe objektivat e Republikës së Shqipërisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, FARSH janë shtylla kryesore e shtetit në përballjen me kërcënimet dhe rreziqet që paraqet mjedisi i sigurisë i tanishëm dhe atyre që e ardhmja mund të sjellë, brenda dhe jashtë vendit.

- Forcat e Armatosura do të përmbushin misionin dhe detyrat e tyre për garantimin e sovranitetit dhe pavarësisë së vendit, mbrojtjen e popullsisë dhe integritetin territorial të vendit, përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile;

- Si pjesë e pandarë e Aleancës, Forcat e Armatosura do të veprojnë në përmbushjen e detyrave të ngarkuara në mbrojtje të tërësisë territoriale të saj dhe në përbërje të Aleancës;

- Në mbështetje të objektivit politik të anëtarësimit në BE, Forcat e Armatosura do të japin

kontributin e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet e drejtuara nga BE-ja dhe prezencës së përhershme në strukturat drejtuese ushtarake të saj;

- Shqipëria do të vijojë të jetë një kontribues i paqes dhe sigurisë edhe përtej rajonit tonë, për rrjedhojë Forcat e Armatosura do të ofrojnë prezencën e tyre në misionet e OKB-së dhe koalicionet e drejtuara nga aleatët.

- Objektivat në nivelin operacional

Puna e strukturave të FA-së do të fokusohet në harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta, për të pasur një forcë profesioniste, në përmbushje të misionit kushtetues dhe detyrimeve në kuadër të Aleancës. Reformimi dhe strukturimi i FA-së do të vijojë si një proces normal, për të siguruar një forcë më të motivuar dhe të përgatitur. Ky reformim do të mundësojë që FA-ja të jetë më e përgatitur, e kompletuar, e dislokueshme, e ndërveprueshme dhe e përshtatshme për të garantuar realizimin e misionit, angazhimet në ndihmë të komunitetit dhe kontributin në mbështetje të Aleancës.

Në përgjigje të sfidave të sigurisë që shtrihet koha dhe situata, Forcat e Armatosura do të rishikojnë dhe harmonizojnë nivelet e gatishmërisë së reagimit për realizimin e detyrimeve kombëtare dhe atyre të Aleancës, në përputhje me Planet e Mbrojtjes Kombëtare edhe ato rajonale të NATO-s. Prioritet do të jenë kapacitetet e deklaruara në NATO, duke ruajtur dhe konsoliduar nivelin e gatishmërisë për grup-batalionin e këmbësorisë së lehtë, kapacitetet detare dhe ajrore si kontributi kryesor në Aleancë, por edhe kapacitetet Niche.⁷

Objektivat për periudhën afatshkurtër:

1. Kompletimi i strukturave të reja dhe konsolidimi i atyre prioritare si pjesë e detyrimit të paketës së objektivave të Aleancës;

2. Integrimi i komponentit rezervist si pjesë e strukturës së forcës aktive.

Strukturat në fokus të kësaj periudhe, do të jenë:

- GBKL-ja me gjithë elementet e tij mbështetëse;

- Grupi i Detyrës së Operacioneve Speciale Tokësore;

- Regjimentet e Këmbësorisë (Veriut dhe Jugut);

- Regjimenti i Mbështetjes me Luftim (RML);

- Distriktet Detare (Veriut dhe Jugut);

- Qendra e Zhytjes;

- Regjimenti i Helikopterëve;

- Baza Ajrore Kuçovë;

- Batalioni i Mbrojtjes Kundërajrore;

- Qendra MADM;



- Kompania e Xhenios;
- Elementet e bashkëpunimit civilo-ushtarak;
- Detashmenti i Sistemeve Ajrore pa Pilot;
- Qendra Operacionale e Mbrojtjes Kibernetike;
- Baza e Mbrojtjes së Emergjencave Civile (BMEC);
- Kapacitetet EOD;
- Qendra e ekselencës për sigurinë fizike dhe menaxhimin e municioneve.

Objektivat për periudhën afatmesme:

1. Kompletimi dhe konsolidimi i strukturave prioritare.

2. Integrimi i plotë i forcës rezerviste në strukturën e forcës aktive.

3. Modernizimi i strukturave kryesore të luftimit dhe të mbështetjes së luftimit:

Strukturat që do të kalojnë në operacionalitet të plotë në fund të kësaj periudhe kohore, do të jenë:

- Regjimentet e Këmbësores;
- GBLK dhe SOLTG;
- Distriktet Detare (Veriut dhe Jugut);
- Regjimenti i Mbështetjes me Luftim;
- Batalioni i Mbrojtjes Kundërajrore;
- Baza Ajrore Kuçovë;
- Baza Ajrore Farkë.

Objektivat për periudhën afatgjatë:

1. Kalimi në operacionalitet të plotë i strukturave të luftimit, të mbështetjes me luftim, strukturave që kompletohen me armatim të ri;

2. Implementimi i *Paketës së objektivave të kapaciteteve*;

3. Arritja e kapaciteteve dhe aftësive të kërkuara.

Strukturat prioritare për këtë periudhë kohore, janë:

- Baza Ajrore Farkë;
- Regjimenti i Mbështetjes me Luftim;
- Batalioni i Mbrojtjes Kundërajrore.

4.2.1 Zhvillimi, menaxhimi dhe motivimi i personelit

Motivimi i personelit të FA-së do të jetë në fokus të veçantë, i cili do të arrihet nëpërmjet meritokracisë, transparencës, trajnimit dinjitoz dhe shpërblimit financiar, arsimimit dhe kualifikimit, përkujdesjes, si dhe përmirësimit të kushteve të punës, stërvitjes e jetesës. Zhvillimi i karrierës së ushtarakut, emërimet dhe gradimet, do të bazohen në performancë, arsimimin e duhur dhe aftësitë e lidershit. Procesi i rekrutimit të personelit ushtarak do të synojë rritjen sasiore dhe cilësore të oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve/detarëve dhe civilëve në

FA. Zhvillimi, menaxhimi dhe motivimi i personelit do të arrihet nëpërmjet arritjes së objektivave sipas afateve.

Objektivat për periudhën afatshkurtër:

- ruajtja e numrit të personelit dhe kompletimi i formacioneve prioritare në strukturat e FARSH-it, duke synuar arritjen e nivelit të kërkuar operacional;

- mbështetja me personel e kapaciteteve të deklaruara për mbrojtjen kolektive dhe e formacioneve në operacione / misione brenda vendit dhe në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së;

- konsolidimi i sistemit të rekrutimit për tërheqjen e kandidatëve cilësorë;

- rritja sasiore dhe cilësore e oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve/detarëve dhe civilëve;

- zhvillimi i sistemit të arsimimit sipas ligjit të arsimit të lartë dhe modelit West Point dhe trajnim kualifikimit;

- integrimi i forcës rezerviste me atë aktive.

Objektivat për periudhën afatmesme:

- konsolidimi i sistemit të arsimimit;

- kompletimi me personel për rritjen e niveleve operacionale të kërkuara;

- rishikimi i procedurave, planeve dhe praktikave në fushën e menaxhimit të personeli;

- zhvillimi i forcës rezerviste.

Objektivat për periudhën afatgjatë:

- konsolidimi i sistemit të arsimimit;

- rritja e numrit të personelit ushtarak aktiv;

- zhvillimi i forcës rezerviste e aftë të marrë dhe realizojë detyra.

Prioritet e zhvillimit të personelit:

- krijimi i një force profesioniste cilësore, e ndërthurur aktive dhe rezerviste e aftë për të përballuar sfidat e kohës;

- konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përkujdesja ndaj personelit;

- mbështetja sociale e personelit nëpërmjet rritjes së mirëqenies; përmirësimit të kushteve të jetesës; kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre, integrimi i ushtarakëve në shoqëri pas daljes nga radhët e FA-së, të krahasueshëm me vendet e NATO-s;

- rritja e profesionalizmit të personelit dhe arritja e një niveli arsimimi konkurrues e të krahasueshëm me vendet e NATO-s;

- zhvillimi i personelit në përputhje me kërkesat për zhvillimin e kapaciteteve.

4.2.2 Arsimit, trajnimit dhe kualifikimi i personelit



Arsimimi, trajnimi dhe kualifikimi i personelit do të mbështetet në programet bashkëkohore që zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA), Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), qendrat stërvitore dhe institucionet arsimore të vendeve partnere dhe aleate jashtë vendit. AFA-ja do të vijojë transformimin si i vetmi institucion ushtarak i arsimit të lartë që do të përgatisë oficerët e ardhshëm të FA-së. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, nëpërmjet kurseve institucionale, do të përgatisë drejtuesit e ardhshëm në të gjitha nivelet dhe oficerë të aftë të punojnë e ndërveprojnë në shtabet dhe operacionet e NATO-s. Arsimimi dhe kualifikimi i personelit nënoficer të FA-së do të vijojë në Qendrën e Arsimit Profesional dhe në qendrat stërvitore të forcave/komandave kryesore.

Në fushën e trajnimit, kualifikimit dhe arsimit të personelit do të realizohen këta objektiva:

Për periudhën afatshkurtër:

- AFA-ja do të vijojë me procesin e riakreditimit institucional/programeve të studimit, duke konsoliduar dhe vënë në eficiencë cilësinë dhe njohjen e diplomës brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;

- konsolidimi i plotë i strukturës dhe programeve të studimit dhe trajnimit të stërvitjes, duke vijuar bashkëpunimin me Akademinë Ushtarake West Point, deri në konsolidimin dhe transformimin e plotë të këtij institucioni arsimor;

- AFA-ja do të forcojë identitetin dhe peshën në zhvillimin e mendimit shkencor ushtarak, duke i paraprirë ndryshimeve në mjedisin e sigurisë, si dhe evolucionin teknologjik.

Për periudhën afatmesme:

- konsolidimi institucional i AFA-së;

- rishikimi dhe përmirësimi i programeve të studimit “bachelor” dhe “master profesional” duke u fokusuar në identifikimin e programeve të reja që mbështesin zhvillimet teknologjike dhe modernizimin e FA-së;

- licencimi dhe hapja e programit të ciklit të dytë të studimeve “master shkencor” në fushën e “sigurisë dhe mbrojtjes” dhe “marrëdhënie ndërkombëtare”;

- Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë do të jetë pjesë e ligjit të institucioneve të arsimit të lartë dhe do të ofrojë kurse institucionale cilësore dhe do të japë diploma master profesional dhe shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Për periudhën afatgjatë:

- zhvillimi i të gjitha cikleve të programeve të studimit (bachelor, master dhe doktoraturë);

- implementimi i projekteve të para kërkimore dhe inovative;

- përmbushja me cilësi e nevojave të FARSH-it për kualifikimin e përgjithshëm dhe me specialitete të oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve dhe civilë.

4.2.3 Zhvillimi i kapaciteteve

Investimet në personel, sisteme dhe pajisje do të përmirësojnë kapacitetet ekzistuese, do të krijojnë kapacitete të reja luftimi, mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime, do të rrisin aftësitë operacionale dhe do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e misionit, detyrave dhe detyrimeve në kuadër të Aleancës. Projektet kryesore, sipas afateve kohore do të mbështesin objektivat kryesorë, si më poshtë:

Objektivat kryesorë për zhvillimin e kapaciteteve për periudhën afatshkurtër:

- rritja e kapaciteteve të luftimit për FT-në, FD-në dhe FAj;

- zhvillimi i kapaciteteve për transport të mesëm ajror;

- fuqizimi i kapaciteteve të mbështetjes me zjarr;

- rritja e lëvizshmërisë dhe mbrojtjes së trupave në operacione dhe misione me mjete taktike të blinduara;

- ngritja e kapaciteteve të sistemeve të drejtuara automatike (UAV, UGV);

- rritja e aftësive të zbulimit (ISTAR/HUMINT);

- zhvillimi i kapaciteteve fikse dhe të lëvizshme të Njësisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike;

- zhvillimi i kapaciteteve për operacionet kundra minave detare në ujëra të cekëta;

- zhvillimi i kapaciteteve për mbështetjen mjekësore ROLE 2;

- rritja e kapaciteteve për përmbushjen e detyrimeve të mbështetjes si vend pritës;

Objektivat kryesorë për zhvillimin e kapaciteteve në periudhën afatmesme:

- rritja më tej e kapaciteteve të luftimit për FT-në, FD-në dhe FAj;

- rritja e kapaciteteve të mbështetjes me zjarr;

- zhvillimi i aftësive të mbrojtjes ajrore;

- përmirësimi më tej i aftësive për transport të mesëm ajror;

- përmirësimi i kapaciteteve të transportit tokësor;



- përmirësimi i kapaciteteve për parapozicionimin dhe magazinimin e vlerave materiale, sipas klasave të furnizimit (kryesisht III&V);

- krijimi i kapaciteteve për mbrojtjen kundërtanke;

- konsolidimi i aftësive të komandim-kontroll (C2);

- zhvillimi i kapaciteteve për mbështetjen mjekësore ROLE 3;

- rritja e kapaciteteve për mbështetjen si vend pritës (Host Nation Support).

Objektivat kryesorë për zhvillimin e kapaciteteve në periudhën afatgjatë:

- konsolidimi i kapaciteteve të luftimit të FT-në, FD-në dhe FAj;

- konsolidimi i kapaciteteve për mbështetjen e luftimit dhe mbështetjen me shërbime të luftimit për forcat kryesore;

- arritja e kapaciteteve të plota për mbështetje me zjarr të forcave të luftimit;

- rritja e kapaciteteve për transportin e mesëm ajror;

- konsolidimi i kapaciteteve të mbrojtjes ajrore;

- rritja e kapaciteteve për zbatimin e detyrave të ligjshmërisë në det;

- sigurimi i kapaciteteve për operacionet e sigurisë së lundrimit në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë;

- rritja e kapaciteteve për vëzhgimin e hapësirës detare dhe ajrore (SIVHD, SIVHA);

- zhvillimi i kapaciteteve për mbrojtjen bregdetare;

- krijimi i kapaciteteve për shkëmbimin e pamjes operacionale të përbashkët dhe informacionit me Aleancën;

- krijimi i kapaciteteve të plota për mbrojtjen kundërtanke;

- zhvillimi i kapaciteteve për mbështetjen mjekësore ROLE 4;

- përmirësimi i kapaciteteve të mirëmbajtjes së mjeteve tokësore, detare dhe ajrore.

4.2.4 Projektet e zhvillimit të infrastrukturës ushtarake

Fatkeqësitë natyrore, siç ishte rasti i tërmetit të vitit 2019, dhe amortizimi i instalimeve ushtarake, bëjnë të domosdoshme investimet në infrastrukturë për përmirësimin e kushteve të punës, jetesës, akomodimit, edukimit dhe stërvitjes së personelit të FA-së.

Gjithashtu, për këtë periudhë, përparësi në mbështetje me buxhetin e nevojshëm do të marrin edhe investimet për rritjen e nivelit të sigurisë dhe ruajtjes së instalimeve, pajisjeve dhe materialeve ushtarake.

Në bazë të nevojave të FA-së, do të vlerësohet dhe do të rishikohet statusi aktual dhe zhvillimet e mundshme të industrisë ushtarake (uzinat dhe kantieret e riparimit), duke i transformuar për t'i bërë ato eficiente dhe efektive.

Strukturat dhe njësitë do të hartojnë dhe përgatisin planet dhe projektet e tyre të zhvillimore për infrastrukturën, duke e shtrirë procesin dhe planet e implementimit sipas prioriteteve.

Objektivat për zhvillimin e infrastrukturës në periudhën afatshkurtër:

- përfundimi i masterplaneve të garnizoneve kryesore dhe fillimi i investimeve për rijetësimin e tyre;

- investimet në infrastrukturë për zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, punës dhe stërvitjes në komandat dhe repartet kryesore:

- Garnizoni Zall-Herr;

- Garnizonet Ferraj;

- Garnizoni Pezë Helmës;

- Repartet e RV dhe RJ.

- modernizimi i infrastrukturës të Bazës Ajrore Kuçovë dhe përfundimi i zhvillimit infrastrukturor të saj;

- ndërtimi i infrastrukturës stërvitore (akomodim, trajnim, simulator, poligon qitje) dhe mbështetëse në Pajet, Bizë dhe në Mnelë;

- zhvillimi i infrastrukturës pritëse dhe akomoduese portuale dhe aereoportuale në Porto-Romano dhe bazën detare Pashaliman;

- zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme logjistike/rezervës, kushtet e jetesës, punës e stërvitjes në komandat dhe repartet kryesore;

- ndërtimi i infrastrukturës akomoduese për stërvitje, materiale, municione, pajisje luftarake dhe mjete teknike;

- transferimi i AFA-së në kampusin e ri universitar;

- zhvillimi i infrastrukturës logjistike, kushtet e jetesës, punës e stërvitjes për funksionimin normal të Batalionit të Mbrojtjes Ajrore;

- zhvillimi i infrastrukturës magazinuese për klasën III dhe V të furnizimit për rezervën



operacionale të FA-së dhe në mbështetje të NATO-s.

Objektivat për zhvillimin e infrastrukturës në periudhën afatmesme:

- ndërtimi i infrastrukturës akomoduese, përmirësimi i kushteve të punës, jetesës dhe stërvitjes për strukturat;

- ndërtimi i infrastrukturës akomoduese për stërvitje, materiale, municione, pajisje luftarake dhe mjete teknike;

- ndërtimi i infrastrukturës për rrjetet inxhinierike për strukturat;

- vijimi dhe përfundimi i zhvillimit të infrastrukturës pritëse dhe akomoduese portuale dhe aereoportuale në Porto-Romano dhe Baza Detare Pashaliman;

- përfundimi i kampusit të ri universitar.

Objektivat për zhvillim në infrastrukturë në periudhën afatgjatë:

- rikonstrukcione të infrastrukturave akomoduese, për punë jetesë, stërvitje, si dhe infrastrukturës së ruajtjes dhe sigurisë;

- vlerësim dhe rivlerësim i projekteve të reja në infrastrukturë, sipas ecurisë së zhvillimit të strukturave;

- përfundimi i infrastrukturës akomoduese, përmirësimi i kushteve të punës, jetesës dhe stërvitjes për të gjitha strukturat e FA-së.

4.2.5 Mbështetja logjistike

Mbështetja logjistike e FARSH-it do të synojë sigurimin e kapaciteteve logjistike të domosdoshme për t'ju përgjigjur nevojave për mbështetjen e aktivitetit të përditshëm të FARSH-it, misioneve, operacioneve dhe stërvitjeve brenda dhe jashtë vendit, si dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare. Pjesë e pandarë e mbështetjes logjistike do të jenë detyrimet apo kërkesat që rrjedhin nga zbatimi i objektivave të kapaciteteve të mbrojtjes.

Objektivat e mbështetjes logjistike për periudhën afatshkurtër:

- sigurimi i transportit strategjik (ajror, detar, tokësor dhe i kombinuar) për dislokimin/ridislokimin e trupave, nëpërmjet operatorëve të brendshëm, bashkëpunimit me Qendrën e Koordinimit të Lëvizjes në Evropë dhe marrëveshjeve bilaterale;

- hartimi i konceptit të rezervës materiale për situata të jashtëzakonshme. Planifikimi i rezervave për furnizim të FA-së, do të jetë sipas kërkesave, ndërsa gjendja e materialeve, transferimi,

identifikimi i nevojave dhe ndjekja e ciklit jetësor do të jetë një proces i vazhdueshëm;

- përmirësimi i kapaciteteve magazinuese për parapozicionimin e materialeve në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

- përmirësimi i sistemeve dhe sigurimi i mirëmbajtjes afatgjatë të mjeteve tokësore, detare, ajrore;

- rritja e aftësive operacionale për mbështetjen shëndetësore të trupave në nivelet taktike, operacionale dhe strategjike;

- aftësimi dhe konsolidimi i shërbimit mjekësor parandalues, dentar, farmaceutik, klinik dhe laboratorik;

- rritja dhe konsolidimi i kapaciteteve për reagimin ndaj emergjencave natyrore dhe atyre humanitare;

- zhvillimi i kapaciteteve operacionale, për mbështetjen me shërbime logjistike të strukturave të angazhuara në operacione luftarake dhe joluftarake;

- ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve operacionale për emergjenca civile, kërkim-shpëtimi dhe operacione humanitare në ndihmë të komunitetit;

- modernizimi i sistemeve dhe pajisjeve të KM-së dhe mbështetja për përmirësimin e infrastrukturës në strukturat e FA-së.

Objektivat e mbështetjes logjistike për periudhën afatmesme:

- zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve për mbështetjen e përgjithshme dhe të specifikuar me shërbime të luftimit;

- rritja e kapaciteteve magazinuese për parapozicionimin e materialeve në mbështetje të operacioneve të NATO-s;

- zhvillimi i kapaciteteve dhe strukturës për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, emergjencave civile, operacioneve humanitare dhe të kapaciteteve xheniere, EOD për mbrojtjen e forcave dhe instalimeve ushtarake;

- planifikimi i mbështetjes logjistike dhe mbështetja e rezervës operacionale për t'u angazhuar sipas planeve kombëtare dhe detyrimeve të NATO-s;

- përmirësimi i mbështetjes në tri nivele (taktik, operacional dhe atë strategjik);

- rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve lëvizëse tokësore si për transportin taktik të trupave ashtu dhe për transportin e materialeve logjistike;

- vijimi i implementimit të konceptit të rezervës materiale për situata të jashtëzakonshme, duke



alternuar shtimin e rezervës me procesin e rifreskimit të saj;

- kompletimi i gjithë strukturave me armatim të ri dhe municione (standard NATO).

Objektivat e mbështetjes logjistike për periudhën afatgjatë:

- krijimi i një strukture në mbështetje të forcës ushtarake dhe të popullsisë civile, e cila plotëson detyrimet në kuadrin e angazhimeve kombëtare dhe në përbërje të Aleancës;

- konsolidimi i mbështetjes në 3 nivele të mbështetjes;

- arritja e kapaciteteve të plota për t'u vënë në dispozicion të NATO-s në operacionet/angazhimet e drejtuara prej saj, si dhe për të kontribuar në misione të BE-së dhe OKB-së;

- vijimi i kompletimit të konceptit të rezervës materiale për situata të jashtëzakonshme;

- kompletimi me infrastrukturë magazinuese për klasat e furnizimit dhe vendqëndrimet e pajisjeve dhe mjeteve;

- konsolidimi i sistemit të mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të Forcat e Armatosura në kuadër të procesit të modernizimit dhe bashkëpunimit me aleatët.

Mbështetja e vendit pritës (HNS)

Mbështetja e vendit pritës (HNS) është koncept thelbësor i operacioneve ushtarake, që shtrihet përtej detyrave dhe përgjegjësive të Forcave të Armatosura. Ky koncept përfshin bashkëpunimin dhe ndihmën që një vend pritës u ofron forcave të huaja ushtarake që kalojnë transit ose janë të vendosura brenda kufijve të tij. Kjo mbështetje është e domosdoshme për suksesin e misioneve ushtarake, pasi mbulon një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë logjistikën, infrastrukturën, sigurinë, madje edhe aspektet diplomatike.

Forcat e Armatosura, krahas rolit që kanë në ofrimin e mbrojtjes së këtyre forcave, mbështetjes me shërbime logjistike dhe infrastrukturën e duhur për pritjen, magazinimin, konsolidimin dhe lëvizjen përpara të tyre, janë koordinatori kryesor për ofrimin e mbështetjes së vendit pritës nga strukturat e pushtetit qendror dhe lokal.

KREU V

KAPACITETET E ARDHSHEMË TË FA-së

Forcat e Armatosura janë organizuar, përgatiten dhe funksionojnë sipas principeve themelore të

ndërtimit e funksionimit të organizmave ushtarakë në shoqëritë demokratike që, pavarësisht madhësisë, janë të afta të përmbushin misionin e tyre. Struktura organizative e FARSH-it është zhvilluar duke u mbështetur në nevojat për mbrojtjen e pavarësisë dhe sovranitetit të vendit që rrjedhin nga ndryshimet në ambientin e sigurisë, qoftë ajo rajonale apo globale, dhe kërkesat e Aleancës për mbrojtjen kolektive.

Forcat e Armatosura, sipas Kushtetutës, organizohen në tri komanda kryesore forcash: Forca Tokësore, Detare dhe Ajrore. Deri më 2033-shin këto forca do të arrijnë kapacitete të plota operacionale dhe do të jenë të ndërveprueshme me NATO-n dhe BE-në.

Në realizimin e misionit dhe detyrave, komandat e forcave mbështeten nga Komanda Mbështetëse (KM), Akademia e Forcave të Armatosura dhe strukturat e vartësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Rishikimi i strukturës së FA-së është proces i vijueshëm, ku ndryshimet bëhen të nevojshme sa herë që kërkohen ndryshime apo përshtatje në kapacitete dhe aftësi.

Struktura e FA-së parashikon një sistem komandimi e drejtimi operacional të thjeshtë e të zhdërvjellët. Shtabi i Përgjithshëm i FA-së përbën strukturën organizative më të lartë ushtarake në Forcat e Armatosura dhe kryen komandim të unifikuar të FA-së. Ai vepron si shtab i bashkuar i forcave tokësore, detare, ajrore dhe strukturave mbështetëse.

Në raport me përfituesit e kontributeve operacionale, si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, Forcat e Armatosura luajnë rolin e gjeneruesit të forcës. Sipas këtij koncepti, Forcat e Armatosura krijojnë dhe mbajnë në gatishmëri kapacitete operacionale ushtarake për t'i vënë në dispozicion të përdoruesve potencialë, kombëtarë apo ndërkombëtarë, të cilët kryejnë funksionin e përdoruesit të forcës. Brenda vetë Forcave të Armatosura, komandat e forcave, njësisë dhe strukturave të tjera të FA-së kryejnë funksionin e gjeneruesit të forcës dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së merr funksionin e përdoruesit të forcës. Angazhimi i FA-së në operacione të ndryshme realizohet përmes grupeve operacionale (*joint/task force*) me forca dhe autoritet të deleguar në kohë dhe hapësirë sipas angazhimit.

5.1 Forca Tokësore



Për të zhvilluar kapacitetet, sipas këtij plani, struktura e Forcës Tokësore (FT) do të përbëhet nga:

- Komanda dhe Shtabi i Forcës Tokësore;
- Regjimenti i Këmbësisë së Veriut;
- Regjimenti i Këmbësisë së Jugut;
- Grup-Batalioni i Këmbësisë së Lehtë (GBKL);
- Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS);
- Regjimenti i Mbështetjes me Luftim (RML);
- Batalioni i Mbështetjes me Shërbime të Luftimit (bMSHL);
- Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore (QSFT);
- Elementi i bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Planvendosja e strukturave të FT-së do të jetë sipas planvendosjes respektive të miratuar.

Kapacitetet e luftimit të FT-së

Kapacitetet e luftimit përfaqësojnë aftësitë kryesore të FT-së për të kryer operacione luftarake dhe joluftarake. Këto kapacitete përfshijnë njësitë e luftimit të cilat janë krijuar dhe zhvillohen, organizohen, pajisen dhe stërviten për zhvillimin e operacioneve luftarake, për të siguruar sovranitetin dhe integritetin e vendit, deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare apo aktivizimin e nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit. Bazën e kapaciteteve të luftimit e përbëjnë batalionet e luftimit të Forcës Tokësore.

Kapacitetet kryesore të luftimit të FT-së përbëhen nga:

- Grup-Batalioni i Këmbësisë së Lehtë;
- Regjimenti i Këmbësisë së Veriut (b1k, b2k dhe b3k);
- Regjimenti i Këmbësisë së Jugut (b1k, b2k dhe b3k);
- Regjimenti i Operacioneve Speciale.

Grup-Batalioni i Këmbësisë së Lehtë (GBKL / INF-L-BN) do të zhvillohet sipas konceptit “task-force”, i cili formohet nga bashkimi i kapaciteteve ushtarake me bërthamë kryesore b2k, nga kapacitete të mbështetjes me luftim të bML dhe ROS të Forcës Tokësore, Forcës Ajrore dhe nga kapacitete të mbështetjes me shërbime të luftimit nga Komanda Mbështetëse dhe Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit dhe aktivizohet në situatë paqe (për trajnim dhe stërvitje), krize (për prezencë dhe tregim force) ose lufte (për operacione kombëtare sipas konceptit të operacionit nga komandanti i FT-së ose ndërkombëtare në kuadër të Forcës së Reagimit të Aleancës (ARF) sipas Modelit

të Ri të Forcës), sipas nenit 5 dhe jashtë nenit 5 të NATO-s).

Grupi për Detyrë i Operacioneve Speciale Tokësore (SOLTG) do të rrisë më tej kapacitetet aktuale operacionale dhe do të krijojë kapacitete të reja, për angazhim kombëtar dhe në kuadër të FS-së të Aleancës, për kryerjen e misionit dhe detyrave duke arritur ndërveprueshmëri të plotë, brenda periudhës së këtij plani, të forcave tona me ato të shteteve anëtare të NATO-s, si në stërvitje të përbashkëta, ashtu edhe në misionet luftarake e joluftarake të forcave speciale.

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit të FT-së.

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përfaqësojnë aftësitë e FT për të mbështetur operacionet në përmbushje të misionit dhe detyrave. Ato gjenerohen dhe realizohen nga strukturat e mbështetjes së luftimit të FT-së.

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përbëhen nga kapacitetet e mbështetjes me fuqi zjarri dhe kapacitete të tjera të mbështetjes së luftimit, si mbrojtja nga armët e dëmtimit në masë, mbështetja xheniere e luftimit, mbështetja me zjarr indirekt, mbrojtja e afërt ajrore, HUMINT/ISTAR dhe komandim-kontrolli e komunikimi.

Për të rritur fuqinë dhe efektivitetin e zjarrit ndaj reparteve të manovrës, si dhe përmirësimin e raportit të forcave të mbështetjes me luftim të FT-së, fillimisht do të krijohen kapacitetet operacionale fillestare të Regjimentit të Mbështetjes me Luftim (RML), i cili gradualisht gjatë periudhës afatmesme do të kompletohet me personel, sisteme dhe pajisje, me kapacitete zjarri direkt dhe indirekt, kundërajrore, xheniere, kimie etj. Qëllimi është që RML të arrijë operacionalitet të plotë brenda 2033.

Kapacitetet aktuale dhe ato që do të zhvillohen sipas prioriteteve dhe periudhave të zhvillimit të FT-së, janë:

- kapacitete të mbështetjes me zjarr direkt dhe indirekt;
- kompletim me armatim, municion dhe pajisje komunikimi;
- kapacitete të mbrojtjes ajrore (V-SHORAD, M-RAD);
- kapacitete UAS dhe C-UAS;
- kapacitete xheniere dhe EOD;
- Mbrojtja ndaj Armëve të Dëmtimit në Masë (MADM);
- kapacitetet e zbulimit HUMINT dhe ISTAR;



- kapacitetet e kompanive të mbështetjes së luftimit të R1K, R2K, ROS, RML, GBKL;

- kapacitetet e komunikimit-komandim-kontrollit të komandës dhe shtabit të FT-së.

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit të Forcës Tokësore

Në këto kapacitete përfshihen kapacitetet e furnizimit, transportit, mirëmbajtjes, kujdesit shëndetësor, rigjenerimit të personelit, kujdesit psikologjik dhe të administrimit.

- elementet e mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve;

- kompania e furnizimit dhe transportit (bMSH);

- kompania e mirëmbajtjes dhe shërbimeve (bMSH);

- kompanitë e mbështetjes së reparteve b1k, b2k, b3k, ROS dhe bML;

- kapacitetet shëndetësore Rol-1⁺ (bMSH);

- elementet e operacioneve psikologjike;

- elementet e bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Kapacitetet e Forcës Tokësore, sipas afateve kohore, do të zhvillohen, si vijon:

Në periudhën afatshkurtër:

- kompletimi me armatim individual/kolektiv dhe aksesore, pajime dhe pajisje të avancuara luftimi, pajisje EOD, xheniere, MADM dhe pajisje komunikimi, zbulimi dhe sigurisë/ISTAR etj., të reparteve të deklaruara operacionale;

- krijimi i kapaciteteve fillestare të fuqisë së zjarrit me Artileri Tokësore (AT) të kalibrave 105 mm dhe 155 mm në RML;

- zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes ajrore (V-SHORAD, M-RAD) dhe krijimi i kapaciteteve të plota operacionale për mbrojtjen e afërt ajrore (V-SHORAD) të GBKL;

- sisteme stacionare dhe të lëvizshme për zbulimin dhe neutralizimin e objekteve fluturuese pa pilotë (C-UAV);

- zhvillimi i kapaciteteve kundërtanke;

- zhvillimi i kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile;

- mjete transporti, mjete speciale dhe ato të blinduara/taktike;

- kompletimi dhe vënia në funksion të plotë operacional të sistemit të menaxhimit në fushëbetejë të K2 (Battle Management System/CIS) për GBKL dhe SOLTG;

- përmirësimi i infrastrukturës në repartet dhe rajonet/poligonet e stërvitjes të Forcës Tokësore;

- zhvillimi i elementeve të bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Në periudhën afatmesme:

- fillimi i kompletimit me transportues të blinduar (IFV/APC) për dy kompani manovre;

- vijimi i kompletimit me armatim, sisteme dhe pajisje të R1K, R2K dhe RML;

- vijimi i modernizimit me sisteme të fuqisë së zjarrit AT të RML;

- vijimi i modernizimit me mjete të blinduara/taktike për ROS, R1K, R2K dhe RML;

- krijimi i kapaciteteve të plota operacionale (FOC) të Qendrës Shëndetësore ROLE-2;

- certifikimi SOFEVAL i SOLTG nga NSHQ/SHPFA, me statusin “*Combat Ready*”;

- konsolidimi i kapaciteteve operacionale në GrBKL (FOC).

Në periudhën afatgjatë:

- krijimi i kapaciteteve të plota operacionale të luftimit, mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit (personel, stërvitje, pajisje dhe resurse, sipas kërkesave dhe standardeve të Aleancës, për të gjitha strukturat e FT-së;

- kompletimi me transportues të blinduar (IFV) për dy kompani manovre;

- realizimi i të gjitha kërkesave të objektivave të kapaciteteve (*Capability Targets*);

- kompletimi dhe vënia në funksion të plotë operacional i batalionit të përzier të AT (me kalibra 105 mm dhe 155 mm;

- kompletimi dhe vënia në funksion të plotë operacional të mjeteve të avancuara të MADM, xhenios, zbulimit, ndërlidhjes etj., në RML dhe repartet operacionale të FT-së;

- kompletimi dhe vënia në funksion të plotë operacional të sistemeve të mbrojtjes ajrore raketore (V-SHORAD, M-RAD) në Regjimentet e Këmbësisë (VJ) dhe ROS;

- kompletimi me sisteme të avancuara zbulimi dhe sisteme kundër mjeteve të fluturimit pa pilotë (C-UAS).

Gjendja e dëshiruar për Forcën Tokësore në fund të periudhës së këtij plani është që ajo të jetë një forcë e kompletuar, e mirëtrajnuar, e motivuar, e ndërveprueshme dhe e aftë për dislokim/ridislokim, qëndrueshmëri, brenda dhe jashtë vendit, për të kryer detyra luftarake dhe joluftarake, edhe në kushte ekstreme moti, në realizimin e misionit kushtetues dhe detyrimeve ndaj NATO-s, sipas



kërkesave e detyrimeve të nenit 3 dhe nenit 5, të Traktatit të Uashingtonit, BE-së dhe OKB-së.

5.2 Forca Detare

Për të zhvilluar kapacitetet, sipas këtij plani, struktura e Forcës Detare (FD) do të përbëhet nga:

- Distrikti Detar Jugor;
- Distrikti Detar Verior;
- Qendra e Vëzhgimit Detar;
- Qendra e Zhytjes;
- Shërbimi Hidrografik;
- Qendra e Stërvitjes Bazë Detare.

Planvendosja e strukturave të FD-së do të jetë sipas planvendosjes respektive të miratuar.

Kapacitetet e luftimit të Forcës Detare.

Distriktet detare përbëhen nga bazat detare, vendbazimet dhe anijet, të cilat janë kapacitetet kryesore operacionale për realizimin e operacioneve, në përmbushje të misionit dhe detyrave të FD-së. Distriktet Detare përmbushin misionin dhe detyrat duke përdorur kapacitetet dhe burimet nëpërmjet prezencës së përhershme në hapësirën detare dhe gatishmërisë për t'ju përgjigjur në kohë, ku dhe kur e kërkon situata. Ato përgjigjen për trajnimin dhe stërvitjen e ekuipazheve të anijeve dhe grupeve të bordingut, si dhe luajnë rolin e gjeneruesit të forcës në operacionet e drejtuara nga struktura të tjera shtetërore.

Në përmbushje të misionit të FD-së, distriktet detare mbajnë kapacitetet në gatishmëri 24/7, si forca të reagimit të menjëhershëm në rast të cenimit të sigurisë territoriale apo detyra të tjera me karakter civil.

Në përbërje të distrikteve detare është edhe Grupi i Bordingut, i cili është i vendosur pranë vendbazimeve detare dhe në afërsi të anijeve të gatshme, me qëllim reagimin sa më shpejt në rast nevojë. Koncepti operacional i përdorimit të Grupit të Bordingut është reagimi dhe bordimi i anijeve deri në nivel kundërshtues.

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit të Forcës Detare.

Kapacitetet për njohjen e situatës detare. Bazë për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit do të vijojë të jetë Qendra e Vëzhgimit Detar, nëpërmjet sistemit të radarëve të SIVHD dhe personelit të PRT-ve, patrullimeve të anijeve në hapësirën detare shqiptare, marrjes së informacionit nga MARCOM mbi anijet e interesit etj.

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) është ndër burimet kryesore për

marrijen e informacionit për njohjen e situatës detare të vendit, i cili kërkon rinovimin teknologjik dhe modernizimin e vazhdueshëm të sistemeve të saj. Ky sistem do të përbëjë bazën për integrimin në nivel kombëtar të informacionit mbi situatën detare në një rrjet të vetëm, me qëllim krijimin e tablosë së përbashkët detare, e cila do të shërbejë jo vetëm për strukturat e Forcës Detare, por edhe për aktorët e tjerë në nivel kombëtar nëpërmjet QNOD-së, por gjithashtu edhe për strukturat e NATO-s dhe vendet partnere, në kuadër të nismave rajonale.

Qendra e Zhytjeve do të modernizohet me ambiente të reja për punën dhe trajnimin e personelit, pajisje speciale për operacionet e zhytjes dhe të luftës kundra minave detare, kapacitete për kryerjen e operacioneve EOD, si dhe detyra të tjera në kuadër të ruajtjes së infrastrukturës kritike detare dhe nënujore në zonën detare të përgjegjësisë së Forcës Detare. Detyrimet në kuadër të Aleancës përfshijnë krijimin e një strukture brenda Qendrës së Zhytjes, e cila do të shërbejë për pjesëmarrjen në Operacionet e Luftës kundër Minave në Ujëra Shumë të Cekëta të Aleancës (Very Shallow Waters Mine Countermeasures Operations). Zhvillimi i kësaj strukture ndërthuret me projektin e modernizimit me anije shumëfunksionalëshe me kapacitetet e nevojshme për mbështetjen dhe kryerjen e detyrave të kësaj strukture, si dhe Qendrën për Menaxhimin e të Dhënave të Luftës me Mina të Shërbimit Hidrografik.

Grupi i Bordingut. Është një element i rëndësishëm për zbatimin e ligjshmërisë në hapësirën detare. Grupi i bordingut trajnohet dhe kryen detyrat për kalimin e flamurit dhe kontrollin e anijeve dhe mjeteve detare të cilat kryejnë aktivitetet në hapësirën detare shqiptare. Grupi i bordingut do të zhvillohet dhe do të modernizohet me sisteme e pajisje me qëllim kryerjen e sigurt dhe me efikasitet të operacioneve të bordimit deri në nivel kundërshtues.

Kapacitete të mbështetjes me shërbime të luftimit të Forcës Detare:

Shërbimi Hidrografik Shqiptar siguron kushtet për lundrim të sigurt në hapësirën territoriale detare dhe kryen studime të karakterit hidrografik dhe hidrologjik të bregdetit shqiptar, relievit dhe fundit të detit, si dhe bashkëpunon me Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake për përgatitjen e hartave detare, udhëzuesve të lundrimit dhe manualit të faro-fenerëve. Modernizimi i



mëtejshëm i këtij shërbimi do të rrisë sigurinë e lundrimit në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë. Shërbimi Hidrografik përfshin në strukturën e saj Qendrën për Menaxhimin e të Dhënave të Luftës me Mina, e cila siguron mbledhjen, përpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për luftën kundër minave detare, duke kontribuar në operacionet detare të Aleancës.

Qendra Stërvitore e Forcës Detare do të zhvillohet më tej për t'ju përgjigjur nevojave për arsimimin dhe trajnimin të personelit për kryerjen e detyrave në llojet e luftërave (luftës detare sipërfaqësore, luftës detare kundërajrore, luftës detare nënujore dhe elektronike), për të cilat anijet e ardhshme do të kenë aftësi luftimi. Teknologjia e re dhe moderne me të cilën anijet e reja do të jenë të pajisura, kërkojnë përshtatje dhe zhvillim me qëllim aftësimin e personelit për përdorimin e saj në mënyrë efektive. Gjithashtu, Qendra Stërvitore e FD-së do të zhvillohet në qendër kombëtare të trajnimit të personelit të institucioneve me interesa në det për zbatimin e ligjshmërisë detare.

Zhvillimi i kapaciteteve të Forcës Detare sipas periudhave, do të jetë:

Në periudhën afatshkurtër:

- fillimi i programit për sigurimin e anijes patrulluese luftarake;
- modernizimi i Grupit të Bordingut (armatim, pajisje komunikimi, pajisje bllokuese, pajisje taktike, pajisje elektronike, MADM etj);
- modernizimi me pajisje të specializuara për operacionet kundër minave detare në ujëra të cekëta;
- rinovimi teknologjik i Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) dhe mirëmbajtja e saj;
- sigurimi i mirëmbajtjes së anijeve të Forcës Detare;
- përmirësimi i infrastrukturë dhe sigurisë fizike në bazat detare;
- rritja e kapaciteteve të kërkim-shpëtimit dhe zbulimit detar.

Në periudhën afatmesme:

- vijimi i projektit për sigurimin e anijes patrulluese luftarake;
- fillimi i programit për kompletim me anije të mesme patrulluese, pjesë e projektit për kompletim me gjashtë të tilla;
- përfundimi i projektit të modernizimit me pajisje të specializuara për operacionet kundër minave detare në ujëra të cekëta;

- mbajtja në gatishmëri tekniko-operacionale e Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare;

- mirëmbajtja e anijeve në gatishmëri tekniko-operacionale.

Në periudhën afatgjatë:

- përfundimi i projektit të modernizimit me anije të mesme patrulluese;

- modernizimi me anije shumë funksionalëshe për mbështetjen e operacioneve të Qendrës së Zhytjes dhe Shërbimit Hidrografik;

- mbajtja në gatishmëri tekniko-operacionale e Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare;

- mirëmbajtja e anijeve në gatishmëri tekniko-operacionale.

Gjendja e dëshiruar për Forcën Detare në fund të periudhës së këtij plani është që ajo në bashkëpunim me strukturat e tjera të FARSH, sipas detyrimit kushtetues, të jetë e aftë të sigurojë dhe ruaj sovranitetin e hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe zbatimin e ligjshmërisë në të. Në këtë mënyrë Forca Detare do të jetë në gjendje të mbështesë interesat kombëtarë të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë të lidhura me hapësirën detare. Zhvillimi i këtyre kapaciteteve do ta bëjë Forcën Detare plotësisht të ndërveprueshme me Aleancën dhe të aftë për të dhënë kontribut cilësor në operacionet dhe misionet e NATO-s.

5.3 Forca Ajrore

Për të zhvilluar kapacitetet, sipas këtij plani, struktura e Forcës Ajrore (FAj), do të përbëhet nga:

- Komanda dhe Shtabi;
- Kompania e Mbështetjes së Shtabit;
- Qendra e Kontroll-Raportimit;
- Qendra Stërvitore;
- Baza Ajrore Kuçovë;
- Baza Ajrore Farkë;
- Shërbimi Meteorologjik Ushtarak;
- Detashmenti i Avionëve pa Pilotë (UAS);
- Batalioni i Mbrojtjes Ajrore të Bazuar në Tokë (GBAD).

Planvendosja e strukturave të FAj do të jetë sipas planvendosjes respektive të miratuar.

Kapacitetet e luftimit të FAj.

Baza Ajrore Farkë ka kapacitete në gatishmëri për përmbushjen e detyrave luftarake dhe atyre stërvitore, mbështet FARSH-in me transport trupash dhe materialesh, kryen operacione humanitare në ndihmë të popullsisë, operacione të kërkim - shpëtimit dhe mbështet operacionet e zbulimit ajror dhe rikonicionit. Objektivi i zhvillimit



të kapaciteteve të Bazës do të fokusohet në përmbushjen e detyrimit kombëtar për kryerjen e shërbimeve SAR, MEDEVAC, VIP, EC, transport trupash, si dhe detyrimit për të kontribuar me helikopterë dhe ekuipazhe të afta për t'u dislokuar në një zonë ku zhvillohet një operacion i drejtuar nga NATO-ja.

Modernizimi i Bazës Ajrore Farkë me helikopterë Blackhawk rrit gradualisht nivelin e operacionalitetit të kësaj baze. Shfrytëzimi i sistemeve moderne të komunikimit, navigimit, dhe alertit të helikopterëve në bashkëpunim me Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) janë prioritet të stërvitjes ajrore që synojnë rritjen e sigurisë së fluturimit në kushte të vështira meteorologjike ditën dhe natën.

Baza Ajrore Kuçovë aktualisht shërben si Bazë Ajrore për Mbështetjen e Vendit Pritës (Host Nation Support-HNS). Synimi për një periudhë afatmesme do të jetë funksionimi i plotë operacional i kësaj baze si Bazë "TACAIR" në inventarin e NATO-s. Përmirësimi i infrastrukturës së kësaj baze do të sjellë shfrytëzimin e saj për kapacitetet kombëtare ISTAR, si dhe për mjetet ajrore me krah të lëvizshëm të transportit të mesëm.

Batalioni i Mbrojtjes Ajrore të Bazuar në Tokë (GBAD) si strukturë e re ka për qëllim krijimin e kapaciteteve të FARSH-it dhe ato kombëtare për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Objektivi përfundimtar do të jetë krijimi i kapaciteteve optimale për mbrojtjen e hapësirës ajrore, popullatës, infrastrukturës kritike, si dhe objekteve të rëndësishme të veçantë.

Kapacitete të mbështetjes së luftimit të Forcës Ajrore:

Detashmenti i Avionëve pa Pilotë (UAV) përbëhet nga mjete ajrore pa pilotë të armatosur dhe të paarmatosur. Mjetet do të përdoren në të gjitha llojet e operacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. Mjetet e paarmatosura do të shërbejnë për përdorim edhe nga agjenci të tjera ligjzbatuese të Republikës së Shqipërisë për monitorim të terrenit dhe hapësirës ajrore. Ndërsa mjetet e armatosura do të përdoren nga FARSH-i, sipas planeve respektive.

Kapacitete të mbështetjes me shërbime të luftimit të Forcës Ajrore:

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak funksionon sipas standardeve ndërkombëtare, duke shfrytëzuar hartat e modeleve matematikore për parashikimin e motit dhe siguron informacion të nevojshëm mbi kushtet

meteorologjike në interes të operacioneve të FA-së, të institucioneve të tjera dhe në interes të komunitetit. Rrjeti i vrojtimit të shërbimit meteorologjik përbëhet nga 14 stacione, disa prej të cilave janë të kompletuara me kapacitete të reja që mundëson memorizimin dhe leximin e të dhënave në mënyrë automatike. Për vitet në vazhdim parashikohet ndërtimi i qendrave të reja sinoptike, i një stacioni meteorologjik në Korçë, si dhe kompletimi me stacione të tjera meteorologjike automatike, malore, hidrometeorologjike etj.

Qendra Stërvitore e Forcës Ajrore do të konsolidohet për të zbatuar me cilësi konceptin "Train the Trainers", duke trajnuar jo vetëm pilotë e mirëmbajtës të teknikës ajrore, por edhe kontrollorë të trafikut ajror, kontrollorë të mbrojtjes ajrore/menaxherëve të betejës ajrore, teknikë dhe operator GBAD, teknikë dhe operator UAV, mirëmbajtës dhe operues radari, mirëmbajtës dhe operues të sistemeve të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, meteorolog etj.

Zhvillimi i kapaciteteve të FAj planifikohet të realizohet sipas fazave të mëposhtme:

Në periudhën afatshkurtër:

- kompletimit me helikopterë "*Blackhawk*" si nevojë për mbështetjen e aktiviteteve të përditshme të FA-së, në rast krize e lufte, por dhe si mjet transporti taktik për evakuim aeromjekësor, komandim dhe kontroll, dhe mbështetje të operacioneve speciale, operacioneve luftarake, EC dhe SAR;

- realizimi i investimit të NATO-s në BA Kuçovë;

- instalimi i sistemeve NAVAIDS/CIS në BA Kuçovë;

- zhvillimi i GBAD (*Ground Based Air Defence*);

- zhvillimi i kapaciteteve UAS;

- integrimi i plotë në NATINAMDS, fillimisht duke prodhuar RAP (*Recognized Air Picture*), shkëmbyer atë, dhe me instalimin e radiorritit Tokë - Ajër - Tokë, duke ushtruar edhe kontrollin taktik ndaj avionëve të NATO-s që kryejnë "Policimin Ajror" në FARSH; transponderi ushtarak MOD 5-IFF;

- rritja e kapaciteteve operacionale të helikopterëve, duke mundësuar mbajtjen në gatishmëri të tyre 365/7/24 në tri "role", një për MEDEVAC/ambulancë ajrore, një për kërkim - shpëtim (SAR) dhe një në versionin "shumërolesh" (2024⁺).



Në periudhën afatmesme:

- arritja e statusit të BA Kuçovë si Bazë “TACAIR” e NATO-s;
- vazhdimi i kompletimit me helikopterë tip “Blackhawk”;
- rritja e operacionalitetit dhe rritja e kapaciteteve për përdorimin e helikopterëve në kushte të kufizuara të shikimit ditën, natën dhe kushte të vështira të motit (365/7/24);
- rritjen e kapaciteteve të dedikuara për operacione kërkim-shpëtimi dhe MEDEVAC;
- përmirësimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë (kompletimi me 2 radarë të lëvizshëm);
- zhvillimi dhe konsolidimi më tej i sistemeve të mbrojtjes ajrore të bazuar në tokë;
- zhvillimi dhe konsolidimi i kapaciteteve UAS;
- zhvillimi i kapaciteteve për ushtrimin e plotë të kontrollit taktik ndaj avionëve të Aleancës/partnerëve që kryejnë policimin ajror (*air policing*).

Në periudhën afatgjatë:

- përmirësimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë (kompletimi me 2 radarë të lëvizshëm);
- krijimi i të gjithë kushteve për kryerjen /ushtrimin e të gjitha përgjegjësive kombëtare në kuadër të NATINAMADS/NIAMDS;
- zhvillimi i kapaciteteve “ekspedituese” dhe “modulare” të helikopterëve të Forcës Ajrore;
- shndërrimi i infrastrukturës së FAj në një “hub” stërvitor ajror të Aleancës/Partnerëve.

Në fund të periudhës së këtij plani, FAj do të ketë plotësuar detyrimet për përfshirjen e Bazës Ajrore Kuçovë në inventarin e Bazave Ajrore Taktike të Aleancës, si dhe do të ketë kapacitetet e duhura për mbështetjen e operacioneve luftarake të FT-së dhe FD-së. Kryerja e operacioneve humanitare dhe atyre të kërkim-shpëtimit do të jetë me kapacitete më të plota.

5.4 Arsimiti, stërvitja dhe trajnimi në FARSH

5.4.1 Arsimi

- Personeli oficer

Sistemi i arsimit dhe trajnimit të personelit do të zhvillohet dhe do të konsolidohet, me qëllim që t’i paraprijë kërkesave dhe prirjeve të transformimit, ndryshimeve në doktrina, pajisje dhe teknologji, rritjes së kapaciteteve operacionale të strukturave të Forcave të Armatosura, si dhe përmbushjes së

misionit të detyrave të sotme dhe të ardhmes në FA, në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për personelin oficer dhe civil arsimi ofrohet nga Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) dhe Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS). Qëllimi është krijimi i një trupe oficerësh lider, të cilët të jenë të aftë të marrin përgjegjësi drejtimi dhe komandimi, për të përmbushur me sukses misionin në të gjitha situatat e mundshme, brenda dhe jashtë vendit. Trupa e oficerëve do të jetë e aftë për t’u përballur me sfidat që ofron koha, e motivuar dhe të transmetojë vlerat më të mira në FA.

Përgatitja e oficerëve është një proces i vazhdueshëm. Pas titullimit “oficer aktiv” dhe gradimit “nëntoger/nënlejtënant”, oficerët kalojnë nëpër kurse të caktuara formimi dhe kualifikimi, të cilat janë të domosdoshme si për thellimin e njohurive e përgatitjen e tyre profesionale, ashtu edhe për zhvillimin e karrierës ushtarake.

Programe studimi që ndjekin kandidatët për oficerë, janë:

- Programe *bachelor*;
- Kursi i përgatitjes së oficerit (KPO);

Programe studimi/kurse që ndjekin oficerët dhe civilët:

- Master profesional;
 - Master i shkencave;
 - Kursi i lartë për sigurinë dhe mbrojtjen.
- Kurset institucionale që ndjekin oficerët janë:
- Kursi bazë i oficerit;
 - Kursi i avancuar i oficerit;
 - Kursi themelor i oficerit;
 - Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm;
 - Kursi i lartë i oficerit;
 - Kursi i lartë për sigurinë dhe mbrojtjen.

Akademia e Forcave të Armatosura

Struktura e AFA përbëhet nga:

- Rektorati dhe drejtoritë e AFA-së;
- Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë;
- Instituti i Kërkimit Shkencor Ushtarak;
- Qendra e Arsimitit Profesional të Nënoficerit;
- Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarit;
- Qendra e Simulimit.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) do të vijojë të jetë institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare,⁸ dhe njëherazi institucioni përgjegjës për përgatitjen e kualifikimin e oficerëve të rinj, trupës së nënoficerëve dhe stërvitjen bazë dhe të avancuar të trupës së ushtarëve që i bashkohen Forcave të



Armatosura. Riorganizimi dhe strukturimi sipas përcaktimeve të urdhrit të Kryeministrit⁹ të Republikës së Shqipërisë dhe urdhrit të ministrit të Mbrojtjes,¹⁰ i paraprin transformimit të AFA-së sipas modelit të Akademisë West Point dhe fillimit të programit “bachelor”. AFA-ja është e fokusuar për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor i bazuar në parimet e profesionalizmit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të FARSH-it, si dhe në përmbushjen e misionit të tyre. Objektivi kryesor është rritja e cilësisë së arsimit nëpërmjet konsolidimit të strukturës, riorganizimit të programeve të studimit sipas modelit të Akademisë Amerikane West Point, modernizimit të infrastrukturës stërvitore dhe akademike dhe aplikimit të standardeve të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit. Kapacitetet që do të zhvillojë AFA-ja, sipas afateve kohore, janë:

Në periudhën afatshkurtër:

- hapja e programeve të ciklit të dytë të studimit;
- akreditimi institucional;
- akreditimi i programeve të studimit;
- trajnimi dhe kualifikimi i personelit akademik me partnerët (në veçanti me SHBA-n);
- hartimi i programeve të reja, kurrikulave dhe zhvillimin e kurseve funksionale në specialitetet e veçanta, sipas nevojave të FA-së dhe për t'i paraprirë zhvillimeve të reja të teknikës ushtarake;
- zhvillimi i kurseve institucionale e funksionale në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerit (QAPN) dhe Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarit (QAPU), duke përmbushur me cilësi të gjitha nevojat e FA-së për kualifikimin e përgjithshëm të nënoficerëve dhe ushtarëve;
- ndërtimi dhe vënia në shfrytëzim i kampusit të ri, duke e transformuar atë në një institucion prestigjioz, i cili ofron dhe zhvillon programe cilësore studimi në të tri ciklet e studimit.

Në periudhën afatmesme:

- konsolidimi institucional i AFA-së;
- rishikimi dhe përmirësimi i programeve të studimit “bachelor” dhe “master profesional”, duke u fokusuar në identifikimin e programe të reja që mbështesin zhvillimet teknologjike dhe modernizimin e FA-së;
- vijimi i diplomimit/titullimit të oficerëve të rinj sipas planit;

- licencimi dhe hapja e programit të ciklit të dytë të studimeve “master shkencor” në fushën e “sigurisë dhe mbrojtjes” dhe “marrëdhënie ndërkombëtare”;

- fillimi i trajnimit në fushën e inovacionit dhe të sigurisë kibernetike;

- rritja e bashkëpunimit me IAL brenda dhe jashtë vendit në fushën e kërkimit shkencor dhe të inovacionit;

- zhvillimi i kurseve institucionale dhe funksionale në QAPN, duke përmbushur me cilësi të gjitha nevojat e FARSH-it për kualifikimin e përgjithshëm të nënoficerëve.

Në periudhën afatgjatë:

- akreditimi i programeve të studimit master;
- hapja e ciklit të tretë të studimeve doktoraturë;
- parashikimi për studime të thelluara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë mbi inovacionin dhe sigurinë kibernetike;
- implementimi i projekteve të para kërkimore dhe inovative;
- ruajtja/menaxhimi i njohurive dhe informacionit nëpërmjet procedurave aktive, mbështetur në pronësinë ekskluzive intelektuale të AFA-së;
- zhvillimi i kurseve institucionale dhe funksionale në QAPN, duke përmbushur me cilësi të gjitha nevojat e FARSH-it për kualifikimin e përgjithshëm të nënoficerëve.

Ndërkohë, Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU) do të kryejë studime të karakterit tekniko-shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare që t'i paraprijë zhvillimeve të mjedisit strategjik. Fokusi në vitet në vijim do të jetë rritja e cilësisë së produkteve të tij për të mbështetur si arsimimin e personelit të FARSH-it, duke qenë i përditësuar me zhvillimet dhe sfidat e kohës, po ashtu edhe punën e SHPFA-së në punën e tij. Veprimtaria e tij do të konsistojë në aktivitete shkencore dhe kërkimore në fushat e studimeve të sigurisë, mbrojtjes, udhëheqjes strategjike, artit ushtarak, menaxhimit strategjik dhe planifikimit të mbrojtjes, me synimin për të gjetur zbatim për nevojat e vendimmarrjes, menaxhimit e mbrojtjes dhe transformimit të FA-së.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS)

Në periudhën afatshkurtër:

- KMS-ja do të përditësojë dhe do të konsolidojë kurrikulat mësimore, bazuar në praktikën më të mira, me qëllim ofrimin e programeve mësimore cilësore dhe konkurruese.



Në periudhën afatmesme:

- në bashkëpunim me IAL publik ose AFA-në, të japë diploma master profesional dhe shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes për kurset institucionale që ofron.

Në periudhën afatgjatë:

- konsolidimi më tej i këtij institucioni dhe rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kurrikulave.

- *Personeli nënoficer*

Për personelin nënoficer arsimit ofrohet nga Qendra e Arsimit Professional të Nënoficerit. Këtu hartohen dhe realizohen programet e arsimit të përgjithshëm profesional gjatë gjithë karrierës së nënoficerëve. Arsimiti dhe trajnimi i nënoficerëve do t'i pajisë ata me cilësitë dhe aftësitë e nevojshme profesionale për drejtimin, komandimin, stërvitjen dhe administrimin e nënrepartëve dhe mbështetjen e zinxhirit të komandimit. Arsimiti dhe trajnimi i nënoficerëve të FA-së do të zhvillohet në dy drejtime:

- arsimim i përgjithshëm bazë të nënoficerit;
- arsimim i thelluar të nënoficerit.

Programi i arsimit të përgjithshëm bazë të nënoficerit do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të:

- Kursit fillestar të nënoficerit (KFNO);
- Kursit bazë të nënoficerit (KBNO).

Programi i arsimit të thelluar të nënoficerit, do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të:

- Kursit të avancuar të nënoficerit (KANO);
- Kursit të lartë të nënoficerit (KLNO);
- kursit të kryekapitrit (KK).

- *Personeli ushtar*

Qendra e Arsimit Professional të ushtarit do të përmirësojë kapacitetet e saj për trajnimin fillestar dhe kualifikimin profesional, sipas specialiteteve të kandidatëve për oficerë, nënoficerë dhe ushtarëve/detarëve. Ajo do të vijojë të ndjekë programin e arsimit dhe kualifikimit të personelit që realizohet nga institucione të tjera jashtë FA-së. Ky arsim do të vijojë arsimin e përgjithshëm ushtarak, për të formuar me cilësitë dhe aftësitë e nevojshme profesionale specialistët e trupës, armës apo shërbimit. Në QAP edhe për vitet në vazhdim, me ushtarët/detarët do të zhvillohet kursi i stërvitjes individuale bazë dhe kursi i stërvitjes individuale të avancuar.

- *Personeli civil*

Arsimimi i personelit civil është pjesë e pandarë e arsimit, kualifikimit, trajnimit të personelit në Forcat e Armatosura, nëpërmjet kurseve,

seminareve, programeve të studimit në institucionet brenda dhe jashtë vendit.

5.4.2 Stërvitja dhe trajnimi

Stërvitja dhe trajnimi është angazhimi më i rëndësishëm në kohë paqe për Forcat e Armatosura, dhe si e tillë do të planëzohet, organizohet dhe zbatohet duke u mbështetur në doktrinat dhe standardet kombëtare dhe ato të NATO-s. Në qendër të trajnimit dhe stërvitjes do të vijojë të jetë rritja, përmirësimi i mëtejshëm dhe konsolidimi i aftësive operacionale.

Me qëllim përgatitjen edhe për situata të emergjencave civile, stërvitjet dhe trajnimet do të përfshijnë tematikë të menaxhimit të situatave kritike, planëzohen dhe zhvillohen të improvizuara në nivel sa më të lartë pjesëmarrës dhe me sa më shumë aktorë ushtarakë dhe civilë, vendës dhe të huaj, me qëllim planëzimin, organizimin, zhvillimin dhe përgjigjen e shpejtë e efektive ndaj situatave të krijuara.

Për përgatitjen dhe stërvitjen e personelit dhe repartëve e nënrepartëve do të vijojë të aplikohen doktrinat kombëtare e ato të NATO-s dhe në veçanti STANAG-ët e miratuara. Trajnimi i efektivëve do të konsistojë në aftësimin e tri elementeve të ndara, por që sinkronizohen me njëri-tjetrin, stërvitje individuale, stërvitje kolektive dhe stërvitja e drejtuesve, me qëllim realizimin e stërvitjeve kombëtare, rajonale dhe të NATO-s dhe zhvillimin me sukses të operacioneve kombëtare, të EC, NATO/BE/UN/koalicione.

- *Stërvitja individuale*

Stërvitja individuale do të synojë rritjen e kapaciteteve luftarake individuale, veçanërisht të personelit të ardhur rishtazi nga Qendra e Arsimit Professional të Ushtarit (QAPU) me qëllim integrimin sa më cilësor në funksion të kohezionit të të gjitha niveleve të komandimit si dhe aftësimin profesional e fizik në interes të realizimit të misionit e të detyrave, që i përgjigjet nivelit të zhvillimit të FA-së dhe standardeve të NATO-s. Konceptet e reja të stërvitjes individuale, përgatitja e luftëtarit “Multi domain” dhe “Transformimi digjital”, do të jenë fokusi kryesor i ndryshimeve për stërvitjen individuale.

Në funksion të stërvitjes individuale do të jetë edhe modernizimi i strukturave me simulator të zhvillimit të qitjes individuale.



- Stërvitja kolektive

Stërvitja kolektive do të ketë si qëllim rritjen e kohezionit të nënrepartëve dhe repartëve në vetvete dhe aftësimin për të koordinuar dhe bashkëvepruar me njëri-tjetrin. Stërvitja dhe trajnimi kolektiv do të ketë në fokus integrimin e strukturave dhe ndërveprueshmërinë me aleatët, në të gjitha stërvitjet kombëtare, rajonale dhe me NATO-n, arritjen e standardeve nëpërmjet stërvitjeve në kushte sa më afër realitetit dhe sfiduese në të gjitha kushtet e motit, situatës dhe ambientit gjeografik.

Në funksion të stërvitjes kolektive Qendra e Simulimit do të modernizohet në infrastrukturë, pajisje, programe dhe do të kompletohet me personel të aftë për të zhvilluar dhe përmirësuar kapacitetet ekzistuese. Ajo do të mundësojë hartimin në kohë reale të kërkesave sfiduese, krijimin e kapaciteteve trajnuese dhe mjedisit specifik, realist e ndërveprues virtual të kërkuar prej situatës taktike për të trajnuar dhe për të zhvilluar personelin ushtarak, drejtuesit dhe njësitë e FA-së për të arritur gatishmërinë e kërkuar apo për të mbajtur atë ekzistuese. Trajnimi i ofruar do të jetë nga niveli i stërvitjes kolektive deri në stërvitjet e përbashkëta dhe shumëkombëshe. Në planin afatmesëm, kjo qendër simulimi është e domosdoshme të zotërojë kapacitete të plota për të përgatitur dhe për të simuluar trajnimin virtual për çdo lloj operacioni dhe do të mund të funksionojë si qendër rajonale simulimi për t'u shfrytëzuar në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e tjera.

- Vlerësimi dhe certifikimi

Vlerësimi i strukturave do të bazohet në manualin e NATO Education, Training Exercise and Evaluation (ETEE) “Sistemi i Vlerësimit të Gatishmërisë Luftarake”.

- Stërvitjet dhe trajnimet paradisllokuese.

Forcat dhe repartet të cilat do të caktohen të jenë pjesë e operacioneve të drejtuara nga NATO (Allied Reaction Force/ARP), do të përzgjidhen, trajnohen, stërviten, pajisen, si dhe do të jenë të gatshme “Combat Ready” për t’ju përgjigjur spektrit të operacioneve me qasjen NTM/NTE (Notice to Move/Notice to Effect), bazuar në deklaratimet kombëtare mbi modelin e ri të forcave (New Force Model / NFM) të Aleancës.

- Stërvitjet dhe trajnimet në kuadër të NATO-s dhe rajonale

Trajnimet dhe stërvitjet e përbashkëta rajonale dhe në kuadër të NATO-s do të vijojnë të realizohen

sipas procesit të planëzimit të stërvitjeve kolektive dhe individuale të NATO-s, duke zbatuar të gjitha fazat e përcaktuar në direktivat e NATO-s.

Ndryshimet gjeostrategjike në krahun verilindor dhe juglindor të Aleancës kanë ndryshuar fokusin e stërvitjeve dhe përgatitjeve të trupave nga stërvitje OMP (Operacionet e Mbështetjes së Paqes) në stërvitje në dobi të luftës konvencionale në kuptimin e nenit 5 të Aleancës për mbrojtjen kolektive. Rrjedhimisht, ky ndryshim do të reflektohet në stërvitjet rajonale dhe të NATO-s për përgatitjen e repartëve dhe nënrepartëve të FA-së.

5.5 Komanda Mbështetëse

Struktura e Komandës Mbështetëse (KM) përbëhet nga:

- Komanda dhe Shtabi;
- Kompania e Mbështetjes së Shtabit;
- Qendra Stërvitore;
- Batalioni i Furnizimit;
- Batalioni i Transportit;
- Batalioni i Xhenios;
- Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile;
- Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së

Teknikës së Forcave të Armatosura.

Planvendosja e strukturave të KM-së do të jetë sipas planvendosjes respektive të miratuar.

Komanda Mbështetëse (KM) do të krijojë, zhvillojë dhe konsolidojë kapacitetet operacionale të domosdoshme për realizimin e misionit, detyrave e përgjegjësi të strukturave të KM-së. Kapacitetet që synohet të zhvillohen do të jenë në gjendje, që në rastet e situatave të ndryshme, t’i përgjigjen dhe plotësojnë kërkesat dhe nevojat e ndërsjella për bashkëpunim, ndërveprim, sinkronizim dhe mbështetje. Prioritet do të jetë zhvillimi i aftësive operacionale reale në periudhën afatshkurtër dhe zhvillimi e konsolidimi i mëtejshëm në periudhat afatmesme e afatgjata.

Krijimi i aftësive të plota operacionale të KM për t’ju përgjigjur një spektri sa më të gjerë të detyrave dhe përgjegjësi të misionit, do të jetë një proces gradual dhe relativisht i gjatë. Zhvillimi i këtyre kapaciteteve do të përqendrohet me prioritet në ato struktura, elemente dhe sisteme që janë të deklaruara ose lidhen e ndikojnë drejtpërdrejt në plotësimin e detyrimeve në kuadër të NATO-s. Synimi kryesor do të jetë zhvillimi i aftësive operacionale, për misionet dhe detyrat më emergjente, në periudhën afatshkurtër dhe konsolidimi i mëtejshëm në periudhën afatmesme e afatgjatë. Për këtë qëllim



KM-ja do të zhvillohet, në koncept dhe praktikë, si një strukturë plotësisht profesioniste, e ndërveprueshme, me aftësi reale operacionale për lëvizshmëri, fleksibilitet dhe reagueshmëri të lartë dhe të qëndrueshme. Zhvillimi i kapaciteteve operacionale të KM-së, krahas aspektit sasior të tyre, planifikimi i zhvillimit cilësor të këtyre kapaciteteve do të mbetet vëmendje dhe prioritet konstant.

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit të Komandës Mbështetëse.

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përfaqësojnë aftësitë e KM-së për të mbështetur operacionet në përmbushje të misionit dhe detyrave. Ato realizohen nga strukturat e mbështetjes së luftimit. Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përbëhen nga kapacitetet e mbështetjes që ofrojnë ndihmë operacionale të elementeve të luftimit, të tilla si kapacitetet e mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë, xhenios të përgjithshme dhe komandim-kontrollit e komunikimit:

- kapacitetet e komandim-kontrollit për KM-në;
- kapacitetet e mbështetjes xheniere të luftimit (Kompania EOD në mbështetje të luftimit);
- kapacitetet e mbështetjes së përgjithshme xheniere (Detashmenti i Urave, Kompania e Mbështetjes së Përgjithshme Xheniere).

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit të Komandës Mbështetëse.

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit përfaqësojnë aftësitë e strukturave të KM-së për të mbështetur operacionet në përmbushje të misionit dhe detyrave. Ato realizohen nga strukturat e përcaktuara në repartet dhe nënrepartet e vartësisë së KM-së. Në këto kapacitete hyjnë kapacitetet e furnizimit, transportit, mirëmbajtjes, kujdesit psikologjik dhe të administrimit. Këto kapacitete do të mundësohen nga Batalioni i Furnizimit dhe Batalioni i Transportit dhe QRMTFA.

Kapacitetet për përballimin e emergjencave civile.

Përfaqësojnë aftësitë e KM-së, të cilat do të angazhohen në operacione të ndryshme për sigurimin e mbështetjes ndaj autoriteteve qendrore dhe lokale për përballimin e emergjencave civile brenda dhe jashtë vendit. Këto kapacitete do të mbështesin një situatë emergjente të vetme me angazhimin e një strukture deri në një batalion të përforcuar ose e dy situatave emergjente të njëkohshme me angazhimin e dy strukturave deri në nivel tri kompani të përforcuara. Kjo mbështetje për

autoritetet civile qendrore dhe lokale kryhet kur burimet shtetërore janë përdorur dhe kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme. Kapacitetet e kërkim-shpëtimit përfaqësojnë aftësitë e KM-së për të mbështetur operacionet e kërkim-shpëtimit dhe përbëhen nga: kompanitë operacionale dhe rezerviste të kërkim-shpëtimit të BMEC-së dhe Batalioni i Xhenios.

Zhvillimi i kapaciteteve të KM-së, sipas afateve kohore, do të jenë:

Në periudhën afatshkurtër:

- modernizimi me mjete transporti dhe speciale;
- kompletimi me pajisje të kërkim-shpëtimit të kompanisë operacionale dhe rezerviste të BMEC-së;
- kompletimi me pajisje dhe sisteme operimi për funksionimin e ndërtesave të ndërtuara/rikonstruktura;
- kompletimi i kompanisë EOD me mjete taktike luftimi dhe pajisje speciale kolektive;
- investime në infrastrukturë për përmirësimin e kushteve të jetesës, punës dhe stërvitjes.

Në periudhën afatmesme:

- kompletimi me mjete transporti;
- modernizimi me mjete të mesme dhe të rënda transporti;
- modernizimi me mjete speciale tërheqëse/rimorkuese;
- kompletimi me mjete speciale dhe gjurmuese të mesme dhe të rënda;
- Kompletimi i kompanisë EOD me mjete taktike luftimi/operimi/pajisje speciale kolektive;
- kompletimi i kompanive të kërkim-shpëtimit në BMEC me pajisje speciale të kërkim-shpëtimit, mjete transporti dhe speciale për kompanitë e BMEC-së;
- kompletimi me mjete speciale taktike (urahedhës të lehtë dhe të mesëm);
- kompletimi i kompanisë së urave, me ura të përgjithshme logjistike të mesme dhe të rënda;
- kompletimi me pajisje dhe sisteme për administrimin dhe ruajtjen e pajisjeve dhe armatimit të moduleve të GBKL-së;
- kompletimi me pajisje dhe sisteme ruajtje, sigurie dhe administrimi të armatimit, municioneve të KM-së dhe FA-së;
- përmirësimi i infrastrukturës për jetesë, punë, trajnim dhe stërvitje.

Në periudhën afatgjatë:

- kapacitete për të përmbushur me cilësi detyrimet kombëtare dhe në kuadër të Aleancës, sipas planeve përkatëse;



- kapacitete efektive dhe të konsoliduara për mbështetjen e forcës ushtarake dhe të popullsisë civile;

- sigurimi i mbështetjes cilësore në të tria nivelet;
- të afta për t'u vënë në dispozicion të NATO-s në operacionet/angazhimet e drejtuara prej saj, si dhe për të kontribuar në misione të BE-së, OKB-së, sipas situatave dhe llojit të angazhimit.

Gjendja përfundimtare e dëshiruar është zhvillimi dhe konsolidimi cilësor i të gjitha strukturave, me kapacitete/aftësi operationale të plota, që t'i përgjigjen misionit të KM-së. Zhvillimi i KM-së do të realizohet në mënyrë progresive dhe prioritare në tri dimensionet kryesore: sasi, cilësi dhe kapacitete.

KREU VI

KAPACITETET E KOMUNIKIM-KOMANDIM-KONTROLLIT NË FA

Fokusi i zhvillimit të kapaciteteve për komandim-kontrollin do të jenë kërkesat e objektivave të kapaciteteve të NATO-s, si dhe trendi i teknologjisë të së ardhmes në komunikim-komandim-kontroll me sisteme dhe programe kompjuterike, të cilat do të rritin efektivitetin e forcave të luftimit, duke krijuar rrjetin taktik të informacionit, zbatimin e sistemit të gjurmimit të forcave tona dhe modernizimin e vendkomandave. Këto kapacitete do të sigurohen nëpërmjet kompletimit dhe futjes në përdorim të sistemeve dhe programeve të posaçme, të cilat rekomandojnë zgjidhjet optimale në situata të ndryshme, duke shfrytëzuar inteligjencën artificiale, programet për zbulimin, mbrojtjen kibernetike, programet për komunikimin taktik dhe sistemet e përbashkëta të radiove taktike etj.

Për të siguruar ushtrimin e funksioneve të komandimit dhe kontrollit do të përmirësohen e zhvillohen kapacitetet e shtabeve për komandim-kontrollin dhe kompletimin me personel të kualifikuar.

Kapacitetet kryesore të komandim-kontrollit që do të zhvillohen:

Në periudhën afatshkurtër:

- përmirësimi dhe përditësim i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes (SIMB);

- ndërtimi i rrjetit kompjuterik të klasifikuar “NATO Sekret” në Forcat e Armatosura (sipas projektit të *Allied Federated Services* të NATO-s);

- ndërtimi i sistemit të radiondërlidhjes digjitale në FA;

- sisteme dhe pajisje të radiokomunikimit të sigurt në Forcat e Armatosura;

- kompletimi me radio taktike të komunikimit të sigurt të (GBKL dhe ROS);

- përmirësimi i sistemit të telefonisë VoIP & VTC në Forcat e Armatosura;

- rritja e kapaciteteve të sistemeve të transmetimit me fibër optike dhe mikrovale (radiorele);

- përmirësimi i sistemeve të burimeve të ushqimit elektrik, për mbështetjen dhe autonominë e funksionimit të Sistemeve të Ndërlidhjes së Informacionit (SNI);

- funksionimi operacional i sistemit të komunikimit tokë-ajër-tokë;

- ndërtimi i sistemit back up i ruajtjes së të dhënave.

Në periudhën afatmesme:

- vijimi i ndërtimit i rrjetit kompjuterik të klasifikuar “NATO Sekret” në Forcat e Armatosura (sipas projektit të *Allied Federated Services* të NATO-s);

- rritja e kapaciteteve shumëkanalëshe (CTE, VoIP, VTC) dhe të sistemeve të transmetimit me fibër optike dhe mikrovale (radiorele);

- kompletimi me sisteme ndërlidhje dhe informacioni të lëvizshme;

- Ndërtimi i Qendrës së Ndërlidhjes Rezervë në Forcat e Armatosura;

- përmirësimi i sistemit back up i ruajtjes së të dhënave;

- përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të burimeve të ushqimit elektrik, për mbështetjen dhe autonominë e funksionimit të Sistemeve të Ndërlidhjes së Informacionit (SNI);

- përmirësimi i cilësisë dhe rritjes së sigurisë të shërbimeve të rrjeteve kompjuterike të Forcave të Armatosura.

Në periudhën afatgjatë:

- vijimi i proceseve të modernizimit dhe konsolidimi i kapaciteteve operationale të SNI-së të ndërveprueshme me ato të NATO-s;

- përmirësimi infrastrukturor dhe teknik i Qendrës së Ndërlidhjes Rezervë në Forcat e Armatosura;



- përmirësimi i sistemit *back up* i ruajtjes së të dhënave;

- zhvillimi i kapaciteteve për shkëmbimin e pamjes së përbashkët operacionale tokë-ajër-det (*Common Operational Picture*).

Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) është struktura nëpërmjet së cilës SHSHPFA-ja ushtron komandim-kontrollin e tij në të gjithë FA-në. Kjo strukturë mbështet Shtabin e Përgjithshëm të FA-së në përmbushjen e përgjegjësisë të komandimit e kontrollit në nivelin operativ-strategjik. QBO-ja koordinon planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve të FA-së për rastet e emergjencave e situatave kritike humanitare në të gjitha format që shfaqen, fazat e zhvillimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e detyrave të planëzuara dhe të miratuara për njësitë e repartet e FA-së.

Në Forcën Tokësore: modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të SNI-ve në periudhën afatshkurtër do të mundësojë sigurimin e SNI-ve të nevojshme për b2K/GBKL, SOLTG, dhe reparteve të tjera operacionale me sisteme IT-je, mjete komunikimi njëkanalëshe dhe shumëkanalëshe të sigurta kombëtare me module të integruara të komunikimit, ndërsa në periudhën afatmesme dhe afatgjatë do synohet të përmirësohet ndërveprimi dhe efektiviteti strategjik i SNI-ve me sisteme të menaxhimit të komunikimit në fushëbetejë me operacionet/misionet e GBKL, SOLTG, reparteve operacionale të FT-së, si dhe me angazhimet e tjera të mundshme në kuadër të Aleancën.

Në Forcën Detare: komandimi dhe kontrolli operacional i veprimtarisë së FD-së për kryerjen e detyrave operacionale realizohet nga komandanti i Forcës Detare nëpërmjet Qendrës Operacionale të FD-së dhe Qendrave Operacionale në Distriktet Detare. Sistemet e komandim-kontrollit do të modernizohen nëpërmjet:

- kompletimit me radiosisteme të komunikimit të sigurt det-tokë-det;

- repetitor, radiorele, centrale telefonike;

- Sistemeve të komunikimit dhe të ndërveprimit në nivelet Anije - QOFD - QO NATO (MARCOM);

- ndërtimit/ngritjes së kapaciteteve të radio komunikimit taktik HF, VHF, UHF, SATCOM në të gjitha strukturat e Forcës Detare, të ndërveprueshme me radiosistemet/sistemet e NATO-s;

- ndërveprueshmërisë me NSWAN, shkëmbimit të RMP nëpërmjet MC2IS/TRITON dhe marrjes

së të gjitha shërbimeve të nevojshme, përfshirë shërbimin satelitor për komunikim nga NATO-ja.

Në Forcën Ajrore: komandim-kontrolli deri në vitin 2026 do të vijojë të kryhet nëpërmjet QKR-së, sipas strukturës aktuale. Me futjen në përdorim të radarit të ri stacionar pas vitit 2026 do të ndryshojë mënyra e komandim – kontrollit, duke krijuar tri struktura të cilat do të rrimëtohen:

1. Qendra e Operacioneve Ajrore (QOA) (aktualisht salla operacionale);

2. Qendra e Vëzhgimit Ajror (sistemi i radarëve, 1 stacionar dhe 2 mobil);

3. Skuadroni i Sistemeve të Komunikimit dhe Shkëmbimit të Informacionit.

Qendra e Operacioneve Ajrore do të jetë në vartësi të drejtpërdrejtë të komandantit të Forcës Ajrore dhe ekuivalente me Shtabin e Forcës Ajrore. QOA do të kryejë/ndjekë të gjithë veprimtarinë operacionale të FAj.

Qendra e Vëzhgimit Ajror do të jetë në vartësi të drejtpërdrejtë të komandantit të Forcës Ajrore dhe do të ketë dy venddislokime të radarëve fiks të mbrojtjes ajrore.

Skuadroni i sistemeve të komunikimit dhe shkëmbimit të Informacionit do të jetë përgjegjës për mundësimin e mjedisit të transmetimit nga sensorët (radarët), stacionet e komunikimit tokë-ajër-tokë, pikat repetitive, si mbajtjen në eficientë/funksionalitet të sistemeve të shkëmbimit të informacionit ajror me aleancën/partnerët.

KREU VII

MBROJTJA KIBERNETIKE

Me shpejtësinë e ndryshimit të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit, ku sasia dhe vlera e informacionit elektronik rritet dita-ditës dhe në kushtet e internetit pa kufij dhe natyrës anonimate, rreziku i sulmeve kibernetike ka arritur nivele të paprecedentë.

Sulmet agresive kibernetike të vitit 2022 ndaj Shqipërisë, të cilat vunë në rrezik shumë prej sistemeve qeveritare, treguan dhe njëherë rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës së informacionit.

Qëllimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura (MM/FA) është mbajtja e një mjedisi elektronik të sigurt, të besueshëm që mbështet sigurinë në MM/FA për funksionimin normal të sistemeve të komunikimit dhe të informacionit në interes të misionit dhe detyrave, të forcimit të



sistemeve të sigurisë kibernetike, zbulimit, parandalimit të sulmeve kibernetike dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj incidenteve të mundshme.

Është siguruar një qasje gjithëpërfshirëse e strukturave të MM/FA-së, për të pasur një kuptim më të qartë për hapësirën kibernetike dhe dobësitë e saj. Janë rritur kapacitetet operacionale të SNI-ve, në aspekte të ndryshme të sigurisë kibernetike, dhe është rritur ndërgjegjësimi i personelit në lidhje me sigurinë kibernetike. Investimet në zhvillimin e kapaciteteve kibernetike, si dhe ngritja dhe funksionimi i Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike është rezultati i kësaj përpjekje, e cila ka nevojë për përmirësim dhe modernizim të mëtejshëm.

Përfitimet e mëdha që vijnë nga hapësira e përbashkët dhe e lirë kibernetike bashkëshoqërohen edhe nga sfida të sigurisë kibernetike. Prandaj dhe siguria kibernetike merr një rol kyç. Forcat e Armatosura zotërojnë Sistemet e Ndërlidhjes dhe Informacionit (SNI), të cilat mbështesin me shërbime funksionet e komandim-kontrollit në të tri nivelet (strategjik, operacional dhe taktik). Këto sisteme janë të integruara e të standardizuara teknologjikisht. Ato arrijnë ndërveprim brenda forcave dhe shërbimeve me agjencitë e tjera shtetërore, si dhe me shtetet e tjera aleate. Ky integrim dhe ndërveprueshmëri mundëson aftësi të mëdha për bashkëpunimin dhe ndarjen e pakrahasueshme të informacionit.

Kjo lidhje e integruar e njërive dhe raporteve nga ana tjetër ka sjellë sfida në lidhje me sigurinë kibernetike. Kërcënimi i sulmeve kibernetike ndaj vendit tonë pritet të jetë në rritje në vitet në vijim, çfarë e bën sigurinë kibernetike një element të rëndësishëm të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. Për pasojë zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes së hapësirës kibernetike merr përparësi, me qëllim parandalimin e rrezikut kibernetik dhe sigurinë e aktiviteteve kritike të kësaj hapësire.

Kapacitetet operacionale të sigurisë kibernetike kanë për qëllim të sigurojnë Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI) të FARSH-it nga sulmet kibernetike, sigurimin e një hapësire kibernetike të sigurt, fleksibël e të besueshme që mbështet sigurinë e këtyre sistemeve të konsolidimit të aftësive mbrojtëse e kundërvepruese, rritjes së vetëdijes, profesionalizmit dhe fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këto kapacitete do të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, duke mbajtur ritmin me kërcënimet dhe mjedisin e teknologjisë që ndryshon me shpejtësi, të arrijnë kapacitete operacionale të afta për mbështetjen e komandim kontrollit në FARSH, me qëllim realizimin e misionit të tyre, si brenda dhe jashtë vendit në kuadër të misioneve të drejtuara nga NATO-ja, duke arritur nivelin e ndërveprueshmërisë dhe të sigurisë së mbrojtjes kibernetike, në përputhje me politikat dhe standardet e NATO-s për sistemet e komunikimit dhe informacionit.

Objektivat që synohet të arrihen nga Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike (NJUSK):

- monitorim 24/7 të sistemeve të komunikimit dhe të informacionit në lidhje me mjedisin kibernetik për zbulimin, identifikimin, analizën, parandalimin, dhe reagimin në kohë reale dhe rivendosur gjendjen operacionale;

- garantimi i një ambienti kibernetik të sigurt në të tri nivelet e komandim-drejtimin në FARSH;

- marrja pjesë aktive dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit me struktura të besuara brenda dhe jashtë vendit;

- zhvillimi i doktrinės së mbrojtjes kibernetike në FARSH, në përputhje me doktrinat e NATO-s dhe dokumentet kombëtare;

- integrimi i kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike në procesin e vendimmarjes operacionale, para dhe pas operacioneve dhe misioneve brenda dhe jashtë vendit;

- sigurimi i një niveli të mjaftueshëm edukimi, hulumtimi dhe trajnimi që përdoruesit të jenë të vetëdijshëm mbi kërcënimet kibernetike dhe rreziqet e tij;

- marrja pjesë aktive në harmonizimin e kuadrit rregullator dhe ligjor që ka të bëjë me sigurinë kibernetike.

Prioritetet e NJUSK-ut do të fokusohen:

- zhvillimi dhe modernizimi i kapaciteteve operacionale të mbrojtjes kibernetike të Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike;

- rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar midis vendeve të NATO-s dhe BE-së;

- koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat e besuara brenda dhe jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për të siguruar dhe për të mbajtur ndërgjegjësimin për situatën dhe përgjigje të koordinuar ndaj sulmeve kibernetike;



- pjesëmarrja aktive në stërvitje të rregullta kombëtare dhe ndërkombëtare duke synuar integrimin dhe ndërveprueshmërinë e elementeve të Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike dhe vlerësimet e mbrojtjes kibernetike në të gjithë gamën e stërvitjeve;

- përgatitja e dokumentacionit të duhur procedural dhe teknik në interes të përdorimit të kapaciteteve të sigurisë kibernetike të FARSH-it, në përputhje me standardet e NATO-s.

Kapacitetet e sigurisë kibernetike bazohen në ndërtimin e Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike. NJUSK-u do të monitorojë Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI) të FARSH-it. NJUSK-u do të zhvillojë kapacitetet e saj sipas periudhave të mëposhtme:

Në periudhën afatshkurtër:

- ngritja e Qendrës Operacionale të Sigurisë Kibernetike;

- sigurimi i kapaciteteve hardware dhe software mobil të besueshëm, të sigurt që garantojnë mbrojtjen e informacionit në interes të stërvitjeve kombëtare dhe ndërkombëtare;

- zhvillimin e aseteve kibernetike dhe atyre të inteligjencës kibernetike për përdorim taktik, të nevojshme në procesin e vendimmarrjes.

Në periudhën afatmesme/afatgjatë:

- zhvillimi dhe konsolidimi më tej dhe i vazhdueshëm, në përputhje me zhvillimin teknologjik dhe evoluimin e kërcënimeve kibernetike, i kapaciteteve operacionale të sigurisë kibernetike, në interes të realizimit të misionit të FARSH-it.

KREU VIII OPERACIONET

Zhvillimi i kapaciteteve të përmendura në këtë plan do të mundësojnë që FARSH-i të jetë plotësisht e ndërveprueshme dhe të japë kontribut cilësor në operacionet e drejtuara nga NATO-ja, por edhe nga BE-ja apo OKB-ja.

- *Brenda vendit*

Operacionet e zhvilluara brenda vendit, në të cilat do të marrin pjesë Forcat e Armatosura me kapacitetet e tyre, përveç misionit të tyre kushtetues për të siguruar sovranitetin dhe pavarësinë e vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe rendin kushtetues, në bashkëveprim me forcat aleate, do të përqendrohen kryesisht në dhënien e ndihmës në

përballimin e emergjencave civile dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit.

- *Jashtë vendit*

Forcat e Armatosura do të marrin pjesë në operacione jashtë vendit në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së dhe koalicioneve të tjera. Operacionet në kuadër të NATO-s do të zhvillohen për mbrojtjen kolektive (*deterrence and defence*), parandalimin dhe menaxhimin e krizave dhe bashkëpunimin për sigurinë (*cooperative security*).

KREU IX BURIMET E MBROJTJES

- *Burimet njerëzore*

Burimet njerëzore janë komponenti më i rëndësishëm i burimeve të mbrojtjes dhe elementi themelor i kapaciteteve. Aktualisht Forca e Armatosur zotëron kapacitetet njerëzore dhe sistemin e automatizuar të menaxhimit të personelit, i cili do të vijojë të shërbejë për një mirëmenaxhim të burimeve njerëzore, si dhe ndjekjen e kompletimit me personel aktiv dhe rezervist, të strukturave të Forcave të Armatosura. Objektivi kryesor në fushën e menaxhimit të personelit është përmirësimi i rekrutimit, i sistemit të arsimit/kualifikimit, trajnimit, mbështetjes dhe mbajtjes së personelit në Forcat e Armatosura. Rritja e cilësisë e të gjithë kategorive të personelit do të transmetojë rritjen e cilësisë së kapaciteteve operacionale për përbushjen e standardeve për integrim në NATO, si dhe përmirësimin e aftësive për pjesëmarrje të suksesshme në operacione si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Zhvillimi i burimeve njerëzore

RSM 2019 ka përcaktuar që numri i personelit aktiv do të jetë 8500. Riorganizimi i strukturës së FARSH-it synon zhvillimin e kapaciteteve të reja luftarake të cilat sjellin domosdoshmërinë për ndryshim strukture dhe rritje të numrit të personelit. Kapacitetet e zhvilluara nga forcat do të vihen në dispozicion të operacioneve që do të ndërmerren brenda vendit, në kuadër të Aleancës e koalicioneve të tjera apo edhe të operacioneve ndërinstitucionale në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, struktura e re e FA-së krijon një ndarje të qartë të strukturave luftarake, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit, duke i integruar ato nën komandat e tyre përkatëse, bazuar në natyrën e veçoritë e tyre, si dhe në lehtësinë për t'i



përdorur me efikasitet në momentin e kërkuar. Rritja e numrit të personelit për periudhën 2024–2033 do të jetë si vijon:

- në periudhën afatshkurtër do të ruhet numri i personelit aktiv prej 8500 plus 30% shtesë personel rezervist;

- në periudhën afatmesme do të arrihet 9000 personel aktiv dhe do të ruhet numri shtesë i personelit rezervist prej 30%. Rritja e personelit aktiv në periudhën afatmesme vjen si rezultat i zbatimit të disa projekteve në teknologji dhe pajisje;

- në periudhën afatgjatë plani ka tendencë të rritjes së numrit të personelit aktiv në 9500, i cili do të mbajë në konsideratë zhvillimin e një studimi të kategorive të personelit, ndërsa numri i personelit rezervist do të caktohet në varësi të vlerësimeve periodike. Kjo periudhë do të karakterizohet nga kompletimi dhe vënia në eficiencë e pajisjeve dhe sistemeve moderne.

Menaxhimi i personelit të FARSH-it (ushtar, nënoficer, oficer dhe civil) do të bëhet sipas ciklit të plotë të tij: nga përsosja e sistemit të rekrutimit, te meritokracia dhe standardet më të mira e përparimit në karrierë e deri te përgatitja e rrugës dhe kushteve për kalimin nga forca aktive në forcë rezerviste/integrimi në jetën civile.

Sistemi i të dhënave të personelit

Sistemi i të dhënave të personelit do të vijë vazhdimisht në përmirësim me synimin që të konsolidohen mënyrat e ruajtjes së të dhënave personale të personelit aktiv dhe rezervist, duke modernizuar informacionin me përdorimin e softeve përkatëse specifike. Qendra e Personel-Rekrutimit do të përmirësojë kapacitetet e menaxhimit të të dhënave për emërimet në detyrë, arsimimin, kualifikimet dhe gradimin, si dhe të dhënave kryesore të personelit.

- Burimet financiare.

Për të garantuar përmbushjen e misionit kushtetues dhe arritjen e objektivave strategjike të SU-së nevojitet mbështetja me buxhet të mbrojtjes në nivele të kërkuara në këtë PAZH. Planifikimi i zhvillimit të kapaciteteve në këtë dokument është bërë bazuar në përmbushje të misionit kushtetues, detyrimeve nën nenin 3 të Traktatit të Uashingtonit dhe në zbatim të vendimit të marrë nga kërret e shteteve në Samitin e NATO-s, në Vilnius 2023.

Përdorimi i burimeve të mbrojtjes në FA do të bëhet në mënyrë të balancuar ndërmjet tri kategorive kryesore të shpenzimeve në personel, operacione dhe mirëmbajtje, si dhe investime për modernizimin dhe infrastrukturën.

Mbështetja me burime i Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FA 2024–2033 është e domosdoshme për të siguruar buxhetimin dhe krijimin e kushteve për implementimin e planeve dhe kthimin e tyre në kapacitete. Njëkohësisht, mbështetja me burime financiare e PAZHFA 2024–2033 do të sigurojë përballimin e kostos për angazhimet e shtuara të FA-së, në zbatim të detyrimeve kombëtare, ndërkombëtare dhe në kuadër të operacioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Kosto e parashikuar e PAZHFA 2024–2033

PAZHFA 2024–2033, në aspektin e mbështetjes me burime financiare të ngritjes, zhvillimit dhe mbajtjes së kapaciteteve të parashikuara në të, i referohet të dhënave makroekonomike të Ministrisë së Financave, për sa i përket tendencës së rritjes së ekonomisë. Bazuar në angazhimet e Republikës së Shqipërisë për arritjen e nivelit 2% të PBB-së si detyrime të buxhetit të Mbrojtjes, arritja e këtij niveli parashikohet duke filluar nga viti 2024. Tabela e mëposhtme pasqyron nevojat për mbështetje me buxhet të mbrojtjes të këtij plani për vitet 2024–2033.

Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033 (në milion lekë)

KATEGORIA	Nevoja 2024	Buxheti 2024	diferenca	Nevoja 2025	Buxheti 2025	diferenca	Nevoja 2026	Buxheti 2026	diferenca	Nevoja 2027	Buxheti 2027	diferenca	Nevoja 2028	Nevoja 2029	Nevoja 2030	Nevoja 2031	Nevoja 2032	Nevoja 2033
Personeli	9,496	9,496	-	11,593	11,593	-	11,456	11,456	-	11,046	11,046	0	23,746	24,817	25,936	27,104	28,324	29,457
Operative	13,944	13,944	-	12,644	12,644	-	13,490	13,490	-	13,490	13,490	0	17,810	18,613	19,452	20,328	21,243	22,093
Investime	26,752	26,403	349	27,567	26,799	768	29,403	28,746	657	32,267	31,999	268	17,810	18,613	19,452	20,328	21,243	22,093
Totali	50,192	49,843	349	51,804	51,036	768	54,349	53,692	657	56,803	56,535	268	59,366	62,043	64,840	67,760	70,810	73,643

*- Burimet materiale*

Menaxhimi i burimeve materiale do të vijojë të jetë pjesa më e rëndësishme e misionit të strukturave logjistike të FA-së, të cilat kanë si qëllim sigurimin e kapaciteteve logjistike të domosdoshme për mbështetjen e FARSH-it brenda dhe jashtë vendit, si dhe minimizimin e rrezikut të krijimit të stokeve.

Burimet materiale në përdorim të FARSH-it do të përdoren me synim përmirësimin e kushteve të jetesës, punës dhe stërvitjes së personelit, në sigurimin e mbështetjes logjistike të domosdoshme për operacionet e FA-së brenda vendit, mbështetjen e trupave që angazhohen në misione/operacione jashtë vendit në kuadër të NATO-s, transportin strategjik (ajror, detar, tokësor dhe i kombinuar) për dislokimin dhe ridislokimin e trupave të FARSH-it etj.

Mbështetja në operacione do të sigurohet edhe me marrëveshje me shtetet e tjera pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta, me agjencitë e mbështetjes të NATO-s, si dhe me kontraktorë vendës.

- Infrastruktura

Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës do të ketë si synim kryesor plotësimin e kushteve për punë e jetesë të efektivëve, krijimin e kushteve për stërvitje sa më afër kushteve dhe situatave luftarake dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të veprimeve luftarake të strukturave, si dhe krijimin e kushteve për infrastrukturë operacionale.

Vijimi i investimeve në fushën e infrastrukturës, hartimi i projekteve zhvillimore, investimet në infrastrukturën akomoduese dhe stërvitore të FA-së, rritja e sigurisë së ruajtjes së materialeve ushtarake do të krijojnë kapacitete të reja për FARSH-in. Projektet kryesore në këtë fushë do të jenë: modernizimi i infrastrukturës Bazës Ajrore Kuçovë, garnizoneve ushtarake “Zall-Herr”, “Ferra”, “Pezë Helmës”, si dhe zhvillimi i infrastrukturës pritëse dhe akomoduese portuale dhe aeroportuale, si Porto-Romano dhe baza detare Pashaliman.□

- Kapacitetet logjistike

Mbështetja logjistike do të fokusohet në:

- sigurimin e mbështetjes së përgjithshme logjistike të Forcave të Armatosura në kohë paqe, krize e lufte në operacione luftarake dhe joluftarake, sipas planeve të miratuara;
- ndërtimin dhe funksionimin e logistikës së integruar dhe rishikimin e kapaciteteve për mbështetje të operacioneve;

- planëzimin, standardizimin dhe informatizimin logjistik në gjendje të sigurojë mbështetjen, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve logjistike;

- realizimin dhe ekzekutimin e mbështetjes logjistike për mallrat dhe shërbimet e përqendruara, për njësitë dhe repartet e FA-së brenda vendit, si dhe funksionimin e elementeve të mbështetjes kombëtare (NSE) për operacionet/misionet brenda dhe jashtë vendit;

- zhvillimi, përsosja dhe funksionimi i logistikës së integruar, si dhe rishikimi i vazhdueshëm i kapaciteteve për mbështetje të operacioneve;

- reagimi i shpejtë/i menjëhershëm (kur i kërkohet) për planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve humanitare;

- sigurimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë logjistike, për ato njësi e reparte të cilat kanë kapacitete të limituara dhe të pamjaftueshme për realizimin e misionit;

- sigurimin e kapaciteteve të duhura mbështetëse në organikë dhe, mbi këto kapacitete, realizimin e koordinimit me autoritetet vendore për sigurimin e plotë të mbështetjes logjistike.

Mbështetja me transport

Në të përfshihet gjithë spektri i infrastrukturës, organizimeve, mjeteve të transportit dhe pajisjeve që janë të nevojshme për dislokimin e strukturave, reparteve e nënreparteve në zonën e operacionit dhe ridislokimin e tyre. Nëpërmjet lëvizshmërisë synohet të shumëfishohet fuqia, sigurohet tempa operacional në përdorimin sa më të shpejtë dhe efikas të forcave gjatë manovrës.

Furnizimi do të organizohet dhe do të funksionojë, si vijon:

Koncepti bazë i furnizimit bazohet në ditët e furnizimit (DF) për të gjitha klasat. Ai do të realizohet nga lart poshtë deri në nivel force (Komandë Mbështetëse – Komandë Force, ose deri në reparte që janë në vartësi të drejtpërdrejtë nga SHP/MM). Synimi kryesor do të jetë krijimi i kapaciteteve për të përballuar angazhimin e qëndrueshëm (me sigurim të rotacionit të nevojshëm) në kuadër të misioneve ushtarake të NATO-s, me një batalion këmbësorie të përforcuar me elemente mbështetëse.

Ky batalion do të jetë i kompletuar, si vijon:

- 3 DOS në kompani;
- 2 DOS në batalion;
- 2 DOS në grup-batalion;



- 23 DOS në Elementet e Mbështetjes Kombëtare (NSE), e cila ngrihet si strukturë nga KM-ja, rast pas rasti, sipas misionëve.

Mbështetja në operacione jashtë vendit me kohëzgjatje mbi 30 ditë, do të sigurohet më anë të marrëveshjeve me shtetet pjesëmarrëse në operacionet e përbashkëta, me vendet që janë udhëheqëse (*Lead Nation*) për mbështetjen logjistike, si dhe duke përdorur marrëveshjet e lidhura nga agjencitë e mbështetjes së NATO-s në operacione.

KREU X BASHKËPUNIMI

Bashkëpunimi ushtarak mbetet i fokusuar në bashkëpunimin me aleatët strategjikë dhe NATO-n. Ky bashkëpunim pritet të intensifikohet në të ardhmen dhe do të jetë i orientuar në arsimim, trajnim, stërvitje dhe modernizim. Forcat e Armatosura do të jenë pjesë e iniciativave dhe strukturave të përbashkëta rajonale dhe do të marrin pjesë në operacione të përbashkëta. Nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak rajonal synohet gjithashtu nxitjen e krijimit dhe përdorimit të kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, kryesisht kapacitete për përballimin e emergjencave civile, por edhe krijimin dhe përdorimin e kapaciteteve në kuadër të operacioneve të NATO-s.

- *Dypalëshe*

Në fushën e bashkëpunimit dypalësh prioritet do të jetë bashkëpunimi me SHBA-në dhe NATO-n. Ky bashkëpunim do të intensifikohet në të ardhmen dhe do të jetë i orientuar në arsimim, trajnim, stërvitje dhe modernizim.

- *Rajonale/ shumipalëshe*

Shqipëria aktualisht është pjesë e disa iniciativave rajonale ku mund të përmendim Kartën e Adriatikut (A5), Ministerialin e Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM), Defence Cooperation Initiative (DECI), BCHOD, Iniciativa Adrion etj. Nëpërmjet bashkëpunimit ushtarak rajonal do të synohet nxitja e krijimit dhe përdorimit të kapaciteteve të përbashkëta ushtarake, kryesisht kapacitete për përballimin e emergjencave civile, por edhe krijimin dhe përdorimin e kapaciteteve në kuadër të operacioneve të NATO-s.

Në nivel rajonal do të intensifikohet bashkëpunimi me vendet e Ballkanit Perëndimor, duke promovuar qartë politikën e dyerve të hapura në rajon. Kosova do të vazhdojë të mbetet interes

kombëtar i yni, duke e përkrahur dhe ndihmuar në të gjitha drejtimet.

- *EU-ja*

Bashkimi Evropian do të zërrë një vend të veçantë për sa i përket bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, sidomos pas marrjes së statusit të “vendit kandidat”. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi do të synohet rritja e prezencës së FARSH-it në misionet e udhëhequra nga BE-ja, si dhe thithja e fondeve për implementimin e projekteve në kuadër të plotësimit të detyrimeve në nivel kombëtar.

- *OKB-ja*

Pjesëmarrja në operacionet dhe misionet e drejtuar nga OKB-ja do të vijojnë të jenë pjesë e angazhimeve jashtë vendit të FARSH-it, si pjesë e kontributit të Shqipërisë në paqen dhe sigurinë botërore. Pjesëmarrja në këto operacione do të vlerësohet rast pas rasti.

KREU XI PËRFUNDIME

Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2024–2033 do të shërbejë si udhëzim dhe do të sigurojë kuadrin e përgjithshëm për zhvillimin e strukturës së forcës dhe zhvillimin e kapaciteteve ushtarake të nevojshme për përballimin e sfidave të sigurisë aktuale dhe të ardhshme.

Zbatimi i këtij PAZH-i do të krijojë një Forcë të Armatosur të mirëpajisur dhe mirëtrajnuar, e aftë për të mbrojtur hapësirën kombëtare dhe interesat e Shqipërisë dhe për të mbështetur mbrojtjen kolektive në hapësirën e Aleancës.

Gjithashtu PAZHFA do t'i sigurojë FA-së mundësinë për t'i paraprirë më mirë ndikimit të zhvillimeve teknologjike në operacionet ushtarake në nivel kombëtar dhe në kontekstin e NATO-s, duke konsideruar transformimin digjital të Aleancës në interes dhe në funksion të rritjes së ndërveprueshmërisë. Realizimi i objektivave të këtij plani do të përcaktojë kushtet për FA-në, për të vijuar me zhvillimin, integrimin dhe përdorimin me sukses të zhvillimeve të parashikuara në fushën e teknologjisë dhe atyre që priten të ndodhin pas vitit 2033. Konsolidimi i një force të edukuar, trajnuar, pajisur dhe me një strukturë efektive, do t'i vendosë Forcat e Armatosura në një pozicion të favorshëm për të përfutur nga zhvillimet e vazhdueshme të



teknologjisë që me siguri do të përfshihen në PAZH-in e radhës.

Zhvillimi dhe arritja e plotë e kapaciteteve sipas këtij plani ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e garantimit të sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë, bazuar së pari në forcat dhe mundësitë kombëtare e më pas në bashkëpunim me Aleatët. Kapacitete që do të synohen të zhvillohen me hartimin e PAZH-it të radhës, siç janë identifikuar gjatë vlerësimit dhe fizibilitetit, janë të tilla, si sistemet dhe platformat e lëshimit të raketave me një rreze të largët dhe avionë luftarakë.

¹ Termi “kapacitet” nënkupton zhvillimin e aftësive luftarake të njësive të Forcave të Armatosura mbi bazën e 8 elementeve: doktrinë, organizim, trajnim, pajisje e sisteme, arsimim, lidhshmëri, personel, infrastrukturë dhe ndërveprim

² *Koncepti Strategjik NATO – 2022, Madrid, Spanjë, <https://www.nato.int/strategic-concept/>*

³ *Konferenca Ndërkombëtare e Sigurisë në Munich, Gjermani, 17–19 shkurt 2023.*

⁴ NATO-ja e përcakton qëndrueshmërinë si aftësia e një shteti për të rezistuar, rikuperuar dhe për të vazhduar ofrimin e shërbimeve, pas një goditje e madhe si, fatkeqësi natyrore, dështim i infrastrukturës kritike ose një sulm hibrid ose të armatosur. Sipas Aleancës Atlantike ky dimension i rëndësishëm shtjellohet nëpërmjet sigurimit të vazhdimësisë së qeverisë dhe shërbimeve kritike, furnizimit të qëndrueshëm me energji, aftësisë për të trajtuar në mënyrë efektive lëvizjen e pakontrolluar të njerëzve, sigurimin e rezervave të qëndrueshme ushqimore, aftësisë për të përballuar kriza shëndetësore, sistemeve të qëndrueshme të komunikimit, dhe sistemeve të qëndrueshme të transportit civil.

⁵ Sipas SSK 2023–2028.

⁶ SSK 2023–2028, f. 16.

⁷ Kapacitete “Niche”, janë kapacitete të vogla të specializuara që kryejnë funksione të unifikuara në njësi shumëkombëshe. Këto kapacitete janë përtej njësive/formacioneve tradicionale. Ato krijohen nga vendet aleate mbi bazën e traditës, eksperiencës, veçorive dhe mundësive të tyre.

⁸ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 19.2.2020.

⁹ Urdhër i Kryeministrit nr. 109, datë 8.7.2022.

¹⁰ Urdhër i MM-s nr. 60, datë 2.9.2022, “Për kalimin në strukturën e re organizative të AFA-së”.

DEKRET

Nr. 283, datë 1.8.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 84/2024, “Për miratimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024–2033”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ Nr. 85/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR USHTARAKE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja kuadër ushtarake ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 284, datë 1.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, **Bajram Begaj**.



**MARRËVESHJE KUADËR USHTARAKE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË TURQISË**

Preambulë

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim të referuar si “Pala” ose “Palët”),

duke ripohuar angazhimin e tyre ndaj qëllimeve dhe parimeve të Traktatit të Atlantikut të Veriut të datës 4 prill 1949, Marrëveshjes ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, lidhur me Statusin e Forcave të Tyre, të datës 19 qershor 1951 (në vijim “NATO-SOFA”) dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara;

duke theksuar faktin se bashkëpunimi në fusha të ndryshme ushtarake mbi bazën e respektit të ndërsjellë për sovranitetin dhe barazinë e të dyja Palëve do të kontribuojë në interesat e përbashkët dhe efikasitetin ekonomik të Palëve;

duke shprehur nevojën për përmirësimin e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Palëve në bazë të ligjeve kombëtare, rregullave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të garantojë një kuadër për marrëdhëniet dhe të zhvillojë bashkëpunimin ndërmjet Palëve në fushat e specifikuar në nenin 4.

Neni 2

Objekti

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për shkëmbimin e personelit, materialeve, pajisjeve, informacionit dhe përvojës në fushat e specifikuar në nenin 4.

Neni 3

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Palë Dërguese” nënkupton Palën që dërgon personel, materiale dhe pajisje te Pala Pritëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. “Palë Pritëse” nënkupton Palën që pret personelin, materialin dhe pajisjet e Palës Dërguese në territorin e saj për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. “Personel Vizitues” nënkupton personelin ushtarak ose personat civilë të dërguar nga njëra Palë tek Pala tjetër për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4. “Student Vizitues” nënkupton studentët e dërguar nga Pala Dërguese që do të emërohen në Forcat e Armatosura të Palës Dërguese për të kryer trajnim në shkollat ushtarake të Palës Pritëse ose në institucione të tjera arsimore që do të përcaktohen nga Pala Pritëse.

5. “Familjarët” nënkupton bashkëshortin/en dhe fëmijët e Personelit Vizitues për të cilët ata janë përgjegjës për t’u kujdesur, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar përkatës.

6. “Personel i lartë” nënkupton personin më të lartë ndërmjet Personelit Vizitues të autorizuar për të mbikëqyrur aktivitetet e grupit ushtarak/civil të dërguar brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje dhe të emëruar në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Dërguese.

7. “Grant” nënkupton dhurimin ose transferimin pa pagesë të një malli ose shërbimi.

8. “Shërbime” nënkupton, në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Palëve, ofrimin e trajnimit, informacionit teknik, mbështetjes, zhvillimit, mirëmbajtjes, riparimit, rikuperimit, asgjësimit, mbështetjes portuale dhe këshilluese dhe shpërndarjes së automjeteve tokësore, detare dhe ajrore, pajisjeve, armëve, ndërtesave dhe pasurive, me kusht ruajtjen e pronësisë.

9. “Mbështetje logjistike” përfshin shitjen, grantin, shkëmbimin, alokimin, marrjen/dhënie me qira transferimin teknologjik dhe licencimin e furnizimeve dhe të shërbimeve.

10. “Informacion dhe material i klasifikuar”, informacion zyrtar, dokument dhe material që kërkon mbrojtje për sigurinë kombëtare. Si rrjedhojë, ai rregullohet me zbatimin e klasifikimit të sigurisë kombëtare. Ky informacion mund të jetë në formë verbale, vizuale, magnetike ose të shtypur, ose në formë teknologjike ose pajisjeje, duke përfshirë informacionin që u nënshtrohet të Drejtave të Pronësisë Intellektuale.



Neni 4

Fushat e bashkëpunimit ushtarak

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të përfshijë fushat e mëposhtme:

1. Trajnimi dhe edukimi ushtarak:

a) trajnimi, arsimimi dhe kurset në shkollat ushtarake, qendrat trajnuese dhe arsimore ose institucione të tjera arsimore të përcaktuara nga Pala Pritëse;

b) trajnimi gjatë punës në njësitë, shtabet dhe institucionet ushtarake;

c) shkëmbim i ndërsjellë/i njëanshëm i personelit vizitues, studentit vizitues ose personelit trajnues ndërmjet institucioneve trajnuese dhe arsimore;

d) vizitat e ndërsjella kontaktuese dhe shkëmbimi i njohurive për përmirësimin e trajnimit dhe edukimit;

e) caktimi i personelit për kurset e gjuhës në vendin e origjinës.

2. Pjesëmarrja e ndërsjellë në stërvitje/trajtime ose stërvitje të përbashkëta në mënyrë aktive ose në cilësinë e vëzhguesit;

3. Industria e mbrojtjes;

4. Bashkëpunimi ushtarak dhe vizitat e kontaktit ndërmjet Forcave të Armatosura;

5. Shkëmbimi i delegacioneve;

6. Struktura organizative e Forcave të Armatosura, struktura dhe pajisja e reparteve ushtarake, drejtimi i personelit;

7. Trajnimi, shkëmbimi i informacionit dhe vizitat e kontaktit në lidhje me planifikimin rekrutimin, trajnimin, punësimin e personelit, si dhe të drejtat e punonjësve;

8. Shkëmbimi i inteligjencës ushtarake;

9. Bashkëpunimi logjistik, grantet dhe sistemet logjistike;

10. Mjekësia ushtarake dhe shërbimet shëndetësore;

11. Komunikimet, elektronika, sistemet e informacionit, lufta elektronike dhe mbrojtja kibernetike;

12. Operacione të tjera përveç luftës, të tilla si: paqeruajtja, ndihma humanitare, operacionet e sigurisë detare dhe operacionet kundër piraterisë;

13. Shkëmbimi i njohurive mbi sistemet juridike ushtarake;

14. Hartografia dhe hidrografia;

15. Shkëmbimi i personelit për zhvillim profesional;

16. Shkëmbimi i personelit vizitues, këshilltarëve dhe njësitë;

17. Shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës në fushat e kërkimit shkencor dhe teknologjik ushtarak;

18. Veprimtaritë shkencore, sociale, sportive dhe kulturore,

19. Trajnimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës në luftën kundër minave dhe mjeteve shpërthyes të improvizuara;

20. Trajnimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe i përvojave, në kuadër të Operacioneve të Ndihmës nga Fatkeqësitë Natyrore;

21. Historia ushtarake, arkivat, botimet/publikimet dhe muzeologjia.

Neni 5

Parimet e zbatimit dhe të bashkëpunimit

1. Palët mund të vendosin linja bashkëpunimi, në bazë të vendimeve të tyre në mënyrat e mëposhtme:

a) Takimet dhe vizitat e Ministrave të Mbrojtjes, Shefave të Shtabit të Përgjithshëm dhe zëvendësve të tyre ose zyrtarëve të tjerë të autorizuar nga Palët;

b) Shkëmbimi i përvojës ndërmjet ekspertëve të të dyja Palëve në fusha të ndryshme aktivitetesh;

c) Organizimi i trajnimeve, edukimit dhe kurseve me kosto, pa pagesë ose me kosto të reduktuar në reparte, shtabe apo institucione ushtarake;

d) Kontaktet ndërmjet institucioneve të ngjashme ushtarake;

e) Organizimi i diskutimeve, konsultimeve, takimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrja në kurse, simpoziume dhe konferenca;

f) Pjesëmarrja në stërvitjet ushtarake duke përfshirë stërvitjet me plumba të vërtetë, pjesëmarrja në këto stërvitje ushtarake si vëzhgues, kryerja e stërvitjeve gjatë lundrimit (PASSEX) dhe vizitat në port, organizimi i stërvitjeve të përbashkëta;

g) Shkëmbimi i informacionit dhe i materialeve trajnuese;

h) Në kuadër të bashkëpunimit logjistik ose mbështetjes logjistike, dhënia, shkëmbimi, shpërndarja, shitja, marrja me qira/dhënia me qira e mallrave dhe shërbimeve në inventarin e Palëve dhe transferimi i teknologjisë, licencimi në lidhje me këto mallra dhe shërbime dhe transporti falas i materialit të dhuruar, në përputhje me legjislacionin e vetë palës dhuruese.

2. Veprimtaritë që do të kryhen, në kuadër të bashkëpunimit logjistik ose mbështetjes logjistike do



të kryhen në përputhje me kufizimet e transferimit të palëve të treta që rrjedhin nga marrëveshjet në fuqi, të cilat palët kanë nënshkruar me kombe të tjera.

3. Palët mund të lidhin memorandume plotësuese mirëkuptimi, protokolle dhe marrëveshje për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me proceset e ratifikimit të Palëve, sipas legjislacionit të tyre kombëtar dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Bashkëpunimi do të kryhet duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e ndërsjella të Palëve dhe mbi bazën e reciprocitetit.

5. Informacioni dhe dokumentet materiale, teknike të shkëmbyera në formën e granteve ose në këmbim për pagesë ose ato të prodhuara bashkërisht nga Palët, në përputhje me këtë Marrëveshje, memorandume të tjera mirëkuptimi, protokolle dhe marrëveshje, nuk do t'i transferohen një pale të tretë pa pëlqim paraprak të ndërsjellë.

6. Në rast se materiali që do të jepet brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje nxirret nga përdorimi, Pala Pritëse do të informojë Palën Dërguese me shkrim.

Neni 6

Autoritetet kompetente dhe planet vjetore të zbatimit

1. Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Për Qeverinë e Republikës së Turqisë: Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë,

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë: Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë.

2. Palët do të përgatisin Planet Vjetore të Zbatimit, në lidhje me aktivitetet e përbashkëta për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Planet Vjetore të Zbatimit do të përfshijnë emrin, qëllimin, llojin, datën, vendin, institucionet zbatuese, aspektet financiare dhe detaje të tjera të aktiviteteve që do të kryhen.

3. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të forcohet nëpërmjet vizitave të ndërsjella në të gjitha nivelet e përmendura në Planet Vjetore të Zbatimit.

Neni 7

Kushtet e trajnimit/kursit

1. Trajnimi dhe edukimi do të jepen sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin e Palës Pritëse.

2. Një kërkesë për trajnim nga Pala Dërguese do t'i bëhet nëpërmjet një letre zyrtare Palës Pritëse jo më vonë se në mars të vitit përpara fillimit të trajnimit ose kurseve, në përputhje me këtë Marrëveshje. Pas marrjes së kërkesës, Pala Pritëse do ta shqyrtojë këtë kërkesë dhe do të informojë Palën Dërguese për përgjigjen e saj, jo më vonë se muaji korrik.

3. Nëse ka kërkesë për trajnim shtesë, kjo kërkesë njoftohet me shkresë zyrtare. Kërkesat shtesë brenda këtij qëllimi mund të përfshihen në kërkesat e planifikuara si rezultat i konsultimit ndërmjet Palëve dhe në masën që është e mundur.

4. Është një parim themelor ofrimi i trajnimeve në gjuhën e Palës Pritëse, me përjashtim të trajnimeve të ofruara nga Pala Pritëse në gjuhën angleze. Megjithatë, nëse kërkohet nga Pala Dërguese dhe nëse çmohet e përshtatshme nga Pala Marrëse, trajnimet që zgjasin më pak se 3 (tre) muaj mund të ofrohen nëpërmjet një përkthyesi. Në rast se trajnimi ofrohet nëpërmjet një përkthyesi, Pala Dërguese do të caktojë një numër të mjaftueshëm përkthyesish për personelin që do të marrë pjesë në trajnim. Kostot e përkthimit/përkthyesit, për qëllime trajnimi do të mbulohen nga Pala Dërguese.

5. Pala Dërguese do të informojë Palën Pritëse për vendimin përfundimtar për pjesëmarrjen në trajnim, numrin e personelit të ftuar të dërguar për trajnim/kurse, të dhënat e fluturimit dhe informacione të tjera të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara fillimit të trajnimit, në mënyrë që t'i mundësojë Palës Pritëse të kryejë rregullimet e nevojshme. Në rast se njoftimet nuk bëhen në kohën e duhur, Pala Marrëse ka të drejtë të shtyjë kërkesën për kursin/trajnimin për një datë të mëvonshme ose ta anulojë plotësisht atë.

6. Trajnimi i personelit të ftuar dhe i studentëve vizitues kryhet në përputhje me programet e institucioneve ose njërive ushtarake ku bëhet trajnimi. Nëse lëndët e kursit mbulojnë çështje që lidhen me sigurinë kombëtare, mund të vendosen kufizime në këtë drejtim.

7. Pala Pritëse do të përcaktojë se cilën nga pajisjet dhe materialet e nevojshme do të sigurojë



për personelin vizitues dhe studentët vizitues gjatë periudhës së trajnimit dhe cili prej tyre do t'i kthehet Palës Pritëse kur të përfundojë trajnimin.

8. Personeli dhe studentët vizitues do të zgjidhen nga Pala Dërguese, sipas kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kompetent i Palës Pritëse. Personeli dhe studentët vizitues që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Pala Pritëse, nuk do të pranohen për trajnim dhe edukim.

9. Çështjet në lidhje me llojin e provimit dhe trajnimit do të vendosen nga Pala Pritëse.

10. Për kryerjen e trajnimit dhe të edukimit, nëse çmohet e nevojshme nga Palët, mund të lidhen protokolle bazuar në këtë Marrëveshje për programet e trajnimit që kanë më shumë se një muaj kohëzgjatje dhe/ose përfshijnë rrezik për jetën. Këto protokolle mund të mbulojnë çështjet e mëposhtme ose çështje të tjera që çmohen të nevojshme:

- a) lënda e trajnimit;
- b) vendi i trajnimit;
- c) gjuha, kohëzgjatja dhe kushtet e trajnimit;
- d) të drejtat dhe detyrat e personelit ushtarak gjatë periudhës së trajnimit;
- e) fillimi dhe përfundimi i trajnimit si dhe numri i pjesëmarrësve në kurs;
- f) kualifikimet e dëshiruara të personelit që do të trajnohet;
- g) mënyra e garantimit të sigurisë së personelit ushtarak gjatë gjithë periudhës së trajnimit;
- h) mënyra e sigurimit të personave ushtarakë;
- i) mënyra e kompensimit për dëmin dhe humbjen;
- j) kushtet dhe procedurat e pagesës për trajnim;
- k) marrëveshjet në lidhje me bordin dhe akomodimin, si dhe transportin.

11. Pala pritëse do të marrë masat e nevojshme në lidhje me akomodimin dhe sigurinë e personelit

vizitues dhe të vartësve të tyre dhe për të garantuar që ata të përfitojnë nga lehtësira të tjera.

12. Personeli i ftuar dhe studentët vizitues, që dërgohen për të ndjekur programin/kurset e trajnimit, kanë përfunduar programin e kursit të specifikuar, kanë pasur sukses në provimet e organizuara, sipas kushteve të kursit dhe kanë shkruar me sukses tezën/projektet e tyre, do t'u jepet një certifikatë që tregon se ata kanë përfunduar specializimin ose programin e duhur të trajnimit (diplomë akademike). Ekuivalentimi i diplomës (dokumenti, certifikata) i nënshtrohet miratimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Palës Dërguese, sipas legjislacionit kombëtar.

Neni 8

Siguria e informacionit dhe materialit të klasifikuar

1. Të gjitha informacionet e klasifikuara, dokumentet, të drejtat e pronësisë fizike dhe intelektuale dhe materiali ushtarak i ofruar ose i prodhuar, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të shkëmbehen, përdoren dhe mbrohen për qëllimet e tyre, sipas memorandumeve pasuese të mirëkuptimit, protokolleve dhe marrëveshjeve që do të lidhen ndërmjet Palëve.

2. Palët, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, do të garantojnë mbrojtjen e informacionit, dokumenteve dhe të gjitha të dhënat mbi materialet dhe pajisjet që do të shkëmbehen në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ose kryerjes së aktiviteteve të përbashkëta. Në këtë kontekst, ata do të marrin të njëjtat masa si ato që janë të nevojshme për mbrojtjen e informacionit të tyre të klasifikuar të të njëjtut nivel. Palët do t'i japin informacionit të shkëmbyer nivelin e duhur të klasifikimit, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Për Qeverinë e Republikës së Turqisë	Ekuivalente në gjuhën angleze	Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Çok Gizli	Top Secret	Top Sekret
Gizli	Secret	Sekret
Hizmete Özel	Restricted	I Kufizuar



3. Informacioni dhe materiali i klasifikuar nuk do të zbulohen ose ndahen (ose transferohen) me një palë të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës që i ofron.

4. Informacioni dhe materiali i klasifikuar do të shkëmbehen vetëm nëpërmjet kanaleve ndërqeveritare ose kanaleve të tjera të miratuara nga autoritetet e sigurisë të përcaktuara nga Palët. Niveli i klasifikimit të informacionit do të përcaktohet nga Pala që jep informacionin.

5. Palët do të vazhdojnë të jenë përgjegjëse për mbrojtjen dhe parandalimin e lëshimit të nivelit të klasifikimit të informacionit dhe materialit të klasifikuar të shkëmbyer edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

6. Palët do të garantojnë mbrojtje efektive të të drejtave për pronësinë intelektuale që krijohen ose transferohen sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe traktatet ndërkombëtare në të cilat janë palë. Në kontekstin e kësaj Marrëveshjeje, pronësia intelektuale do të kuptohet siç përshkruhet në nenin 2 të Konventës për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, bërë në Stokholm, më 14 korrik 1967.

7. Nëse çmohet e nevojshme, një marrëveshje e veçantë sigurie për transferimin, përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit dhe të materialeve të klasifikuara të shkëmbyera brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, mund të lidhet nën përgjegjësinë e organeve të autorizuar për secilën nga fushat e bashkëpunimit të specifikuar në nenin IV.

8. Informacioni i marrë gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk do të përdoret nga asnjëra Palë kundër interesave të Palës tjetër ose ndonjë Pale të tretë.

9. Palët do të sigurojnë që aksesin në informacionin dhe materialet e klasifikuara t'i jepet në bazë të nevojës për t'u njohur dhe për personelin që zotëron lejen e duhur të sigurisë.

10. Në rast se informacioni i shkëmbyer në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zbulohet papritur, pala që zbulon faktin do të informojë menjëherë Palën tjetër për situatën.

11. Palët do të respektojnë të drejtat dhe rregullat që rregullojnë patentat, të drejtat e autorit dhe sekretet tregtare në aktivitetet e tyre të bashkëpunimit. Palët mund të vendosin kufizime për çështjet që lidhen me sekretet kombëtare.

Neni 9

Inteligjenca ushtarake

1. Ky nen mbulon zhvillimet në fushën e interesit të Forcave të Armatosura të Palëve, në lidhje me ato vende që konsiderohen se dëmtojnë interesat e ndërsjellë të Palëve dhe që do të përcaktohen së bashku, duke u dhënë përparësi aktiviteteve ushtarake dhe shkëmbimit të informacionit të inteligjencës ushtarake për aktivitetet e këtyre vendeve në Republikën e Turqisë dhe Republikën e Shqipërisë.

2. Shkëmbimi i informacionit të inteligjencës do të kryhet me mjetet e mëposhtme dhe sipas metodave të mëposhtme:

a) Çdo çështje koordinimi (përfshirë subjektet e shkëmbimit) do të përcaktohet ndërmjet Palëve me marrëveshje të ndërsjellë për vitin përkatës gjatë negociatave dypalëshe të mbajtura nga Shefat e Inteligjencës Ushtarake të të dyja vendeve ose nga personeli i autorizuar prej tyre në bazë të rotacionit, një vit në Republikën e Turqisë dhe një vit në Republikën e Shqipërisë.

b) Pala vizituese do të njoftojë Palën Pritëse për emrin, gradën, emërimin dhe lejen e sigurisë së anëtarëve të delegacionit të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së planifikuar.

c) Gjuha e dokumenteve dhe e negociatave do të jetë anglisht. Negociatat mund të zhvillohen nëpërmjet një përkthyesi, nëse kërkohet.

d) Informacioni që mund të shkëmbehet do të dorëzohet në formë dokumenti. Nëse ka ndonjë CD, DVD, film, fotografi, *slide* etj., në lidhje me këtë informacion, ato duhet t'i bashkëngjiten dokumentit.

e) Të dyja Palët bien dakord që t'u përgjigjen kërkesave të njëra-tjetrës për informacion sa më shpejt të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve të sigurta të dakordësuara reciprokisht.

f) Kërkesa për shkëmbimin e informacionit të inteligjencës ushtarake do të vlerësohet rast pas rasti dhe mund të refuzohet, nëse ato rrezikojnë sovranitetin dhe sigurinë kombëtare të njëres prej Palëve ose kundërshtojnë gjerësisht interesat e saj kombëtarë/ndërkombëtarë



Neni 10 Çështjet juridike

1. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre, si dhe studentët vizitues do t'i nënshtrohen legjislacionit kombëtar dhe juridiksionit të Palës Pritëse gjatë pranisë së tyre në territorin e Palës Pritëse, duke përfshirë hyrjen, qëndrimin dhe nisjen. Në rastet kur zbatohet juridiksioni penal i Palës Pritëse dhe vendimi përcakton një dënim që nuk është i përfshirë në legjislacionin e Palës Dërguese, do të zbatohet një lloj dënimi që është i përfshirë në legjislacionin e të dyja Palëve. Pala dërguese do të ketë të drejtën të ushtrojë juridiksion ekskluziv mbi personat që i nënshtrohen ligjit ushtarak të Palës Dërguese, në lidhje me shkeljet, duke përfshirë shkeljet që lidhen me sigurinë e saj, të dënueshme nga ligji i Palës Dërguese, por jo nga ligji i Pala Pritëse.

2. Në rastet kur zbatohet ligji i të dyja Palëve, autoritetet e Shtetit Dërgues do të kenë të drejtën parësore për të ushtruar juridiksionin e tyre mbi personelin vizitues në situatat e mëposhtme:

a) Kur vepra është vetëm kundër pronës ose sigurisë së Shtetit Dërgues, ose është vetëm kundër personit ose pronës së një anëtarit tjetër të forcës ose komponentit civil të Shtetit Dërgues, ose të një varësi.

b) Rastet që rrjedhin nga çdo veprim ose mosveprim të kryer me dashje ose nga pakujdesia në kryerjen dhe në lidhje me detyrën zyrtare.

3. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve, nëse një veprim përfshihet në paragrafin 2a ose 2b të këtij neni, Palët do të krijojnë urgjentisht një komision të përbashkët të përbërë nga përfaqësues nga secila palë për të përcaktuar nëse veprimi në fjalë ose mosveprimi përfshihet në paragrafin 2a ose 2b të këtij neni. Nëse komisioni i përbashkët në fjalë nuk mund të arrijë një marrëveshje për këtë çështje, atëherë vendimi i Shtetit Pritës do të ketë përparësi.

4. Në rast se ndonjë person nga personeli vizitues, familjarët e tyre ose studentët vizitues ndalohet ose arrestohet, Pala Pritëse do të informojë menjëherë Palën Dërguese për situatën.

5. Në rast se ndonjë person nga personeli vizitues, familjarët e tyre ose studentët vizitues përballlet me një hetim ligjor ose proces ligjor në Palën Pritëse, ai ose ajo do të ketë të drejtën e të gjithë mbrojtjes ligjore të pranuar gjerësisht, e cila do

të jetë jo më pak se ajo që gëzojnë shtetasit e Palës Pritëse.

6. Veprimtaritë e studentit vizitues dhe të personelit vizitues mund të ndërpriten nëse shkelin ligjet e Palës Pritëse.

7. Studentët vizitues dhe personeli vizitues do të respektojnë rregullat disiplinore në njësitë, selitë dhe institucionet ku janë caktuar.

8. Studentët vizitues do t'i nënshtrohen legjislacionit kombëtar të Palës Pritëse për ndëshkimet disiplinore dhe personeli vizitues do t'i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të Palës Dërguese. Megjithatë, autoritetet ushtarake kompetente të Palës Pritëse mund t'i japin urdhra personelit vizitues që kanë nën komandën e tyre, sipas kërkesave të detyrës.

9. Personeli i Lartë i Palës Dërguese do të autorizohet të zbatojë masa disiplinore ndaj personelit vizitues, në përputhje me dispozitat e tyre përkatëse të ligjeve të shërbimit ushtarak dhe ligjeve disiplinore.

10. Personeli vizitues, familjarët e tyre ose studentët vizitues nuk duhet të angazhohen në asnjë aktivitet politik ose nuk duhet të kryejnë asnjë veprimtari kundër Palës Pritëse.

Neni 11

Pretendimet për kompensim

1. Legjislacioni kombëtar i Palës Pritëse do të zbatohet për kërkesat e kompensimit të palës së tretë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët nuk do të kërkojnë kompensim nga njëra-tjetra për dëmtimin ose vdekjen e personelit të tyre ose për dëmet/humbjet e shkaktuara ndaj individëve, mallrave dhe mjedisit gjatë kryerjes së aktiviteteve, sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur një dëm ose humbje e tillë shkaktohet si rezultat i neglizhencës së rëndë ose shkeljes së qëllimshme.

3. Palët do të përcaktojnë së bashku nëse një situatë e tillë është shkaktuar si rezultat i neglizhencës së rëndë ose shkeljes së qëllimshme ose të paqëllimshme. Palët do të krijojnë menjëherë një komision të përbashkët të përbërë nga përfaqësues nga secila Palë për të përcaktuar nëse veprimi ose mosveprimi i përmendur përfshihet në paragrafin 2 të këtij neni. Nëse komisioni i përbashkët në fjalë nuk mund të arrijë një marrëveshje për këtë çështje, atëherë vendimi i Shtetit Pritës do të ketë përparësi.



Neni 12

Çështjet administrative

1. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre dhe studentët vizitues nuk do të kenë imunitet dhe privilegje diplomatike.

2. Përveç rasteve kur Palët bien dakord reciprokisht ndryshe, Pala Pritëse nuk do t'i caktojë studentët vizitorë dhe personeli i vizituesve në detyra të ndryshme nga ato të specifikuara në këtë Marrëveshje ose në marrëveshjet dhe marrëveshjet e mëvonshme.

3. Studentët vizitues dhe personeli vizitues do t'u nënshtrohen të njëjtave procedura administrative, si homologët e tyre të Palës Pritëse.

4. Personeli ushtarak i Palës Dërguese do të ketë të drejtën të veshë uniformën e tij kombëtare, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në memorandumet e tjera mirëkuptimi, protokolle dhe marrëveshje teknike që do të nënshkruhen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje. Pala Pritëse do të sigurojë, në masën që është e mundur, pajisjet e nevojshme për kryerjen e çdo veprimtarie gjatë detyrës. Megjithatë, studentët vizitues duhet të veshin uniformën ushtarake të siguruar nga Pala Pritëse. Këta studentë mund t'i bashkëngjisin uniformës simbole ushtarake të ofruara nga Pala Dërguese në mënyrë që të dallohen.

5. Pala Dërguese do të rezervojë të drejtën që të thërrasë personelin e saj, kur e gjykon të nevojshme. Pala Pritëse mund t'i kërkojë Palës Dërguese të tërheqë ose të zëvendësojë personelin e saj pa dhënë asnjë arsye. Në këtë rast, Pala Pritëse i dërgon Palës Dërguese, nëpërmjet zyrave të atasheut ushtarak, vetëm kërkesën e saj me shkrim, në lidhje me zëvendësimin e personelit. Pala Pritëse do të marrë masat e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur për kthimin e personelit përkatës.

6. Çështjet administrative që përbëjnë përjashtime do të specifikohen në memorandumet e tjera mirëkuptimi, protokolle ose marrëveshje teknike që do të nënshkruhen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

7. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre mund të përfitojnë nga klubet e oficerëve dhe supermarketet e personelit ushtarak në kuadrin e rregulloreve të Palës Pritëse.

8. Në rast se ndonjë prej personelit vizitues dhe familjarë të tyre ose studentëve vizitues vdes, Pala Pritëse do të informojë Palën Dërguese për situatën,

do ta transportojë të ndjerin në aeroportin më të afërt ndërkombëtar brenda territorit të saj dhe do të marrë masa të tjera të nevojshme, duke përfshirë mbrojtjen mjekësore derisa trupi të transferohet.

9. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre dhe studentët vizitues duhet të shmangin veprimet që dëmtojnë mjedisin, t'i kushtojnë vëmendje të madhe parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe të respektojnë rregulloret e Palës Pritëse për këtë çështje.

10. Pala Pritëse do të marrë vendimin përfundimtar në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit të nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve në bazë të reciprocitetit, dhe duke marrë parasysh mundësitë e saj kundrejt kostos ose pa kosto.

11. Trajnimi dhe edukimi do të bëhen në përputhje me legjislacionin e Palës Pritëse. Studenti vizitues dhe personeli vizitues, të cilët nuk janë në gjendje të ndjekin trajnimin dhe arsimin, për shkak të mosarritjeve akademike, mungesës së disiplinës, problemeve mjekësore etj., shkarkohen nga institucionet e trajnimit dhe arsimit, në përputhje me procedurat përkatëse të përcaktuara në legjislacionin e Palës Pritëse.

Neni 13

Shërbimet shëndetësore

1. Personeli vizitues dhe studentët vizitues do të jenë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer çdo aktivitet sipas kësaj Marrëveshjeje. Pala pritëse mund të kërkojë një raport mjekësor që vërteton se ata janë në gjendje të mirë shëndetësore.

2. Shpenzimet e shërbimeve të ekzaminimit dhe të trajtimit të studentëve të ftuar do të mbulohen sipas legjislacionit kombëtar të Palës Pritëse. Pala Pritëse do të mbulojë primet e sigurimit shëndetësor ose shpenzimet shëndetësore të studentëve vizitues.

3. Pala Pritëse do të ofrojë falas shërbimet e urgjencës mjekësore dhe shërbimet urgjente të kujdesit dentar të personelit të ftuar dhe të vartësve të tyre. Shpenzimet e ekzaminimit dhe të trajtimit mjekësor, me përjashtim të shërbimeve mjekësore urgjente dhe kujdesit urgjent dentar të personelit të ftuar dhe vartësve të tyre, do të mbulohen nga një sigurim shëndetësor që do të blihet sipas legjislacionit kombëtar të Palës Pritëse.

4. Pala Pritëse mund të sigurojë pa pagesë ose në këmbim të pagesës primet e sigurimit ose të gjitha kostot e shërbimit të trajtimit të personelit të ftuar dhe vartësve të tyre. Nëse Pala Pritëse vendos t'i



sigurojë ato në këmbim të pagesës, primet e sigurimit ose të gjitha kostot e shërbimit të trajtimit të personelit vizitues dhe vartësve të tyre do të mbulohen nga Pala Dërguese ose personeli i ftuar.

Neni 14

Çështjet financiare

1. Pala Dërguese do të jetë përgjegjëse për pagën/dietat, akomodimin, ushqimin, transportin dhe të drejtat e tjera financiare të personelit vizitues dhe studentëve vizitues të caktuar për të kryer aktivitetet e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Megjithatë, nëse kërkohet nga Pala Dërguese, Pala Pritëse do të vendosë nëse çështjet e mëposhtme do të përmbushen apo jo, si dhe do të vendosë kushtet e përmbushjes së tyre për personelin vizitues dhe studentët vizitues të caktuar për qëllime trajnimi dhe edukimi.

a) Për personelin vizitues:

1) Transportin brenda vendit dhe ndërkombëtar (procedurat dhe parimet përcaktohen nga Pala Pritëse: dy herë nga Turqia në Shqipëri dhe dy herë nga Shqipëria në Turqi, gjatë periudhës së arsimimit);

2) Paga mujore (kushtet dhe shumat e oficerit dhe nënoficerëve pjesëmarrës në kurs do të përcaktohen në përputhje me gradat e tyre, ndërsa kushtet dhe shumat e personelit civil do të përcaktohen nga Pala Pritëse në përputhje me statusin e tyre);

3) Kostot e trajnimit dhe arsimit (me kosto, me kosto të reduktuar ose pa pagesë);

4) Veshja (detajet do të përcaktohen nga Pala Pritëse);

5) Pagesa e punës me turne për mjekët pritës të trajnimit të posaçëm;

6) Konviktet (në një vendndodhje ushtarake që do të përcaktohet nga Pala Pritëse);

7) Qiradhënia (në një vendndodhje ushtarake që do të përcaktohet nga Pala Pritëse);

b) Për studentët vizitues:

1) Transportin brenda vendit dhe ndërkombëtar (procedurat dhe parimet përcaktohen nga Pala Pritëse: dy herë nga Turqia në Shqipëri dhe dy herë nga Shqipëria në Turqi, gjatë periudhës së arsimimit);

2) Ushqimin;

3) Akomodimin (në shtëpitë ose ambientet e pritjes të përcaktuara nga Pala Pritëse);

4) Dieta ditore (kushtet dhe shumat përcaktohen nga Pala Pritëse);

5) Kostot e trajnimit dhe të arsimit (me kosto, me kosto të reduktuar ose pa pagesë);

6) Veshja (detajet do të përcaktohen nga Pala Pritëse);

7) Pagat e paguara për studentët e vitit të 6-të të Fakultetit të Mjekësisë gjatë trajnimit të praktikës.

3. Kurset e gjuhës turke që do të ofrohen në Republikën e Turqisë (përfshirë klasat përgatitore të gjuhës gjatë arsimimit akademik) dhe kurset e gjuhës shqipe që do të ofrohen në Republikën e Shqipërisë, do të jenë pa pagesë. Trajnimet që kërkojnë kosto të lartë (si trajnimi i fluturimit, trajnimi i zhytësve, trajnimi për hedhjen e lirë nga kulla etj.) mund të ofrohen me çmim të plotë.

4. Studentët vizitues dhe personeli vizitues do të shlyejnë borxhet e tyre dhe të familjarëve të tyre para largimit përfundimtar nga Pala Pritëse. Në rast të një tërheqjeje urgjente, borxhet e personelit vizitues dhe të familjarëve të tyre, si dhe të studentëve vizitues do të paguhën nga Pala Dërguese, sipas dokumentit që do të lëshohet nga Pala Pritëse, ku specifikohet shuma e shpenzimeve të miratuara nga autoriteti përkatës.

5. Shpenzimet e trajnimit dhe arsimit do të paguhën në dollarë amerikanë nga Pala Dërguese në llogarinë bankare të përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës Pritëse brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e dokumentit që specifikon shumën e shpenzimeve të miratuar nga autoriteti përkatës në fund të çdo periudhe trajnimi dhe arsimit (shpenzimet e trajnimit një mujor ose me periudhë kohore më të shkurtër do të paguhën me para në dorë).

6. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre si dhe studentët vizitues do t'u nënshtrohen ligjeve tatimore në fuqi në Palën Pritëse gjatë hyrjes, qëndrimit dhe largimit të tyre.

Neni 15

Procedurat doganore dhe të pasaportës

1. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre si dhe studentët vizitues do t'u nënshtrohen rregulloreve të Palës Pritëse, në lidhje me qëndrimin dhe udhëtimin e shtetasve të huaj në territorin e Palës Pritëse.

2. Personeli vizitues dhe familjarët e tyre si dhe studentët vizitues do t'u nënshtrohen rregulloreve doganore dhe të pasaportës të Palës Pritëse gjatë hyrjes dhe daljes së tyre nga vendi i saj. Megjithatë, Pala Pritëse do të sigurojë të gjitha lehtësitë e



mundshme administrative brenda kuadrit të legjislacionit të saj.

Neni 16

Angazhimet e palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojnë të drejtat dhe angazhimet e Palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare dhe nuk do të përdoren kundër interesave, sigurisë dhe integritetit territorial të Shteteve të tjera.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi ose interpretimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime dhe negociata ndërmjet Palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk do t'i referohet asnjë gjykate kombëtare ose ndërkombëtare ose pale të tretë për zgjidhje.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e kësaj mosmarrëveshjeje, Palët do të fillojnë negociatat brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Nëse nuk arrihet asnjë zgjidhje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve në vijim, Palët mund ta ndërpresin këtë Marrëveshje në përputhje me procedurën e specifikuar në nenin 19.

Neni 18

Ndryshime dhe rishikimi

Secila Palë mund të propozojë ndryshimin ose rishikimin e kësaj Marrëveshjeje përmes kanaleve diplomatike, nëse e çmon të nevojshme. Negociatat do të fillojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit me shkrim. Nëse nuk arrihet asnjë rezultat brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, Palët mund ta ndërpresin këtë Marrëveshje në përputhje me procedurën e specifikuar në nenin 19. Ndryshimet ose rishikimet me shkrim të dakordësuara do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 20 që rregullon hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 19

Kohëzgjatja dhe ndërprerja

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare).

2. Nëse njëra nga Palët nuk njofton Palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi synimin e saj për ta ndërprerë atë, kjo Marrëveshje do të zgjatet automatikisht për periodha të njëpasnjëshme prej 1 (një) viti.

3. Secila palë mund ta njoftojë palën tjetër për synimin e saj për të ndërprerë Marrëveshjen me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike në çdo kohë. Njoftimet për ndërprerjen e Marrëveshjes do të hyjnë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë pas dhënies së njoftimit.

4. Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në programet dhe aktivitetet në vazhdim.

5. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të ndërpritet “Marrëveshja e Bashkëpunimit në Fushat Ushtarake të Stërvitjes, Teknikës dhe Shkencës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, e nënshkruar më 29 korrik 1992. Në këtë rast, referencat e Marrëveshjes së ndërprerë do të konsiderohen se janë bërë në këtë Marrëveshje dhe çdo Marrëveshje tjetër e bërë në bazë të Marrëveshjes së përfunduar do të mbetet në fuqi.

Neni 20

Ratifikimi dhe hyrja ne fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore që nevojiten për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 21

Teksti dhe nënshkrimi

Kjo Marrëveshje është lidhur në Ankara, më 20.2.2024, në dy kopje origjinale: në gjuhët turke, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast divergjence në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Në emër të Këshillit të
Ministrave të
Republikës së
Shqipërisë
Niko Peleshi
MINISTËR I
MBROJTJES

Në emër të qeverisë së
Republikës së Turqisë

Yaşar Güler
MINISTËR I MBROJTJES
KOMBËTARE



DEKRET
Nr. 284, datë 1.8.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 85/2024, “Për miratimin e marrëveshjes ushtarake ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 88/2024

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË
SHTETËRORE PËR PRODHIMIN DHE
TREGTIMIN E ARMËVE,
MUNICIONEVE, PAJISJEVE DHE
TEKNOLOGJIVE USHTARAKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e shoqërisë “KAYO” sh.a., shoqëri shtetërore për prodhimin, demilitarizimin dhe tregtimin e armëve, të municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake (në vijim “Shoqëria”), si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj.

Neni 2
Objekti i veprimtarisë

1. Shoqëria ka objekt veprimtarie projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake.

2. Përgjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria ndjek gjithashtu interesa ekonomike dhe tregtare.

Neni 3
Statusi juridik

1. Shoqëria krijohet si person juridik, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare.

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si aksionar të Shoqërisë, është ministria përgjegjëse për mbrojtjen.

3. Themelimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe dispozitave të këtij ligji.

4. Kapitali themeltar i Shoqërisë përcaktohet në statutin e Shoqërisë.

5. Financimi i Shoqërisë në natyrë nëpërmjet pasurisë shtetërore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, si dhe të ministrit përgjegjës për mbrojtjen.

6. Statuti i Shoqërisë miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Shoqëria ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës.

8. Shoqëria ka selinë në Tiranë dhe ka të drejtën të krijojë struktura të tjera sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 4
Objektivat e Shoqërisë

Shoqëria ka këta objektiva kryesorë:



1. Zhvillon me eficiencë aktivitetin e saj, duke kontribuar në ngritjen, zhvillimin dhe forcimin e industrisë së prodhimit e të tregtimit të armëve, me qëllim sigurimin e nevojave të Forcat të Armatosura dhe ato të sigurisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të realizimit të fitimit ekonomik.

2. Prodhon dhe furnizon me pajisje të nevojshme Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e interesave kombëtarë.

3. Ndërton, zhvillon dhe përmirëson kapacitetet vendase për të prodhuar e furnizuar Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë me pajisje të nevojshme për operacionet e tyre.

4. Mobilizon kapital shtetëror dhe/ose privat në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj.

5. Nxist investimet në teknologji dhe inovacion për prodhimin, përdorimin, tregtimin e armëve brenda dhe jashtë vendit.

6. Bashkëpunon me subjekte të ndryshme shtetërore e private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për zhvillimin e objektit të veprimtarisë së saj.

7. Financon ose bashkëfinancon projekte në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike të ngritura për realizimin e tyre.

Neni 5

Funksionet e Shoqërisë

Funksionet kryesore të Shoqërisë janë si më poshtë:

1. Prodhimi, riparimi, demilitarizimi dhe tregtimi i armëve ose i pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municionet, teknologjitë dhe pajisje ushtarake, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, të politikave shtetërore të rritjes së kapaciteteve ushtarake, si dhe të zhvillimit të industrisë ushtarake.

2. Bashkëpunimi me Forcat e Armatosura, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre ushtarake, nëpërmjet sigurimit të armëve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake për Forcat e Armatosura nga ana e Shoqërisë, në cilësinë e furnizuesit, të agjentit ose të autoritetit kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Tregtimi nga vetë Shoqëria apo nga subjekte të tjera të themeluara prej saj ose në bashkëpunim me subjekte private i armëve ushtarake ose i pjesëve të tyre, i municioneve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, të prodhuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Financon ose bashkëfinancon projekte ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike, me qëllim realizimin e objektit të veprimtarisë së saj.

5. Këshilli i Ministrave mund ta autorizojë Shoqërinë të kryejë funksione të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Burimet financiare

1. Shoqëria mund të financohet nga:

a) buxheti i shtetit, me qëllim kapitalizmin, si dhe mbështetjen operacionale, derisa Shoqëria të krijojë të ardhura për t'u vetëfinancuar;

b) të ardhurat e përfituara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara;

c) donacionet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) financime nga institucione financiare pas miratimit të Këshillit të Ministrave;

d) burime të tjera, të lejuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e saj të brendshme.

2. Detyrimet financiare të Shoqërisë nuk i transferohen buxhetit të shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i Shoqërisë.

Neni 7

Zhvillimi i aktivitetit të Shoqërisë

1. Shoqëria, me qëllim ndjekjen e objektivave të saj, kryen studime dhe analiza të objektit e të përmasave të investimeve që ka për qëllim të realizojë, si dhe të mundësive objektive për realizimin e tyre.

2. Shoqëria mund të marrë ndihmë, si dhe të kontrakttojë ose të nënkontrakttojë konsulentë nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte shtetërore dhe private, vendase e të huaja, në lidhje me:

a) konceptimin, hartimin ose realizimin e një projekti zhvillimi të objektit të aktivitetit të Shoqërisë;



b) përgatitjen e një plani të detajuar biznesi në raport me politikat shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes me politikat ndërkombëtare, të zbatueshme për prodhimin e tregtimin e armëve dhe me politikat tregtare të Shoqërisë;

c) marrjen e teknologjive, të ekspertizës, infrastrukturës kibernetike dhe digjitale, makinerive /pajisjeve të nevojshme për zbatimin e planit të biznesit;

ç) trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të saj;

d) furnizimin me pjesë, materiale dhe teknologji të nevojshme për prodhimin e armëve dhe të pajisjeve ushtarake;

dh) zhvillimin e teknologjive të avancuara për prodhimin e armatimeve të reja, ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes dhe të pajisjeve të sigurisë;

e) sigurimin e shërbimeve mbështetëse, të tilla si: mirëmbajtja, riparimi dhe përmirësimi i pajisjeve ushtarake dhe të aseteve të Shoqërisë;

ë) financimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe të zhvillimit ndërmjet institucioneve kërkimore publike dhe kompanive private në sektorin e mbrojtjes për të promovuar inovacionin dhe zhvillimin e teknologjive të reja;

f) bashkëpunimin me shoqëri të specializuara për të ofruar programe edukimi dhe trajnimi për personelin ushtarak, duke përdorur aftësitë dhe përvojën e shoqërive në fushën e formimit profesional;

g) bashkëpunimin me shoqëri të specializuara për të promovuar dhe shitur armë e pajisje ushtarake në tregjet ndërkombëtare, duke përdorur rrjetet tregtare dhe ekspertizën e marketingut të këtyre shoqërive;

gj) nevoja të tjera, që lidhen drejtpërdrejt me realizimin dhe zhvillimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 8

Operacionet e veçanta

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, në vijim të vendimmarrjes së Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, rast pas rasti, miraton operacione të veçanta për t'u financuar nga Shoqëria.

2. Operacionet e veçanta, sipas pikës 1 të këtij neni, janë aktivitete që Shoqëria i kryen brenda qëllimit të këtij ligji, por jashtë planit të saj të

zhvillimit, nevoja e kryerjes së të cilave lind nga zbatimi i politikave të caktuara në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

3. Shoqëria krijon një fond rezervë të veçantë për financimin e operacioneve sipas parashikimeve të këtij neni.

Neni 9

Transferimi i pronave të paluajtshme shtetërore

1. Në rastet kur një pronë e paluajtshme shtetërore është me interes për realizimin e projekteve të investimit, Shoqëria i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministrit përgjegjës për mbrojtjen, transferimin e së drejtës së pronësisë, të përdorimit apo çdo të drejte tjetër, sipas parashikimeve të Kodit Civil.

2. Këshilli i Ministrave parashikon mënyrat, kriteret dhe procedurat sipas të cilave Shoqëria do të ushtrojë të drejtat e saj mbi pronat e paluajtshme, në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në dhënien e saj në sipërmarrje, dhënien me qira ose përdorim sipas formave të tjera të parashikuara në Kodin Civil.

3. Shoqëria, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj, me miratimin e Këshillit të Ministrave, me qëllim ngritjen e kapitalit, të aseteve ose të likuiditetit të nevojshëm për realizimin e aktivitetit të saj, mund ta përdorë pronën e paluajtshme shtetërore si garanci, kolateral, peng apo hipotekë, në rast marrjeje financimi.

Neni 10

Marrëdhëniet me palët e treta

1. Shoqëria ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie me palët e treta, subjekte shtetërore ose private, vendase apo të huaja, në të gjitha fazat e zhvillimit të veprimtarisë së saj, në përputhje me kriteret dhe procedurat e caktuara me këtë ligj.

2. Shoqëria, vetë ose me kërkesë të palëve të treta, bashkëpunon me subjekte private nëpërmjet pjesëmarrjes në bashkim operatorësh ekonomikë, në partneritet publik, privat, sipas legjislacionit tregtar në fuqi dhe/ose nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme kontraktore të lejuara nga legjislacioni civil e tregtar.



3. Kushtet e negocimit të Shoqërisë me subjekte private miratohen, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të Shoqërisë, nëpërmjet ministrit përgjegjës për mbrojtjen. Pas këtij miratimi, Shoqëria vijon procedurat sipas pikave 4, 5 dhe 6 të këtij neni.

4. Në rastet kur Shoqëria kërkon të bashkëpunojë me partnerë privatë, procedurat e përzgjedhjes së bashkëpunëtorit privat janë procedura konkurruese të zhvilluara nga Shoqëria në përputhje me parimet e transparencës, të proporcionalitetit, efikasitetit, ruajtjes së informacionit të klasifikuar, përfitueshmërisë, fizibilitetit ekonomik dhe tregtar të projekteve, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore, si dhe sipas përcaktimeve në këtë ligj e aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë.

5. Në rastet kur Shoqërisë i paraqiten kërkesa për bashkëpunim nga palë të tjera shtetërore ose private, Këshilli Mbikëqyrës autorizon administratorin të ngrejë grupin e negocimit të ofertës, i cili ngarkohet për vlerësimin dhe negocimin e kërkesës së paraqitur, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Shoqërisë. Raporti i grupit të negocimit i paraqitet Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, i cili miraton ose jo bashkëpunimin në rastin konkret.

6. Në rastet kur bashkëpunimi lidhet me interesat e shtetit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, të evidentuara në dokumentet strategjike, sipas vlerësimit të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Shoqëria mund të përzgjedhë drejtpërdrejt një subjekt publik apo privat me të cilin do të bashkëpunojë. Në këto raste, Këshilli Mbikëqyrës autorizon administratorin të urdhërojë ngritjen e grupit të negocimit, i cili, në përputhje me vendimin e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, vlerëson subjektin me të cilin negocion në mënyrë të drejtpërdrejtë. Raporti i grupit të negocimit miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

7. Në çdo rast, Shoqëria siguron ruajtjen, në përputhje me ligjin dhe kërkesat e palëve konkurruese, të konfidencialitetit të informacionit të administruar prej saj dhe të klasifikuar gjatë procedurave si sekret shtetëror, tregtar apo industrial. Aktet e administruara nga Shoqëria gjatë procedurave të tilla nuk bëhen publike nëse kjo bie ndesh me interesat e shtetit në fushën e mbrojtjes e të sigurisë.

8. Në përzgjedhjen e subjektit privat me të cilin bashkëpunon në prodhim dhe tregtim të armëve

dhe teknologjive ushtarake, Shoqëria sigurohet, sipas rasti, që:

a) subjekti përmbush kriteret e nevojshme për pajisjen me leje dhe licenca për prodhimin e tregtimin e armëve dhe të teknologjive ushtarake, duke përfshirë sigurinë e objekteve, kapacitetin teknik, operacional e financiar;

b) subjekti garanton zbatimin e standardeve të sigurisë e të kontrollit të armëve dhe teknologjive ushtarake në të gjitha fazat e prodhimit e të tregtimit, duke përfshirë ruajtjen, transportin dhe transferimin e tyre;

c) subjekti garanton raportim të veprimtarisë së tij në përputhje me standardet vendore e ndërkombëtare të sigurisë dhe të kontrollit të armëve e teknologjive ushtarake;

ç) subjekti garanton respektimin e konfidencialitetit të të dhënave në veprimtaritë e Shoqërisë;

d) subjekti plotëson kriteret e besueshmërisë, pastërtisë së figurës dhe reputacionit në sektorin e prodhimit e të tregtimit të armëve dhe të teknologjive ushtarake.

9. Në funksion të garantimit të interesave të saj, Shoqëria, pavarësisht pjesëmarrjes në këto subjekte, ushtron të drejtën e vetos për çështjet si më poshtë:

a) ndryshim statuti;

b) zmadhim apo zvogëlim kapitali;

c) shpërndarje fitimi;

ç) riorganizim dhe prishje të Shoqërisë;

d) përfshirje e aksionarëve të tjerë.

10. Shoqëria ka detyrimin të garantojë sigurimin e përmbushjes së kërkesave ligjore, parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme të armëve, të municioneve, të pajisjeve dhe teknologjive ushtarake, si dhe ndalimin e konkurrencës së paligjshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke ushtruar të drejtën e vetos në vendimmarrje.

11. Në rastet kur Shoqëria krijon bashkëpunim me subjekte të tjera, me qëllim garantimin e sigurisë juridike të pronës së paluajtshme shtetërore të kaluar te Shoqëria, përveçse me miratim të Këshillit të Ministrave, ndalohet transferimi nëpërmjet shitjes, si dhe lënia e saj si garanci, kolateral, peng apo hipotekë.

Neni 11 Licencimi

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të licencave dhe të lejeve të lëshuara nga autoriteti



shtetëror përgjegjës për lëshimin e licencave, mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve të lidhura me armët, municionet, pajisjet dhe teknologjitë ushtarake, si dhe çdo licencë tjetër të nevojshme, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 12

Kontrolli financiar

1. Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

3. Pasqyrat financiare të Shoqërisë auditohen sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar.

Neni 13

Garantimi i normave të sigurisë

1. Shoqëria ka detyrimin të sigurojë përmes policave të sigurimit operacionet e saj, që lidhen me prodhimin, riparimin e demilitarizimin e armëve. Procedurat për zbatimin e kësaj dispozite rregullohen me akte të brendshme, rregullatore të Shoqërisë.

2. Shoqëria siguron një strukturë operative për zbatimin dhe mbikëqyrjen e rregullave kombëtare e ndërkombëtare të sigurisë, të aplikueshme për prodhimin, riparimin dhe demilitarizimin e armëve. Përbërja, funksionimi dhe përgjegjësitë e kësaj strukture rregullohen nga statuti dhe aktet e tjera, rregullatore të Shoqërisë.

3. Shoqëria ngre dhe operon infrastrukturë digjitale dhe kibernetike, e cila ndërvepron me infrastrukturën e Ministrisë së Mbrojtjes. Personeli operativ i këtyre infrastrukturave pajiset me certifikatën e sigurisë përkatëse dhe informacioni i përpunuar në këto infrastruktura është i mbrojtur nga sekreti shtetëror, tregtar dhe industrial ushtarak. Rregullat për ngritjen, funksionimin dhe sigurimin e infrastrukturës përcaktohen me akte të brendshme të Shoqërisë.

Neni 14

Regjimi i prokurimit

Për kontratat në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Neni 15

Detyrimi për shërbim

1. Në rastin e gjendjes së luftës ose në kushtet e një rreziku të afërt dhe konkret të një agresioni ushtarak ndaj Republikës së Shqipërisë ose aleatëve të saj strategjikë, Shoqëria ka detyrimin që të sigurojë një rezervë të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, në vijim të propozimit të ministrit të Mbrojtjes dhe vendimmarrjes së Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

2. Shoqëria është e detyruar të plotësojë kërkesën, sipas pikës 1 të këtij neni, në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë, në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e autoriteteve përgjegjëse për rregullimin e industrisë së mbrojtjes.

Neni 16

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli Mbikëqyrës;
- c) administratori.

2. Struktura dhe organika e Shoqërisë miratohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 17

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme:

a) miratimin e statutit të Shoqërisë dhe të ndryshimeve të tij, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës;

b) miratimin e strategjisë së zhvillimit të Shoqërisë, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me politikat dhe dokumentet strategjike të mbrojtjes dhe sigurisë;



c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë së Shoqërisë;

ç) çështje të tjera të parashikuara nga ky ligj, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe statuti i Shoqërisë, përveç atyre që i janë dhënë me këtë ligj Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 18 Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës ka 7 (shtatë) anëtarë si më poshtë:

- a) 1 (një) anëtar, përfaqësues i Kryeministrit;
- b) 2 (dy) anëtarë, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen;
- c) 1 (një) anëtar, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;
- ç) 1 (një) anëtar, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për ekonominë;
- d) 1 (një) anëtar, përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- dh) 1 (një) anëtar, përfaqësues i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe lirohen nga Asambleja e Përgjithshme pas propozimit të institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Shoqërinë.

4. Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, periudha e emërimit apo e riemërimit të tyre, pagat dhe modalitetet për shpërblym të suplementare caktohen në statutin e Shoqërisë.

Neni 19 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës siguron që Shoqëria gëzon autonomi operationale në veprimtarinë e saj dhe ka këto kompetenca:

- a) propozon për miratim në Asamblenë e Përgjithshme statutin e Shoqërisë dhe ndryshimet në të;
- b) propozon për miratim në Asamblenë e Përgjithshme strategjinë e zhvillimit të Shoqërisë;
- c) miraton planin e biznesit dhe planet vjetore të punës;
- ç) miraton projektet e investimit;

d) miraton ngritjen e strukturave të tjera të Shoqërisë;

dh) kontrollon e mbikëqyr zbatimin e politikave dhe të projekteve të investimit të Shoqërisë;

e) miraton treguesit e performancës dhe monitoron performancën e saj;

ë) siguron që auditimi i Shoqërisë të kryhet për të respektuar dhe për të dhënë në çdo kohë garancitë që shoqëria ka marrë përsipër, sidomos ato në fushën e sigurisë e të mbrojtjes;

f) përcakton pagat dhe shpërblym të organeve dhe të administratës së Shoqërisë;

g) krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollin e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në Shoqëri;

gj) miraton procedurat për kontraktimin e konsulentëve dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Shoqërisë, me kërkesë të administratorit;

h) miraton aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë.

2. Këshilli Mbikëqyrës miraton procedurat e hollësishme konkurruese, kriteret për negociimin, raportin e grupit negociator, si dhe autorizimin për lidhjen e kontratave me subjekte juridike, private apo publike, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar, të aplikueshëm për prodhimin e tregtimin e armëve.

3. Këshilli Mbikëqyrës miraton procedurat dhe kriteret për emërimin e personelit, si dhe një rregullore të veçantë mbi masat për ruajtjen e të dhënave të klasifikuara dhe të sekretit tregtar të veprimtarisë së Shoqërisë, format e kontrollit të vazhdueshëm lidhur me marrjen e masave dhe procedurën e mundshme administrative e penale, që ndiqet në rast shkeljeje të këtyre rregullave.

4. Këshilli Mbikëqyrës përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, legjislacioni tregtar në fuqi, statuti i Shoqërisë dhe akte të tjera të brendshme të Shoqërisë.

Neni 20 Administratori

1. Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë.

2. Administratori përgjigjet përpara Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës.

3. Administratori emërohet dhe lirohet nga Asambleja e Përgjithshme. Kriteret dhe procedurat



e emërimit dhe të lirit të administratorit rregullohen në statutin e Shoqërisë.

4. Asambleja e Përgjithshme sigurohet që personi kandidat për pozicionin e administratorit të plotësojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

5. Paga e administratorit është konkurruese në raport me tregun, kredencialet dhe performancën në detyrë.

Neni 21

Kompetencat e administratorit

1. Administratori ka këto kompetenca:

a) drejton veprimtarinë e Shoqërisë dhe zbatimin e politikave të caktuara nga programi i zhvillimit të Shoqërisë dhe legjislacioni në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes;

b) përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve e të librave kontabël të Shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;

d) kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, standardet dhe normat e sigurisë e të mbrojtjes, si dhe respektimin nga ana e personelit të detyrimeve të tyre, të parashikuara në legjislacionin e aplikueshëm për Shoqërinë;

dh) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, kryhen me saktësi nga Shoqëria;

e) krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën e Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e aplikueshme nga Shoqëria;

ë) kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi;

f) raporton përpara Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave dhe veprimtarinë e Shoqërisë;

g) siguron zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme e të Këshillit Mbikëqyrës, të legjislacionit dhe të akteve të brendshme të Shoqërisë;

gj) detyra të tjera të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, legjislacioni tregtar në fuqi, statuti i Shoqërisë dhe akte të tjera të brendshme të Shoqërisë.

2. Administratori është i detyruar të sigurojë ngritjen, ruajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës kibernetike dhe digjitale të Shoqërisë në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 22

Personeli

1. Struktura dhe organika e Shoqërisë miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

2. Marrëdhëniet e punës së personelit të Shoqërisë rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë.

3. Kriteret specifike të emërimit të personelit përcaktohen në aktet e brendshme të Shoqërisë.

4. I gjithë personeli i Shoqërisë, pavarësisht funksionit dhe pozicionit që ka, ka detyrimin të respektojë normat dhe standardet e sigurisë, të konfidencialitetit dhe të sekretit tregtar e shtetëror.

5. Organet drejtuese të Shoqërisë kujdesen për trajnimin e vazhdueshëm të personelit për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.

6. Ndalohej punësimi i një personi të dënuar me vendim të formës së prerë për pjesëmarrje ose financim në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste, pastrim parash ose financim të terrorizmit, vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, gjenocid, torturë, vrasje, akte të tjera të dhunshme, vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, armëmbajtje pa leje, tregti të paligjshme armësh, krime ushtarake apo sulme kibernetike.

7. Shoqëria kryen kontrolle të vazhdueshme edhe pas punësimit të personelit lidhur me përputhshmërinë ligjore të të punësuarve të saj.

8. Shoqëria mund të angazhojë personel të përkohshëm ose ekspertizë të jashtme për pjesë të veprimtarisë së saj, të cilën nuk mund ta plotësojë me stafin në dispozicion. Personat e angazhuar duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara nga aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë.



Neni 23
Konflikti i interesit

1. Personeli i punësuar në Shoqëri ndalohet të angazhohet në aktivitete private të lidhura me prodhimin, tregtimin ose shpërndarjen e armëve, brenda ose jashtë vendit. Këto aktivitete përfshijnë, por nuk kufizohen në dypunësimin në shoqëri të tjera private të armëve, lidhjen e kontratave private për prodhimin ose tregtimin e armëve, si dhe dhënien e shërbimeve të konsulencës lidhur me industrinë e armëve.

2. Në rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës me Shoqërinë, punonjësi është i ndaluar të angazhohet në një aktivitet konkurrues me veprimtarinë e Shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare nga data e shkëputjes së marrëdhënies së punës.

Neni 24
Të dhënat konfidenciale

1. Në funksion të zbatimit të politikave të mbrojtjes e të sigurisë, aktivitetet e Shoqërisë do të ndahen në dy kategori:

a) aktivitete të klasifikuara që përfshijnë çdo veprim, dokument ose proces që përmban informacion sensitiv, i cili duhet të trajtohet me kujdes dhe të klasifikohet sipas kërkesave të këtij ligji;

b) aktivitete të paklasifikuara që përfshijnë veprimet e zakonshme të Shoqërisë, që nuk përmbajnë informacion sensitiv e nuk klasifikohen.

2. Aktivitetet klasifikohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe procedurat e klasifikuara, si dhe me rregulloren e brendshme të Shoqërisë.

3. Personeli i Shoqërisë, i cili ka administruar informacion të klasifikuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, si edhe pas përfundimit të saj është i detyruar të ruajë konfidencialitetin dhe sekretin tregtar për fakte për të cilat është vënë në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

4. Autoritetet kompetente shtetërore kanë për detyrë t'i përdorin të dhënat tregtare të marra nga Shoqëria vetëm për qëllimet e treguara në kërkesën e tyre për marrje informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin rreth tij. Informacioni konfidencial tregtar dhe industrial mund të bëhet

publik vetëm sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 25
Dispozita kalimtare

1. Uzina e Lëndëve Plasëse, Uzina Mekanike Gramsh dhe Kombinati Mekanik Poliçan pushojnë së ekzistuari me përfundimin e proceseve, sipas pikave në vijim të këtij neni.

2. Aktivitetet e ndërmarrjeve, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, i transferohen shoqërisë “KAYO” sh.a., në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Ministri i Mbrojtjes miraton me udhëzim procedurat për zbatimin e kësaj pike.

3. Detyrimet financiare ndaj të tretëve të ndërmarrjeve shtetërore, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përballohen nga buxheti i shtetit.

4. Autorizohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e pikës 3 të këtij neni.

Neni 26
Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për mbrojtjen brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndjek procedurat e nevojshme për:

- a) sigurimin e kapitalit fillestar;
- b) zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Shoqërisë;
- c) miratimin e statutit të Shoqërisë;
- ç) regjistrimin e Shoqërisë pranë regjistrimit tregtar.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 302, datë 6.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.



DEKRET
Nr. 302, datë 6.8.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 89/2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 46/2018, “PËR
KONTROLLIN SHTETËROR TË
TRANSFERIMEVE NDËRKOMBËTARE
TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË
ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME
PËRDORIM TË DYFISHTË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 3 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, të cilat kryhen sipas udhëzimeve të vendeve/agjencive të NATO-s, për rastet e veçanta të nevojave operacionale të këtyre vendeve.”.

Neni 2

Paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

“Në Ministrinë e Mbrojtjes funksionon Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), e cila është struktura shtetërore, përgjegjëse për zbatimin e politikës së kontrollit për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, të artikujve dhe të teknologjive me përdorim të dyfishtë.”.

Neni 3

Pika 1 e nenit 10 ndryshohet si më poshtë:

“1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me kontributet e ministrive dhe të organeve të tjera të interesuara, harton dhe propozon pranë ministrit të Mbrojtjes listën e mallrave, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, miraton listën e mallrave ushtarake, të artikujve e të teknologjive me përdorim të dyfishtë në përputhje me listat përkatëse të Bashkimit Evropian.”.

Neni 4

Në nenin 13 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) ndaj subjektit aplikues ka filluar procedimi penal ose është dënuar me vendim penal të formës së prerë nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë për:

i. veprën penale të prodhimit, mbajtjes, blerjes, transportit apo tregtimit të lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimit shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë;

ii. shkeljen e dispozitave të këtij ligji;

iii. shkeljen e dispozitave të tjera të legjislacionit në fuqi, që lidhen me rendin kushtetues dhe sigurinë kombëtare.”.



2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) ndaj subjektit aplikues ka filluar procedimi penal ose është dënuar me vendim penal të formës së prerë nga gjykatat e një shteti të huaj për:

i. veprën penale të prodhimit, mbajtjes, blerjes, transportit apo tregtimit të lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimit shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë, sipas parashikimeve të legjislacionit penal në fuqi të shtetit të huaj;

ii. shkeljen e dispozitave të legjislacionit të shtetit të huaj për kontrollin shtetëror mbi transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë;

iii. shkeljen e dispozitave të tjera të legjislacionit në fuqi të shtetit të huaj, që lidhen me rendin kushtetues dhe sigurinë kombëtare;”.

Neni 5

Në nenin 14 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Përcaktimi i formatit të regjistrat, si dhe të dhënat e subjekteve, të cilat duhet të regjistrohen, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Në pikën 3 togfjalëshi “miraton vendimet” zëvendësohet me fjalën “vendos”.

3. Në shkronjën “dh” të pikës 5 fjalët “arsye të tjera për cenimin e sigurisë kombëtare.” zëvendësohen me fjalët “dyshime të arsyeshme që cenojnë sigurinë kombëtare.”.

Neni 6

Paragrafi i dytë i pikës 4 të nenit 17 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i tretë i pikës 1 shfuqizohet.

2. Fjalja e dytë e pikës 2 shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalja e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Për lëshimin e licencave/autorizimeve apo të certifikatave në transferimin ndërkombëtar të

mallrave, personi fizik ose juridik paraqet kërkesën *online* me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtim dhe vlerësim.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Llojet e licencave, certifikatave dhe autorizimeve, dokumentacioni i aplikimit, formatet e kërkesave të aplikimeve, si dhe formatet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 9

Shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 29 shfuqizohet.

Neni 10

Në pikën 2 të nenit 30, fjalët “mund të miratojë një vendim” zëvendësohen me fjalën “vendos”.

Neni 11

Paragrafi i dytë i pikës 2 të nenit 34 ndryshohet si më poshtë:

“Procedurat dhe kërkesat për marrjen e autorizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 12

Në nenin 37 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Formatet e raportimit, si dhe afatet e koha e paraqitjes së raporteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “d” fjalët “dhe incizimet audio-video” hiqen.

b) shkronja “e” e pikës 3 shfuqizohet.

Neni 13

Pika 2 e nenit 38 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për ofrimin e informacionit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, subjektet e përfshira në transferimet e mallrave, që kanë marrë licencë, raportojnë sipas formateve të miratuara.

Formatet e raportimit, si dhe afatet e koha e paraqitjes së raporteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.



Neni 14

Fjalja e parë e pikës 2 të nenit 42 ndryshohet si më poshtë:

“Subjekteve të pikës 1, përsëritëse të mbi dy herë të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni, përveç gjobës, u caktohet si masë shtesë ndalimi i kryerjes së transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara.”.

Neni 15

Pikat 4 dhe 5 të nenit 44 ndryshohen si më poshtë:

“4. Kundër vendimit të komisionit, të marrë sipas pikës 1 këtij neni, bëhet ankim administrativ sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Kundër vendimit të zyrtarit të autorizuar, të marrë sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet ankim administrativ sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.”.

Neni 16

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Deri në ngritjen e infrastrukturës së dedikuar për paraqitjen e kërkesës *online*, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 26, kërkesa për lëshimin e licencave, certifikatave dhe autorizimeve, si dhe dokumentacioni përkatës paraqiten sipas mënyrave e mjeteve ekzistuese.

2. Detyrimet e subjekteve, sipas shkronjave “d” e “dh” të pikës 1 të nenit 38 dhe shkronjës “k” të nenit 41 zbatohen vetëm për rastet e licencave që lëshohen të printuara fizikisht.

3. Të gjitha procedurat e kryera sipas udhëzimeve të vendeve ose agjencive të NATO-s për transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, me qëllim dhënien e asistencës shtetërore ushtarake konsiderohen në përputhje me regjimin e vendosur për transferimin ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara dhe të përcaktuara në nenin 3, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 303, datë 6.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 303, datë 6.8.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 89/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018, ‘Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 90/2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 78/2020,
“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT
TË PROVËS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Shërbimit të Provës dhe punonjësve administrativë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale rregullohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pika 6 shfuqizohet.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Niveli i pagave të nëpunësve të Shërbimit të Provës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Neni 2

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Në pikën 2 togfjalëshi “të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil” zëvendësohet me togfjalëshin “të përcaktuara në rregulloren e brendshme”.

Neni 3

Në nenin 12 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Në pikën 2 togfjalëshi “të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil” zëvendësohet me togfjalëshin “të përcaktuara në rregulloren e brendshme”.

Neni 4
Dispozitë kalimtare

Nëpunësit e Shërbimit të Provës, marrëdhëniet e punës së të cilëve aktualisht rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil, vijojnë marrëdhënien e tyre të punës sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.

Neni 5
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 1, pika 3, të këtij ligji.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 304, datë 7.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 304, datë 7.8.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 90/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**LIGJ**
Nr. 91/2024**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.**
7961, DATË 12.7.1995, “KODI I PUNËS
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pikat 1 dhe 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 92, pika 2, togfjalëshi “4 javë kalendarike” zëvendësohet me togfjalëshin “22 ditë pune”.

Neni 2

Në nenin 93, pika 3, togfjalëshi “por asnjëherë nuk duhet të jenë më pak se një javë kalendarike pa ndërprerje” hiqet.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 305, datë 7.8.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 305, datë 7.8.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 91/2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 288, datë 5.8.2024**PËR LEJIMIN E LËNIES SË**
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

- Valbona Veri Lamanjaku
- Erjona Bujar Joca (Paja)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 289, datë 5.8.2024

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Besjana Ferit Gjilani (Domi)
2. Vilson Mariglen Gjilani
3. Ina Dhimitër Dogga
4. Irgita Bardhyl Omeri
5. Malvina Andon Çaçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 290, datë 5.8.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kujtim Shkelzen Gjevori
2. Bledi Besnik Mejzini
3. Ismail Skender Kokaj

DEKRET
Nr. 291, datë 5.8.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mariana Ziko Mingo (Zguri)
2. Linda (Lindita) Faslli Kevani (Qevani) (Baho)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET
Nr. 292, datë 5.8.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Altin Roberto Mustafaraj
2. Ernesto Franco Andracchio



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 293, datë 5.8.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Alfred Ajdin Brasha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 294, datë 5.8.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Endrit Murteza Godeni
2. Laurat Skender Mulliqi
3. Gjelojsh Martin Rasaj
4. Hysen Riza Hyseni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 295, datë 5.8.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dijamant Zejnel Latifi
2. Lavdim Bashkim Krusha
3. Sali Malush Hoti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 296, datë 5.8.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Rajaa Mustafa Monim

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 297, datë 5.8.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mahsa Mehrdad Barbullushi (Tayyar)
2. Olga Alexey (Alexeevna) Samoylenko
3. Cynthia Francisco Delfino Vargas Juarez (Juarez)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 298, datë 5.8.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Zak Petrit Saraili

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 299, datë 5.8.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Frida Viktor Skënderi
2. Rabah Isa Ramaj
3. Elisa Fehmi Reçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 300, datë 5.8.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Liljanë Kolë Jaku
2. Ermond Baftjar Dedja
3. Dennis Erman Myrto

4. Eni Naim Alla**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 301, datë 5.8.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasve:

1. Ina Adnand Zalosnjaja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

URDHËR**Nr. 137, datë 6.8.2024****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Marbona Cuka, drejtor i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme.

2. Kompetencat e deleguara të Sekretarit të Përgjithshëm do të ushtrohen deri në emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Ngarkohet znj. Marbona Cuka për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë

